



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM

RAPORTI I PROGRESIT 2006-2007

**Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive
dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj**

Dhjetor 2008

Pasqyra e lëndës

	HYRJE	7
1	Integrimi në Bashkimin Europian dhe në NATO	11
1.1	Integrimi në Bashkimin Europian.....	12
1.2	Integrimi në NATO	15
1.3	Punët e jashtme	17
2	Demokratizimi dhe shteti i së drejtës	18
2.1	Drejtësia	19
2.2	Të drejtat e pronës	21
2.3	Anti-korrupsioni	22
2.4	Krimi i organizuar	23
2.5	Rendi publik.....	25
2.6	Administrata publike.....	26
2.7	Decentralizimi	28
3	Zhvillimi Ekonomik dhe Social	29
3.1	Infrastruktura	30
3.1.1	Transporti.....	31
3.1.2	Energjetika	35
3.1.3	Furnizimi me ujë dhe kanalizimet.....	38
3.1.4	Mjedisi	41
3.2	Ekonomia e tregut.....	43
3.2.1	Financat publike.....	45
3.2.2	Ekonomia	48
3.2.3	Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbikqyrja e tregut.....	51
3.2.4	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit	52
3.3	Politika sociale.....	54
3.3.1	Punësimi	55
3.3.2	Barazia gjinore.....	57
3.3.3	Mbrojtja sociale	59

3.3.4	Përfshirja sociale	61
3.3.5	Sigurimet shoqërore	63
3.3.6	Shëndetësia	65
3.3.7	Arsimi parauniversitar	68
3.3.8	Arsimi i lartë	70
3.4	Zhvillimi urban, rural dhe rajonal	72
3.4.1	Planifikimi hapësinor.....	73
3.4.2	Zhvillimi rajonal	74
3.4.3	Zhvillimi rural.....	75
3.4.4	Bujqësia.....	77
3.4.5	Turizmi	79
4	SHTOJCË: Raporti i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit për vitin 2007.....	81

Lista e Shkurtimeve

Shkurtimi	EMËRTIMI I PLOTË
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Europian
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj
EJL	Evropa Juglindore
EMIS	Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Arsimit
FARSH	Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
KE	Komisioni Evropian
KM	Këshilli i Ministrave
LSMS	Anketa për Matjen e Standardeve të Jetesës
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MB	Ministria e Brendshme
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
MF	Ministria e Financave
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OZHM	Objektiva të Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PKZMSA	Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
PM	Projekti i Mijëvjeçarit
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik e Social
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara i Emergjencës për Fëmijët
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

HYRJE

Raporti i Progresit 2006-2007 i SKZHI është një element i rëndësishëm i sistemit të monitorimit në lidhje me zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili po zbatohet që prej vitit 2005. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013, që ky raport monitoron, është një nga komponentët më të rëndësishëm të SPI-së dhe përfaqëson dokumentin themelor strategjik të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, kombinuar me axhendën e integritimit në Bashkimin Europian e në strukturat e NATO-s, dhe me realizimin e Objektivave të Mijëvjeçarit. Gjatë viteve 2006-2007 të gjitha strukturat e qeverisë kanë qenë të angazhuara në hartimin, rishikimin dhe konsultimin e këtij dokumenti.

SKZHI është hartuar mbi bazën e 37 strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, procesi i hartimit të të cilave filloi gjerësisht në vitin 2006. Në këto strategji janë identifikuar prioritetet sektoriale/ ndërsektoriale, duke u përqendruar në angazhimet e Integritimit Europian dhe duke identifikuar njëkohësisht politikatat, objektivat, treguesit e zbatimit të politikave, si dhe kostot e tyre.

Procesi i konsultimit të SKZHI-së ka qenë gjithpërfshirës dhe kombëtar, i orientuar nga nevoja për një konsensus të gjerë kombëtar mbi përcaktimin e prioritetëve kryesore për zhvillimin dhe integrimin e vendit. Një proces i tillë gjithpërfshirës konsultimi u bë për herë të parë në Shqipëri dhe kishte për qëllim që të mblidhte komentet e palëve të interesuara, veçanërisht mbi identifikimin e përparësive strategjike dhe shpërndarjen e burimeve të ardhshme financiare, si dhe arritjen e një konsensusi sa më të gjerë mbi çështjet kryesore të dokumentit. Ky proces ka përfshirë një audiencë të madhe aktorësh, duke filluar nga nivele të ndryshme të Qeverisë, anëtarë të parlamentit, shoqëria civile, akademikë dhe ekspertë, organizata profesionale, qeverisja vendore dhe donatorë.

Procesi i konsultimeve të SKZHI-së është kryer gjatë vitit 2007 në disa etapa. Fillimisht, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 është diskutuar dhe shqyrtuar në Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe më pas ka ndjekur një proces intensiv konsultimesh me grupet e interesit nëpërmjet një seri aktiviteteve të organizuara. Në kuadrin e procesit të këshillimit, në nëntor të vitit 2007 janë zhvilluar disa tryeza të rrumbullakëta në nivel kombëtar dhe rajonal. Tematika e tryezave të rrumbullakëta i është kushtuar diskutimit të përparësive strategjike: Integrimi në BE dhe NATO, Zhvillimi Ekonomik e Social dhe Demokratizimi e Shteti i së Drejtës dhe të ftuar kanë qenë përfaqësues nga komuniteti i donatorëve dhe shoqëria civile, përfaqësues nga Grupet Këshillimore, akademikë, ekspertë të fushës, përfaqësues të biznesit etj. Tryezat e rrumbullakëta rajonale janë zhvilluar në qytetet e Lezhës, Peshkopisë, Fierit dhe Pogradecit.

SKZHI është dërguar për t'u diskutuar edhe në Komisionet Parlamentare për t'i dhënë këtij dokumenti një dimension gjithpërfshirës dhe kombëtar. Gjithashtu, gjatë muajve tetor-dhjetor 2007 janë transmetuar një seri debatesh televizive të quajtur "Sfida dhe Strategji", me temë strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale dhe prioritetet strategjike të SKZHI-së. Në këto debate morën pjesë ministra, ish ministra, ekspertë nga partitë politike, figura të spikatura të opozitës, specialistë të fushës dhe shoqëria civile.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave në mars të vitit 2008 (VKM Nr. 342 datë 12.03.2008).

Qëllimi, objektivat dhe përmbajtja e Raportit të Progresit

Raporti i Progresit 2006-2007 të SKZHI-së bazohet mbi zhvillimet politike, ekonomike e sociale të vendit dhe vlerëson zbatimin e politikave dhe reformave, që kanë rëndësi kritike për procesin e arritjes së objektivave afatgjata të vendit, të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 (SKZHI). Raporti i Progresit përmbledh ecurinë dhe performancën e sektorëve gjatë viteve 2006-2007, përsa i përket zbatimit të SKZHI-së në tri drejtimet kryesore të saj: Integrimi në Bashkimin Europian dhe në NATO; Demokratizimi dhe Shteti i së Drejtës dhe Zhvillimi Ekonomik dhe Shoqëror. Gjithashtu, raporti paraqet ecurinë për vitin 2007 në lidhje me arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Ky raport është hartuar nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj në Këshillin e Ministrave (DEBASKON) në bashkëpunim me ministritë e linjës, institucione të

tjera të varësisë, INSTAT, Bankën e Shqipërisë etj. Publiku i gjerë është audienca kryesore e synuar për Raportin e Progresit.

Nëpërmjet këtij Raporti Progresi 2006-2007 synohen këto objektiva kryesore: (i) monitorimi dhe vlerësimi i progresit të bërë kundrejt arritjes së qëllimeve për zhvillimin e vendit; (ii) përdorimi i informacioneve statistikore për të bërë krahasimin e ecurisë së reformave në Shqipëri me ato të vendeve të tjera në rajon; (iii) paraqitja e një vlerësimi të ecurisë kundrejt përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM); (iv) nxitja për diskutime të gjera mbi planet strategjike dhe axhendën e Qeverisë.

Gjatë viteve 2006-2007 është punuar paralelisht për hartimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale nga njëra anë dhe të SKZHI-së nga ana tjetër. Për këtë arsye, Raporti i Progresit përmbledh një periudhë dy-vjeçare kohore 2006-2007.

Dokumenti ndahet në kapituj sipas tre drejtimeve kryesore të SKZHI-së dhe gjithashtu përmban si shtojcë të tij edhe Raportin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit për vitin 2007. Çdo kapitull paraqet raporte të veçanta për ecurinë e çdo treguesi të SKZHI, që bazohet mbi një analizë të përmbledhur të sektorit përkatës.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 monitoron dhe raporton edhe mbi përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, të cilat janë përfshirë në strategjinë kombëtare dhe në strategjitë sektoriale e ndërsektoriale dhe janë pjesë e sistemit të monitorimit të SKZHI-së për vitet 2007-2013. Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) janë integruar në objektivat kombëtare të zhvillimit që prej vitit 2002 dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik e Social (SKZHEs) ka raportuar për progresin e bërë drejt arritjes së objektivave dhe synimeve të OZHM-së.

Raporti i vitit 2007 për OZHM është hartuar si shtojcë e Raportit të Progresit për SKZHI-në dhe përmban raporte të veçanta për çdo objektiv të OZHM-së. Çdo raport, në vetvete, ofron (i) një panoramë të objektivave, synimeve dhe treguesve, (ii) një tabelë që përmbledh të dhëna historike, (iii) të dhënat për vitin 2007 dhe (iv) synimin për vitin 2015. Objektivat, qëllimet dhe treguesit që analizohen janë ato të përfshira në Raportin paraprak të vitit 2002 për OZHM-të. Analiza ka të bëjë me parashikimet për arritjen e OZHM-së deri në vitin 2015, në faktin se sa ambiciozë janë synimet, si dhe me vlerësimin e sistemit të monitorimit për të analizuar përparimet e bëra për arritjen e OZHM-së.

Mbështetur në treguesit sipas sektorëve, Raporti 2006-2007 paraqet situatën aktuale dhe masat kryesore të ndërmarra gjatë këtyre viteve. Në të njëjtën kohë, për sektorë të veçantë, paraqiten edhe çështje kritike lidhur me zbatimin e politikave sektoriale, si dhe disa masa që duhen ndërmarrë me qëllim përballimin e sfidave të së ardhmes të tilla si, Integrimi në Bashkimin Evropian dhe NATO. Gjithashtu, në raport analizohen edhe prirjet afatgjata, duke krahasuar Shqipërinë me vendet e tjera të rajonit. Ky raport nuk zëvendëson Raportet Vjetore të Rezultateve të hartuara nga DEBASKON në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe as nuk përcakton një kuadër buxhetor për të ardhmen, pasi kjo jepet në dokumentin e PBA-së nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave.

Metodologjia dhe procesi

Raporti i Progresit bazohet mbi të dhënat statistikore të grumbulluara nga ministritë e linjës, INSTAT, BSH, etj, si dhe të dhëna nga raporte të institucioneve e organizmave ndërkombëtarë. Këto të dhëna janë përpunuar dhe analizuar kryesisht nga pikëpamja e rezultateve dhe impakteve, në funksion të paraqitjes së ecurisë së 44 treguesve të përcaktuar në SKZHI. Treguesit e përzgjedhur të SKZHI-së janë tregues të nivelit të lartë, që monitorojnë ecurinë e qëllimeve strategjike të shprehura në SKZHI dhe kryesisht janë pjesë e sistemit statistikor kombëtar. Në këtë raport janë monitoruar edhe treguesit makroekonomikë.

Në kuadrin e standartizimit të mjeteve të monitorimit dhe vlerësimit të SKZHI-së është punuar për organizimin e të dhënave në një format unik dhe standard, me qëllim paraqitjen e informacionit në një formë të thjeshtë dhe të lehtë për t'u kuptuar. Për këtë qëllim, çdo treguesi i është kushtuar një hapësirë e veçantë, shoqëruar dhe me grafik ilustrues.

Procesi i përgatitjes së Raportit të Progresit është kryer gjatë periudhës qershor-nëntor 2008 dhe përfshin disa faza, të cilat kanë synuar cilësinë e përgatitjes së dokumentit dhe konsultimin e gjerë të tij me të gjithë aktorët e mundshëm. Mbështetur në të dhënat e ministrive të linjës dhe institucioneve

të tjera të përfshira, DEBASKON ka kryer përpunimin dhe analizimin e informacionit të grumbulluar, duke përgatitur një dokument të parë të konsoliduar. Ky dokument i është dërguar për komente dhe sugjerime ministive të linjës dhe të gjitha institucioneve të përfshira, të cilat kanë shërbyer për një rishikim dhe përmirësim të dokumentit. Konsultimi i Raportit të Progresit është kryer gjatë muajit nëntor 2008, me organizimin e dy tryezave të rrumbullakëta, përkatësisht: (i) tryeza e rrumbullakët e organizuar në 4 nëntor 2008, ku morën pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, akademikë, institucione të pavarura, drejtues dhe specialistë të ministrive të linjës, etj; (ii) tryeza e rrumbullakët e datës 6 nëntor, me pjesëmarrjen e komunitetit të donatorëve, përfaqësuesve të ambasadave, organizatave ndërkombëtare, etj. Qëllimi i këtij konsultimi ishte marrja e kontributit për monitorimin dhe vlerësimin sa më të plotë të ecurisë së zbatimit të politikave dhe reformave të ndërmarra. Në këtë kuadër, dokumenti i Raportit të Progresit është dërguar për komente dhe diskutim pranë komisioneve parlamentare.

TABELA E STRATEGJIVE SEKTORIALE DHE NDËRSEKTORIALE DHE STATUSI I TYRE DERI NË FUND TË VITIT 2007

Strategji sektoriale	Miraturuar me VKM	Në fazë përfundimi	Në proces
• Bujqësia dhe ushqimi		X	
• Mbrojtja	X		
• Zhvillimi i biznesit dhe investimeve të huaja (përfshin edhe industrinë jo-ushqimore, industrinë minerare)	X		
• Energjetika		X	
• Arsimi parauniversitar (arsimin bazë, dytësor, të mesëm, profesional)			X
• Arsimi i lartë		X	
• Financat (përfshirë tatimet dhe doganat)		X	
• Sigurimet shoqërore			X
• Marrëdhëniet me jashtë		X	
• Shëndetsia			X
• Rendi publik	X		
• Drejtësia			X
• Punësimi	X		
• Mbrojtja sociale		X	
• Planifikimi hapësinor (përfshirë strehimin)			X
• Furnizimi me ujë dhe kanalizimet			X
• Transporti		X	
• Turizmi		X	
• Kultura			X
• Sporti			X
• Statistikat	X		
Strategji ndërsektoriale	Miraturuar me VKM	Fazë përfundimi	Në proces
• Decentralizimi		X	
• Zhvillimi rajonal	X		
• Zhvillimi rural	X		
• Shoqëria e informacionit			X
• Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë			X
• Përfshirja Sociale		X	
• Lufta kundër korrupsionit dhe qeverisja transparente		X	
• Mjedisi	X		
• Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikqyrja e tregut	X		
• Migracioni	X		
• Barazia gjinore dhe parandalimi i dhunës në familje		X	
• Menaxhimi i integruar i kufijve	X		
• Rinia	X		
• Lufta kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit		X	
• Reforma në administratën publike			X
• Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore, trafikut të fëmijëve		X	

1 INTEGRIMI NË BASHKIMIN EUROPIAN DHE NË NATO

Procesi i anëtarësimit të vendit në Bashkimin European dhe në NATO, si objektiva madhorë të Qeverisë Shqiptare, ka shënuar progres të rëndësishëm gjatë periudhës 2006-2007, ku ndër arritjet kryesore mund të përmenden si vijon:

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) më 12 qershor 2006, si dhe i Marrëveshjes së Përkohshme, dhe hyrja në fuqi e kësaj të fundit më 1 dhjetor 2006. Hyrja në fuqi e MSA-së nëpërmjet ratifikimit të saj nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, si dhe zbatimi me sukses i saj, përbën objektivin kryesor të qeverisë në vitet e ardhshme. Deri tani, MSA është ratifikuar nga 24 vende anëtare të BE-së.

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e marrëveshjes për lehtësimin e vizave. Në këtë kuadër po punohet për plotësimin me rigorozitet të të gjitha kushteve për arritjen e liberalizimit të plotë të regjimit të vizave për qytetarët shqiptarë.

Përgatitja për marrjen e ftesës për anëtarësim në NATO në Samitin e Bukureshtit në prill 2008 përbën një arritje të rëndësishme dhe madhore. Në vijim të ftesës, Qeveria Shqiptare do të mbështesë FARSH-in për plotësimin e të gjithë Objektivave të Partneritetit me NATO-n, si një nga detyrimet më të rëndësishme për të mundësuar anëtarësimin e plotë në këtë aleancë.

Që nga 1 janari 2007, Shqipëria, si vend kandidat potencial, përfiton nga Instrumenti i Para-Aderimit (IPA) i Bashkimit European një fond prej 213 milion Euro për periudhën 2007-2009, për dy komponentë: Forcimi Institucional dhe Asistenca e Tranzicionit dhe Bashkëpunimi Ndërkufitar.

Aplikimi për statusin e vendit kandidat në BE do të bëhet në bashkëpunim me vendet partnere anëtare të BE-së dhe Komisionin Evropian, brenda vitit 2009. Plotësimi i kushteve për mundësimin e marrjes së këtij statusi është sfida më e madhe për Qeverinë Shqiptare në periudhën afatmesme.

1.1 INTEGRIMI NË BASHKIMIN EUROPIAN

Në 12 qershor 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Bazuar në Raportin Vjetor 2007 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, por edhe të raporteve të përgatitura nga Qeveria Shqiptare, treguesit kryesorë të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE paraqiten si vijon:

Situata politike	
Demokracia dhe shteti ligjor	Klima politike në vend ka njohur zhvillime pozitive, në frymën e debatit konstruktiv dhe konsensusit për reforma të rëndësishme të Procesit të Integrimit Evropian, të tilla si reforma elektorale dhe reforma e gjyqësorit. Në vijim të konsultimeve të gjera politike, diskutimeve dhe debateve në Kuvendin e Shqipërisë u ndërmor iniciativa ligjvënëse kushtetuese për përcaktimin e sistemit të ri elektorale në Republikën e Shqipërisë dhe amendamente të tjera kushtetuese të lidhura me të. Amendamentet e propozuara kishin në fokusin e tyre ndryshimin e modelit të sistemit zgjedhor të përcaktuar në Kushtetutë nga Sistemi Proporcional Miks në Sistemin Proporcional me Zona Zgjedhore Shumëmërore (Proporcional Rajonal). Hartimi dhe përgatitja e ligjit të ri <i>“Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”</i> ka sjellë risi në zhvillimin e reformës në sistemin e drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe është punuar edhe për projektligje të tjera të rëndësishme, si: <i>“Mbi Administratën Gjyqësore”</i>, projektligji <i>“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative”</i>, ndryshimet në ligjet <i>“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”</i>, <i>“Për noterinë”</i>, <i>“Për avokatinë”</i>, <i>“Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD)”</i>, të cilat janë në proces. Gjithashtu, është hartuar edhe një paketë ligjore me elementë të rëndësishëm që do të çojnë në reformimin e mëtejshëm të gjyqësorit, të tillë si: krijimi i gjykatave administrative; ndryshime në Kodin Penal për përmirësimin e kuadrit ligjor mbi veprat penale të krimit informatik; ligji për administratën gjyqësore; ligji për ndihmën gjyqësore; ndryshime në ligjin për organizimin dhe funksionimin e KLD-së, ligjin e Noterisë, dhe të Avokatisë, Shërbimit Përmbarimor, Sistemit Penitenciar; harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën civile e tregtare përfshi trajnimin e gjyqtarëve shqiptarë për çështjet tregtare. Për të krijuar kushte dhe procedura më të përshtatshme për dhënien e drejtësisë, ndëshkimin e rasteve abuzive, si dhe trajtimin e të dënuarve në përputhje me normat europiane janë realizuar: aplikimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në rrugë elektronike; inspektimi i gjykatave dhe prokurorive si edhe rritja e efikasitetit të procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile. Referuar këtij treguesi, Shqipëria ka një performancë më të mirë se vendet e tjera të rajonit, përveç Malit të Zi.
Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	Për sa i përket ratifikimit të instrumenteve të të drejtave të njeriut, Shqipëria ka ratifikuar Protokollin 13 të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut, në lidhje me heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat. Shqipëria është rreshtuar në Kombet e Bashkuara krahas nismës së Italisë dhe Bashkimit Evropian për heqjen e dënimit me vdekje, duke miratuar edhe ligjin përkatës në vitin 2006. Është ndryshuar Kodi Penal Ushtarak: Ligji 9722 datë 30.04.2007 <i>“Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8003, datë 28.09.1995 “Kodi Penal Ushtarak i RSH-së”</i> miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është hequr dënimi me vdekje, i cili ka qënë i parashikuar si masë dënimi në rastet e kryerjes së veprave të rënda penale ushtarake në kohë lufte nga subjektet e përcaktuara në këtë kod. Shtesat dhe ndryshimet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë përforcojnë garancitë ligjore për ushtrimin e fjalës së lirë në Shqipëri, duke bërë disa saktësime që synojnë interpretimin dhe zbatimin e drejtë të institutit të dëmit moral. Ndryshimet në Kodin Civil garantojnë mbrojtje të mjaftueshme të dinjitetit dhe reputacionit të individit.

	Përkufizimi i torturës: Shqipëria ka ratifikuar Protokollin Opsional (OPCAT) të Konventës së OKB për Parandalimin e Torturës. Në përputhje me kërkesat e Protokollit, Shqipëria ka krijuar Mekanizmin Kombëtar për parandalimin e torturës, i cili është pranë Avokatit të Popullit. Në lidhje me raportin e Konventës së OKB-së Kundër Torturës janë bërë ndryshime në Kodin Penal në përputhje me Nenin 1 të Konventës. Ligji Nr. 9686 datë 26.02.2007 <i>“Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të RSH-së”</i> e përkufizon torturën në përputhje të plotë me nenin 1 të Konventës së OKB-së. Progres është arritur në zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës. Gjatë harkut kohor 2006-2007 është kryer transferimi i përgjegjësisë për qendrat e paraburgimit nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Drejtësisë. Shqipëria ratifikoi Konventën e UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjes kulturore, e cila ka hyrë në fuqi. Po bëhen përpjekje për të përmbushur angazhimet për konventën kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Në nenin 6 të Ligjit Nr. 9686 datë 26.02.2007 <i>“Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të RSH-së”</i> është parashikuar si figurë krimi e veçantë në Kodin Penal kryerja e krimeve për motive racore apo për motive të tjera diskriminuese, ku konsiderohet si rrethanë rënduese motivi i diskriminimit si motiv për kryerjen e krimit. Shumë i rëndësishëm është edhe angazhimi i Qeverisë Shqiptare për t’iu bashkangjitur iniciativës <i>“Dekada e Përfshirjes së Romëve 2005-2015”</i>, e cila ka si objektiv nxitjen e progresit dhe mirëqënies së komunitetit rom, si edhe rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje, duke u përqendruar në fushat e punësimit, arsimit dhe strehimit. Referuar këtij treguesi, Shqipëria ka një performancë të përafërt me Malin e Zi, Kroacinë dhe Kosovën, por gjendet në një stad më të përparuar se Serbia, Maqedonia dhe Bosnjë-Hercegovina (B&H).
Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar	Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar shihet në katër drejtime: (i) me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, (ii) me vendet e BE-së, (iii) me vende të tjera (me peshë në arenën ndërkombëtare dhe partnerë strategjikë, etj), (iv) dhe me organizatat/forumet shumëpalëshe rajonale, ndërkombëtare. Në 6 nëntor 2007, Shqipëria u bë anëtare në Procesin e Barcelonës, Bashkimi për Mesdheun. Përgjithësisht, Shqipëria ka vazhduar të zhvillojë marrëdhënie pozitive e tepër të veçanta me partnerët e saj rajonalë, qoftë në nivelin shumëpalësh, ashtu edhe në atë dypalësh. Qëndrimi i vazhdueshëm konstruktiv i Shqipërisë për procesin e statusit të Kosovës ka kontribuar në stabilitetin e rajonit. Në lidhje me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve (ICC), Shqipëria ruan ende një marrëveshje dypalëshe imuniteti me Shtetet e Bashkuara, që në qershor të vitit 2003, e cila lejon përjashtime nga juridiksioni i ICC-së. Kjo marrëveshje nuk përputhet plotësisht me Qëndrimet e Përbashkëta të BE-së për integritetin e Statutit të Romës, si dhe me parimet përkatëse të BE-së për marrëveshjet dypalëshe të imunitetit. Për këtë duhet të bëhen përpjekje për afrimin e kësaj marrëveshjeje me standartet dhe qëndrimin e kërkuar nga BE. Referuar këtij treguesi, Shqipëria ashtu si dhe vendet e tjera të rajonit (përjashtuar Serbinë) ka një performancë të kënaqshme.
Situata ekonomike	
Ekonomia e tregut të lirë, reformat strukturore dhe menaxhimi publik financiar	Rritja ekonomike reale gjatë vitit 2007 vlerësohet të ketë qenë rreth 6%, ku kontribuesit kryesorë janë sektorët e transportit dhe telekomunikacionit, tregtisë, hotelarisë dhe restoranteve, si dhe ai i industrisë. Norma mesatare e inflacionit vjetor për vitin 2007 rezultoi 2.9%, duke qenë mjaft pranë objektivit 3% të Bankës së Shqipërisë. Në tremujorin e dytë të vitit 2007, norma e papunësisë ka patur ulje në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku nga 13.9% ajo zbriti në 13.5%. Shkalla e hapjes së tregut shqiptar ka shënuar nivelin prej 83%. Gjatë vitit 2007,

eksportet (në mallra dhe shërbime) u rritën me 23% krahasuar me rritjen prej 19% të vitit të kaluar. Treguesi relativ i investimeve të huaja direkte ndaj PBB-së për vitin 2007 u vlerësua në 5.9%, me një rritje të konsiderueshme prej 84% në krahasim me vitin 2006.

Referuar këtij treguesi, Shqipëria gjendet në një stad të përafërt me Maqedoninë, ka një performancë më të dobët se Serbia, Mali i Zi dhe Kroacia, por më të mirë se Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova.

Në mënyrë të përmbledhur, ecuria e marrëdhënieve BE-Shqipëri gjatë periudhës 2006-2007 jepet më poshtë.

12/2007	Deri në fund të vitit 2007, MSA-ja është ratifikuar nga 15 vende anëtare të BE-së
11/2007	Miratimi formal, ndërmjet tjerash, edhe i Marrëveshjes së Lehtësimit të Vizave Shqipëri/BE në takimin e Këshillit të Ministrave të Brendshëm dhe Drejtësisë (JHA Council)
09/2007	Nënshkrimi i Marrëveshjes së Lehtësimit të Vizave
09/2007	Miratohet PKZMSA-ja 2007-2012.
12/2006	Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Përkohshme (MP) mes Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për Tregtinë dhe çështje të lidhura me të.
11/2006	Dhënia e mandatit të Komisionit Europian (KE) nga Këshilli për Politikën e Jashtme për fillimin e negociimeve me vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) për lehtësimin e vizave.
07/2006	Ratifikimi nga Parlamenti Shqiptar i MP-së mes Shqipërisë dhe Komunitetit Europian mbi tregtinë dhe çështje të lidhura me të, dhe ratifikimi i MSA-së mes Shqipërisë dhe vendeve anëtare.
07/2006	Adoptimi nga Këshilli i Rregullimit i Instrumentit të ri të Para-Aderimit (IPA) në BE. Ky instrument financiar thjeshtëson dhe strukturon asistencën e BE-së gjatë periudhës së Para-Aderimit, duke zëvendësuar instrumentat si (PHARE, ISPA, SAPARD, CARDS) që nga 1 janari 2007
06/2006	Nënshkrimi i MSA-së dhe MP-së mbi Tregtinë dhe çështje të lidhura me të në Luksemburg më 12 qershor 2006.
02/2006	Iniciimi i MSA-së në Tiranë.

Hapat e planifikuara për t'u ndërmarrë në procesin e Integritimit Evropian:

Në kuadër të përpjekjeve për të marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Qeveria Shqiptare ka paraqitur dokumentin “Vizion Strategjik për Aplikimin e Shqipërisë për Statusin e Vendit Kandidat në BE”, në të cilin parashikohen hapat që do të ndërmerren për të zbatuar me sukses Procesin e Aplikimit. Ky proces pritet të zgjasë disa muaj dhe të angazhojë plotësisht kapacitetet e administratës publike, si në terma sasiorë ashtu dhe cilësorë. Për nevoja të Procesit të Aplikimit në muajt e ardhshëm do të ngrihet infrastruktura e domosdoshme e fazës përgatitore - përcaktimi dhe trajnimi i personave të kontrollit të Përgjigjeve ndaj Pyetësorit të Komisionit Evropian, konsultimi me Ministritë e Linjës, ngritja e një mekanizmi koordinimi, logjistika, parashikimet buxhetore të nevojshme, dhe përzgjedhja e përkthyesve.

1.2 INTEGRIMI NË NATO

Shqipëria ka realizuar të gjitha objektivat për marrjen e ftesës për anëtarësim në NATO në samitin e rradhës të Bukureshtit në prill 2008, duke përmbushur kështu një nga qëllimet madhore të vendit. Përveç kësaj arritjeje të rëndësishme, sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, disa nga rezultatet e punës gjatë viteve 2006-2007 janë:

Çështjet politike	
Konsolidimi i kontrollit civil demokratik në FARSH Kontributi i Shqipërisë në misionet paqeruajtëse	Është bërë progres i qenësishëm në drejtim të reformimit të sistemit të mbrojtjes. Në Kuvend është ngritur një komision dypartiak ad hoc për çështjet e NATO-s. Në gusht 2007 është krijuar Zyra e Koordinatorit Kombëtar për NATO-n pranë Këshillit të Ministrave, që bashkërendon punën e institucioneve të ndryshme brenda ekzekutivit, duke lehtësuar bashkëpunimin midis ekzekutivit dhe Kuvendit, Presidencës dhe organeve të tjera të pavarura. Në janar 2007 është miratuar struktura e re FARSH-it, në dhjetor 2007 strategjia ushtarake dhe në nëntor 2007 ajo sektoriale e Ministrisë së Mbrojtjes. Buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes është rritur gjatë viteve 2006-2007 dhe në 2008 do të arrijë në 2% të GDP-së. Në misionin “ISAF” të udhëhequr nga NATO në Afganistan, përveç 22 trupave që vijuan dislokimin në Kabul, në korrik 2007 u dislokua për herë të parë një kontigjent shtesë prej 113 trupash në Herat. Ndërkaq, në kuadrin e Kartës së Adriatikut “US-A3” ka vijuar dislokimi i Ekipit të Përbashkët Mjekësor, i angazhuar në mision që në vitin 2005. Në misionin “Liria e Irakut” vijoi angazhimi me një kontigjent prej 123 trupash në Mosul. Në misionin ALTHEA të BE-së në B&H janë angazhuar 71 trupa. Në misionin “UNOMIG” në Gjeorgji vijoi prania e 2 vëzhguesve ushtarakë. Është rritur pjesëmarrja e oficerëve shqiptarë në strukturat e NATO-s, duke arritur në 11 numri i oficerëve në Shtabin e Partneritetit (PSE).
Çështjet ushtarake	
Reforma e mbrojtjes dhe realizimi i objektivave për anëtarësim në NATO Zbatimi i Sistemit të Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes	Në vitin 2007 u kalua në strukturën e re të FARSH-it, e cila është një strukturë më e vogël, por më profesioniste dhe e ndërveprueshme me NATO-n. Në këtë mënyrë u konsolidua komandim-kontrolli në nivel strategjik (MM/SHP), si dhe komandimi operacional dhe ekzekutimi i decentralizuar në nivelet e Komandës së Forcës së Bashkuar, Komandës së Doktrinės dhe Stërvitjes dhe Komandës Mbështetëse. Vënia në zbatim e Objektivave të Partneritetit me NATO-n: Nga 43 objektiva të paketës së Objektivave të Partneritetit 2006 u realizuan plotësisht 13 dhe pjesërisht 30. U deklaruan edhe 3 nënreparte të tjera në dispozicion të NATO-s, në kuadrin e zbatimit të Konceptit për Kapacitetet Operacionale (OCC). U miratua Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA-së për periudhën 2007-2020. Rritja e buxhetit të mbrojtjes me 2% të GDP-së u bë dy vjet para afatit të parashikuar, duke përshpejtuar procesin e integrimit në NATO.

Shkatërrimi i armëve të vogla dhe të lehta	Për periudhën 2006-2007 u shkatërruan 22.481 ton municione si dhe 23.819 armë këmbësorie. Në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe, po punohet me vendet e Aleancës dhe atyre Partnere për zhvillimin e programeve të eliminimit të municioneve të tepërta dhe armëve të vogla e të lehta. Shqipëria ka shkatërruar të gjithë agjentët/materialet kimikë në korrik 2007, duke u bërë i pari vend në botë që ka plotësuar detyrimin e vet sipas Konventës së OKB-së për Ndalimin e Armëve Kimike. Shqipëria është e angazhuar plotësisht që, në vitin 2010, sipas afateve që përcaktohen në nenin 5 të Konventës së OKB për ndalimin e Minave (Konventa e Otavës) të pastrojë të gjitha minat brenda territorit të saj. Me këtë rast, Shqipëria do të vazhdojë të bashkëpunojë me vendet donatore për të siguruar fondet e nevojshme për përfundimin e çminimit, ndërsa deklaron se ka ndërtuar kapacitetet lokale për të bërë të mundur çminimin.
--	--

Disa nga drejtimet dhe fushat ku ka patur rezultate më të mira në zbatimin e Objektivave të Partneritetit (OP) kanë qenë:

- Përmirësimi në strukturat organizative të FA-së.
- Aplikimi i formateve standarde të punës në shtabe.
- Rritja e aftësive në njohjen e gjuhës angleze.
- Vijimi i modernizimit të sistemeve dhe pajisjeve që kanë lidhje me OP-në.
- Përmirësimi i infrastrukturës në FA-së dhe aerodromeve.
- Rritja e aftësive operacionale e njësive të PfP jashtë vendit

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar vlerësimit të OP-ve me karakter kombëtar, zbatimi i të cilave kërkon angazhimin e strukturave të tjera shtetërore, si lëvizja strategjike e forcave kombëtare, mbështetja e vendit pritës (HNS), vrojtimi i hapësirës ajrore dhe detare, OP-të e kufirit.

Synimi i afërm më i rëndësishëm është tashmë anëtarësimi në NATO dhe, mekanizmi më i rëndësishëm për të vlerësuar ecurinë e reformave drejt përmubshjes së tij, është implementimi i plotë i Objektivave të Partneritetit (OP). Paketa e re OP 2006 u pranua për t'u realizuar gjatë periudhës 2006-2009.

Për vitin 2008, Shqipëria ka shprehur vullnetin politik për të kontribuar me trupa shtesë në operacionet ndërkombëtare, si më poshtë:

- Dërgimin në ISAF, në Afganistan të personelit në dy ekipe të OMLT-së
- Dërgimin në B&H të një ekipe AME (Asgjësimit të Municioneve me Eksplozivë).
- Pjesëmarrjen në operacionin EUFOR në Çad me dy toga, nën drejtimin e BE-së.
- Pjesëmarrjen në operacionin Active Endeavour, operacion i NATO-s në Detin Mesdhe, (pjesëmarrje me personel ndërlidhës/koordinues).
- Shtimi i kontigjentit me një kompani në misionin "Liria e Irakut".

1.3 PUNËT E JASHTME

Në kuadrin e marrëdhënieve me jashtë, Ministria e Jashtme është përqëndruar kryesisht në çështje të dialogut politik me vendet e BE-së dhe në rajon.

BE udhëzon autoritetet shqiptare mbi prioritetet e reformave nëpërmjet **Partneritetit Evropian**. Progresi në këto reforma kryesore inkurajohet dhe monitorohet përmes dialogut politik dhe ekonomik me Shqipërinë. Ky dialog zhvillohet nëpërmjet Trojkës Ministrorë, takimeve të komitetit të përbashkët dhe Task-Forcës Konsultative (CTF) në nivel ministror, takimet e grupit të punës në nivel zv/ministrash, takimet e përhershme të forumit BE-Ballkani Perëndimor për çështjet e brendshme dhe drejtësisë ndërmjet ministrave të brendshëm dhe të drejtësisë. Gjatë periudhës 2006-2007 ka patur një seri takimesh periodike të niveleve të ndryshme.

Në shtator 2007, BE dhe Shqipëria nënshkruan një marrëveshje për lehtësimin e vizave (MLV). Rregullimet e reja janë të rëndësishme për të lehtësuar kontaktet mes njerëzve dhe thjeshtojnë procedurat e dhënies së vizave për disa kategori të caktuara qytetarësh të Shqipërisë, ku përfshihen diplomatët, studentët, akademikët, biznesmenët, gazetarët dhe turistët. Kjo marrëveshje plotëson marrëveshjen e ripranimit KE-Shqipëri, e cila hyri në fuqi në maj 2006. MLV-ja është një hap i rëndësishëm në drejtim të dialogut për liberalizimin e vizave, që do të sigurojë lëvizjen pa viza të shqiptarëve në vendet anëtare të BE-së.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë pjesë thelbësore e procesit të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë aktive në iniciativat rajonale. Përmendim këtu Paktin e Stabilitetit dhe procesin e tranzicionit të tij në një kuadër bashkëpunimi rajonal me një Proces Bashkëpunimi të Evropës Juglindore (SEECP) të përforcuar, si dhe me Këshillin e ri të Bashkëpunimit Rajonal (RCC). Në cilësinë e saj si presidente e radhës e Iniciativës së Evropës Qendrore, gjatë vitit 2006, Shqipëria organizoi Samitin e Kryetarëve të Shteteve si dhe evenimente të tjera rajonale të përqëndruar në transport, energji dhe gazetari.

2 DEMOKRATIZIMI DHE SHTETI I SË DREJTËS

Në këtë pjesë paraqitet ecuria e Shqipërisë në lidhje me disa fusha si: sistemi i drejtësisë, të drejtat e pronës, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar, rendi publik, administrata publike dhe procesi i decentralizimit.

Përgatitja e reformës në sistemin e drejtësisë, orientuar në frymën e konsensusit politik, ka qenë një nga arritjet e periudhës 2006-2007. Është miratuar nga Parlamenti ligji për organizmin e pushtetit gjyqësor. Harmonizimi i ligjeve organike të sistemit të drejtësisë është pjesë e paketës së re ligjore, që do të nxisë reformimin e mëtejshëm të gjyqësorit.

Regjistrimi fillestar i pronave dhe pasurive të paluajtshme, si dhe procesi i legalizimit të ndërtimeve informale, do të ndikojnë në zhvillimin e tregut të tokës, si faktor i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Gjatë viteve 2006-2007 është punuar për përfundimin e hartës së vlerës së tokës, si dhe hartën e vlerës së pyjeve dhe kullotave, në të gjithë territorin e vendit. Gjithashtu, ka përfunduar fotografimi ajror, dixhital i territorit të vendit, proces i rëndësishëm jo vetëm për legalizimin por edhe regjistrimin dhe kthimin e kompensimin e pronës.

Lufta kundër korrupsionit ka shënuar disa arritje që pasqyrohen në përmirësimin e treguesit “Perceptimi i Korrupsionit” i Transparency International, duke renditur Shqipërinë në një pozicion më të lartë krahasuar me vitin 2005. Megjithatë, është i nevojshëm reformimi i mëtejshëm i sistemit të drejtësisë për të luftuar korrupsionin, i shërbimeve shëndetësore dhe konsolidimi i praktikave të mira në prokurimin publik, tatimet dhe doganat.


Në luftën kundër krimit të organizuar ka pasur përmirësime të cilat janë shprehur në rënien e vlerës së treguesit të numrit të personave të trafikuar në krahasim me vitin 2005. Siguria publike dhe roli i policisë janë rritur jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë rajonin e Ballkanit, ashtu siç e vë në dukje raporti i Zyrës për Drogën dhe Krimin, e Kombeve të Bashkuara (UNODC) në mars 2008.

Sfida për një administratë publike të përgatitur dhe të aftë për të realizuar zbatimin e nismave dhe reformave të rëndësishme për integrimin e vendit në NATO dhe në BE është në mënyrë të vazhdueshme në qendër të politikave të qeverisë. Përmirësimet gjatë viteve 2006-2007 në administratën publike janë shprehur edhe në Raportin e Progresit të BE-së 2007, përse i përket ndryshimeve strukturore dhe ruajtjes së memories institucionale. Hapat e mëtejshëm në drejtim të zbatimit të Ligjit të Shërbimit Civil dhe përfundimit të zbatimit të sistemit elektronik të menaxhimit të burimeve njerëzore (HRMIS) do të forcojnë profesionalizimin në administratën publike.

Procesi i decentralizimit ka ecur me hapa të ndjeshëm, pasi janë hedhur bazat ligjore dhe institucionale për një transferim të kompetencave nga pushteti qendror drejt pushtetit vendor, në përputhje me parimet e kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Gjatë viteve 2006-2007 është punuar për të përgatitur procesin e transferimit të pronave, të pyjeve dhe kullotave, të pronës shtetërore, të shoqërive të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore. Në vitin 2007 u realizua transferimi i taksës mbi fitimin për biznesin e vogël nga administrata qendrore në atë vendore, duke i krijuar një hapësirë më shumë pushtetit vendor për të ardhurat e tij. Konsolidimi i procesit të decentralizimit, plotësimi i skemës financiare të nevojshme, si dhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për të përballuar përgjegjësitë e reja, mbeten sfidat për të ardhmen.

2.1 DREJTËSIA

Treguesi: Shteti i së drejtës, krahasuar me vendet e EJT-së



Burimi: Treguesit e Qeverisjes, Instituti i Bankës Botërore

Reforma e sistemit të drejtësisë është një hap i domosdoshëm për forcimin e shtetit ligjor, forcimin e besimit të qytetarëve të drejtësisë dhe luftën pa kompromis kundër korrupsionit. Duke iu referuar Raportit të Progresit të Komisionit Europian të vitit 2007, në fushën “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, thuhet se edhe pse Shqipëria ka bërë përmirësime, ka ende vend për përparime të ndjeshme. Ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor është miratuar tashmë nga Parlamenti Shqiptar. Ky ligj i ri është një ndër instrumentet themelore të gjyqësorit, që përcakton organizimin dhe kompetencat e gjykatave, procedurat për emërimin e gjyqtarëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe procedimin disiplinor. Gjithashtu, është hartuar edhe një paketë ligjore me elementë të rëndësishëm që do të çojnë në reformimin e mëtejshëm të gjyqësorit, të tillë si: krijimi i gjykatave administrative; ndryshime në Kodin Penal për përmirësimin e kuadrit ligjor mbi veprat penale të krimit informatik; ndryshimi i hartuar për shërbimin e provës dhe masat alternative të dënimit; ndryshimi i hartuar në Kodin e procedurës Civile i cili është hartuar në formën e paketës së bashku me ligjin për shërbimin e përmbartimit; ligji për administratën gjyqësore; ligji për ndihmë gjyqësore; ligjin e noterisë, ligjin e avokatisë, ligjin e shërbimit përmbartimor, ligjin e sistemit penitenciar; harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën civile e tregtare, përfshi trajnimin e gjyqtarëve shqiptarë për çështjet tregtare.

Për të krijuar kushte dhe procedura më të përshtatshme për dhënien e drejtësisë, ndëshkimin e rasteve abuzive, si dhe trajtimin e të dënuarve në përputhje me normat europiane, janë realizuar: aplikimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në rrugë elektronike; inspektimi i gjykatave dhe prokurorive; rritja e efikasitetit të procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile (në vitin 2005 janë ekzekutuar 5,831 çështje ose rreth 90% të çështjeve në total i është dhënë zgjidhje ligjore; në vitin 2006 janë ekzekutuar 5,511 çështje ose rreth 94.8% të çështjeve i është dhënë zgjidhje ligjore; në vitin 2007 janë ekzekutuar 5,031 çështje ose rreth 92% të çështjeve i është dhënë zgjidhje ligjore); instalimi i sistemit online në zyrat e përmbartimit në të gjithë vendin për vitet 2008-2009; ndërtimi i burgjeve dhe i paraburgimeve të reja, si dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së të burgosurve.

Një nga treguesit që vlerëson funksionimin e sistemit gjyqësor është treguesi “shteti i së drejtës”, i cili mat “cilësinë e vënies në jetë të kontratave, policinë dhe gjykatën, gjithashtu edhe probabilitetin e krimit dhe të dhunës”. Ky tregues është pjesë e treguesve të qeverisjes, të cilët që nga viti 2006 maten nga Instituti i Bankës Botërore çdo dy vite. Këta tregues janë subjektivë, pasi ata mbështeten në opinione specialistësh, perceptime dhe mbi një sërë pikëpamjesh të studiara, të cilat mbledhen duke përdorur teknika statistikore. Megjithatë, ata janë të dobishëm për të studiuar prirjet afatgjata dhe për të bërë krahasime me vendet e tjera.

Në grafikun më sipër tregohet renditja e Shqipërisë për këtë tregues (në pjesën e majtë) për harkun kohor 1996-2007. Përveç vitit 1996, kur Shqipëria kishte një pozicionin më të mirë në 50%-shin më të ulët

të vendeve (maksimumi dhe vlerësimi më i mirë për treguesin është 100%), në vitet në vijim ajo ra në 20%-shin e fundit. Megjithëse prirja është për një rritje të nivelit, krahasuar me vende të tjera në rajon (panelin e djathtë), Shqipëria renditet në një nivel më ulët. Për këtë do të ndërmerren masa në lidhje me përsheptimin e procedurave gjyqësore dhe trajtimin e tyre në mënyrë transparente. Gjithashtu, është i nevojshëm forcimi i kapaciteteve hetuese të prokurorisë, si edhe miratimi i ndryshimeve ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve.

2.2 TË DREJTAT E PRONËS

Treguesi: Numri i pronave që kanë marrë një certifikatë legalizimi

Përfundimi i proceseve që kanë të bëjnë me regjistrimin, kthimin dhe kompensimin e pronës si dhe me legalizimin e ndërtimeve informale, është një nga çështjet më të rëndësishme për ekonominë e vendit dhe për garantimin e të drejtave të individëve. Rritja ekonomike pengohet nga paqartësia në lidhje me të drejtat e pronësisë, prandaj ecuria drejt zgjidhjes së tyre është shumë e rëndësishme.

Një nga treguesit e rëndësishëm për ecurinë e procesit të regjistrimit të pronës është regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme. Gjendja aktuale e regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme për të gjithë vendin dëshmon për 11 zona kadastrale urbane dhe 1 zonë rurale regjistruar gjatë harkut kohor 2006-2007. Numri i përgjithshëm i pasurive që do t'i nënshtrohen regjistrimit fillestar është 500,000 në zonat kadastrale urbane për vitet 2007-2011. Në një periudhë afatshkurtër parashikohet të realizohet regjistrimi fillestar për 23 zona kadastrale, që përbëjnë rreth 150,000 pasuri, në Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Lushnjë, Kavajë, Shkodër, Sarandë. Gjithashtu, për këtë periudhë parashikohet edhe përfshirja në sistem e zonave kadastrale, si në Mallakastër, Malësi e Madhe, Sarandë, Has, Kukës, Korçë, ku regjistrimi fillestar nuk ka përfunduar për shkak të problemeve teknike.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i çështjes së pronës është përfundimi i procesit të legalizimit të ndërtimeve informale. Gjatë viteve 2006-2007 janë pajisur me "Leje Legalizimi" 127 pasuri informale të vendosura në Qarkun e Tiranës dhe të Lezhës, të cilat janë përfshirë gjithashtu në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, është përgatitur dokumentacioni teknik për rreth 53,000 pasuri informale. Ka përfunduar fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është përpunuar produkti i përfutur prej tij, duke prodhuar ortofoto dhe harta vektor të domosdoshme për procesin e legalizimit dhe të urbanizimit.

Parashikohet që, nga një numër total prej rreth 350,000 pasurish informale të përfshira në procesin e legalizimit në të gjithë vendin, të realizohet pajisja me "Leje Legalizimi" dhe regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme i 200,000 pasurive deri në fund të vitit 2008. Nëpërmjet përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm, përpunimit të informacionit hartografik, si dhe krijimit, ruajtjes, analizimit e menaxhimit të të dhënave të objekteve informale, do të bëhet i mundur formalizimi dhe përfshirja e tyre në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Ndërkohë, janë ndërmarrë hapa të rëndësishme në lidhje me kuadrin ligjor për të drejtat e pronës. Kështu, janë miratuar me ligj ndryshimet lidhur me rikonceptimin e institucionit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) në disa fusha të veprimtarisë së tij, në funksion të qartësimit të procedurave lidhur me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-subjekteve të shpronësuar.

Gjithashtu, po me disa ndryshime në kuadrin ligjor ekzistues u përcaktuan përgjegjësitë e institucionit të AKKP-së në qendër, si dhe procedura e ankimit ndaj vendimit të zyrave rajonale të Agjencisë. Më tej, janë miratuar ndryshime në legjislacion që parashikojnë përcaktimin e procedurave të qarta dhe të thjeshtuara në lidhje me lëshimin e dokumenteve të kërkuara pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme; eliminimin e hapësirave ligjore që më parë lejonin abuzime në procesin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe krijonin mbivendosje të pasurive, etj. Ndërkohë, është hartuar një draft paraprak mbi përcaktimin e procedurave të krijimit të një fondi për kompensimin fizik të ish-pronarëve për pronat që janë nën administrimin e institucioneve shtetërore. Për periudhën në vijim mbetet në qendër të vëmendjes përfundimi i draftit të strategjisë ndërsektoriale mbi të drejtat e pronës, e cila orienton politikat qeveritare për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, si edhe miratimi i saj në Këshillin e Ministrave. Me përparësi do të shihet: (i) regjistrimi fillestar në zonat urbane dhe ato që kanë përparësi zhvillimi ekonomik; (ii) dixhitalizimi i të dhënave në një pjesë të zyrave; (iii) përpilimi i hartës së vlerës së tokës; (iv) regjistrimi i pasurive shtetërore; (v) legalizimi i zonave dhe ndërtimeve informale. Gjithashtu, një sfidë do të përbëjë edhe problemi i trajtimit të pronësisë si një i vetëm, që përfshin regjistrimin, rikthimin dhe kompensimin dhe legalizimin, si edhe ruajtjen e mbrojtjen e pronës. Kjo gjë do të ndihmojë në zhvillimin e një tregu funksional dhe në rritjen e investimeve të huaja. Ndërkohë, me rëndësi shihet edhe hartimi i një inventari të tokave të caktuara për kompensim.


2.3 ANTI-KORRUPSIONI

Treguesi: Kontrolli i korrupsionit (%)

Shqipëria ka bërë një progres të mirë në zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s 2002 (Grupi i Shteteve të Këshillit të Europës kundër Korrupsionit), megjithëse masat për forcimin e gjyqësorit kundër korrupsionit konsiderohen të vonuara. Sipas Raportit të Progresit të Komisionit European 2007, korrupsioni është i përhapur dhe përbën një problem serioz në Shqipëri. Progres është arritur në drejtim të miratimit të legjislacionit të ri për prokurimin publik, si dhe masat për forcimin e pavarësisë dhe transparencës së Agjencisë së Prokurimit Publik. Janë fuqizuar kapacitetet institucionale për hetimin dhe procedimin e korrupsionit, me ngritjen e një task-force të re në prokurori kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik, e cila bashkërendohet me policinë dhe strukturat e shërbimit sekret. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Auditimin e Pasurisë shënoi progres në imponimin e detyrimeve për deklarim pasurie. Nga 3,500 persona që me ligj janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre, vetëm 87 nuk e kanë plotësuar këtë detyrim.

Progres i mëtejshëm kërkohet në zbatimin e grupit të dytë të rekomandimeve të GRECO-s të vitit 2005, si dhe harmonizimi i plotë i Kodit Civil, Tregtar dhe Administrativ me Konventën e Ligjit Civil të Evropës për Korrupsionin. Ligji për konfliktin e interesit ka nevojë të sqarohet më tej.

Treguesi i kontrollit të korrupsionit, një tjetër tregues i grupit të treguesve të qeverisjes, mat “ushtrimin e pushtetit publik për përfitime personale, duke përfshirë korrupsionin e vogël dhe të madh, si dhe fenomenin e “kapjes së shtetit”.



Burimi: Treguesit e Qeverisjes, Instituti i Bankës Botërore

Në grafikun më sipër tregohet ecuria e treguesit të qeverisjes të Bankës Botërore për Shqipërinë për periudhën 2006-2007, krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Që prej vitit 1998, ky tregues është përmirësuar lehtë dhe shumë ngadalë nga viti në vit, për të arritur në vlerën 36.7% në 2007. Në panelin e djathtë krahasohen nivelet e treguesit të kontrollit të korrupsionit në vitin 2007 midis vendeve të rajonit, ku Shqipëria paraqitet në një pozicion të ulët në krahasim me to.

Përsa i përket indeksit të perceptimit të korrupsionit të matur nga organizata “Transparency International”, vlera e tij është përmirësuar ndjeshëm, pasi në 2005 Shqipëria pozicionohej në vendin e 126-të, ndërsa në 2006 në vendin e 111-të, dhe në 2007 në vendin e 105 në renditjen botërore të perceptimit të këtij indeksi (pozicionet më të larta tregojnë për një nivel të lartë të perceptimit të korrupsionit).

Për vitin në vazhdim, përparësitë kryesore në të cilat do të përqëndrohen politikat janë: zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin, Luftën kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente; përshtatja e legjislacionit të brendshëm me të gjitha standardet e vendosura nga konventat kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara; ulja progresive e pengesave administrative; rritja e forcës zbuluese dhe ndëshkuese ndaj rasteve të korrupsionit. Një rëndësi të madhe do të ketë ngritja e çështjes së imunitetit të zyrtarëve publikë dhe deputetëve në lidhje me hetimin dhe procedimin penal, si edhe miratimi i ligjit për financimin e partive politike, i cili do të përmirësojë mënyrën transparente të financimit të tyre.

2.4 KRIMI I ORGANIZUAR

Treguesi: Trafikimi i qënieve njerëzore

Hapat e ndërmarrë gjatë viteve 2006-2007 në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të kontrollit të kufirit, të përmirësimit të legjislacionit dhe adoptimit të teknikave të reja investigative, të reformimit të strukturave policore përgjegjëse për luftën kundër krimit të organizuar, si dhe të thellimit të bashkëpunimit policor me vendet e rajonit e më gjerë, kanë krijuar kushtet për një luftë më me efektivitet në këtë drejtim. Me miratimin e ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, kapacitetet institucionale dhe strukturore për goditjen e krimeve në fushën financiare, korrupsionit dhe pastrimit të parave janë përmirësuar ndjeshëm.

Në Raportin e Progresit të Komisionit European në nëntor 2007 thuhet se “përparim jo i njëtrajtshëm është shënuar në luftën kundër krimit të organizuar, një prioritet kyç i Partneritetit European. Krimi i organizuar vazhdon të mbetet një problem shumë serioz në Shqipëri”.

Përsa i përket trafikimit të qënieve njerëzore, në Raportin e Progresit të BE-së thuhet se “ka pasur disa përparime në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, të cilën qeveria ka vazhduar ta hetojë dhe ta ndjekë penalisht në mënyrë të vendosur”. Statistikat tregojnë se vit pas viti ka një rënie të theksuar të fenomenit të trafikimit të qënieve njerëzore në vend, gjë që është si pasojë e masave të marra për rritjen e efektivitetit të kontrolleve kufitare, përmirësimin e bashkëpunimit me vendet fqinje, si edhe ndryshimeve në kodin penal për të penalizuar trafikimin e qënieve njerëzore. Gjithashtu, është hapur një numër telefoni kombëtar pa pagesë në ndihmë të viktimave të trafikimit. Për të koordinuar punën për të luftuar trafikun e qënieve njerëzore është ngritur Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, pranë të cilit vepron njësisia antitrafik. Gjithashtu, është ngritur struktura e “Autoritetit Përgjegjës”, e cila bashkërendon veprimet e tre ministrive të përfshira në marrëveshje, MB, MPÇSSHB dhe MPJ. Në nivel rajonal janë ngritur Komitetet Rajonale kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore në të gjitha qarqet. Me qëllim përfundimtar të një informacioni zyrtar të unifikuar, pranë Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, si dhe pranë Drejtorisë kundër Krimit të Organizuar, është instaluar një bazë të dhënash për viktimat e trafikimit me të dhëna nga policia, shërbimi diplomatik shqiptar, shërbimi social shtetëror, si dhe nga agjensitë e ndihmës të drejtpërdrejtë.

Sipas të dhënave që disponon Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar në Policinë e Shtetit, gjatë vitit 2006 janë identifikuar 25 viktima të trafikut, ndërsa në vitin 2007 janë identifikuar gjithsej 12 viktima. Duke iu referuar Raportit të Departamentit të Shtetit Amerikan mbi trafikimin e qënieve njerëzore (periudha 2006-2007), gjatë vitit 2006 në Shqipëri në Gjykatën e Krimeve të Rënda u trajtuan 62 raste që lidhje me trafikimin dhe u dënuan 57 persona. Ndërkohë, në Maqedoni, për të njëjtën periudhë janë ndjekur penalisht 48 raste trafikimi; në Kroaci janë iniciuar 10 hetime ndaj 17 personave; në Bullgari dhe Itali, janë iniciuar përkatësisht çështje penale ndaj 129 personave dhe 784 trafikantëve të dyshuar.

Në tabelën më poshtë jepen disa të dhëna për numrin e personave të trafikuar:

Viti	Trafikimi i femrave	Trafiku i të miturve
2007	12	3
2006	25	4
2005	30	7
2004	84	10

Burimi: Drejtoria e Krimit të Organizuar

Në luftën kundër drogës, gjatë viteve 2006 dhe 2007 janë arritur disa rezultate të mira në drejtim të goditjes së rrjeteve kriminale që merren me trafikun e heroinës, kokainës dhe marijuanës. Sasitë e drogave të sekuestruara dhe numri i personave të arrestuar në vendin tonë kanë ardhur në rritje. Në vitin 2006 u identifikuan 453 raste, nga të cilat janë zbuluar 341 dhe janë arrestuar 473 persona, ndërsa në 2007, 524 raste, nga të cilat janë zbuluar 314 dhe janë arrestuar 406 persona. Gjatë së njëjtës periudhë janë realizuar edhe 13 operacione ndërkombëtare në bashkëpunim me prokurorinë

dhe autoritetet gjyqësore të vendeve të ndryshme, Itali, Gjermani, Turqi, Maqedoni, Zvicër, dhe SHBA. Sipas raportit të Zyrës për Drogën dhe Krimin të Kombeve të Bashkuara (UNODC) të mars 2008, në të gjithë rajonin e Europës Juglindore ka një pakësim të formave të ndryshme të krimit të organizuar, që ishin shumë më të zhvilluara gjatë viteve të tranzicionit dhe konflikteve. Në këtë kuadër do të ndërmerren hapa për miratimin e akteve nënligjore të ligjit për pastrimin e parave, si edhe të forcohen kapacitetet e Drejtorisë së Pastrimit të Parave. Koordinimi dhe bashkëpunimi me zyrën e prokurorisë përbën një rëndësi të madhe dhe në këtë kuadër duhet të forcohet më tej bashkëpunimi në nivel operacional. Për trafikimin e qenieve njerëzore do të vazhdohen përpjekjet në fushën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit.


2.5 RENDI PUBLIK

Treguesi: Shkelje penale për 100,000 banorë (përfshirë shkeljet e kundërvajtjeve në trafik) krahasuar me disa vende europiane të përzgjedhura

Disa përparime të mira, por jo të njëtrajtshme, janë bërë në fushën e policisë, thuhet në Raportin e Progresit të Komisionit Europian 2007. Ligji i ri për policinë e shtetit ishte një hap i rëndësishëm drejt depolitizimit të policisë. Megjithatë, thuhet në këtë raport, kapacitetet policore për të parandaluar dhe për të regjistruar krimin mbeten të dobëta. Për të kapërcyer vështirësitë dhe për të përmirëuar rezultatet, ndërmarrja e reformës në fushën legjislative, organizative, strukturore dhe teknologjike, si dhe rritja e nivelit të sigurisë në të gjithë territorin e vendit, është orientuar drejt arritjes së rezultateve konkrete, si dhe drejt konceptit të policimit në komunitet.

Gjatë vitit 2006 në Shqipëri, Policia e Shtetit ka regjistruar 9,009 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 7,052 ose 78% dhe ky tregues për 100,000 banorë është 257 vepra penale. Ndërsa, gjatë vitit 2007, Policia e Shtetit ka regjistruar 10,036 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 7,920 prej tyre ose 79% dhe ky tregues për 100,000 banorë është 287 vepra penale.

Bazuar në Raportin mbi të Dhënat e Krimit dhe Drejtësisë Kriminale (European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics), të publikuar nga Këshilli i Europës në vitin 2006, që mbulon vitet 2000-2003, në grafikun më poshtë jepen këto të dhëna për Shqipërinë dhe vende të tjera të rajonit.




Burimi: European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics, 2006

Raporti i ardhshëm i Këshillit të Europës për statistikën që kanë të bëjnë me krimin dhe drejtësinë kriminale do të botohet në vitin 2009 dhe do të mbulojë vitet 2003-2007.

2.6 ADMINISTRATA PUBLIKE

Treguesi: Numri i ankimeve në lidhje me zbatimin e ligjit mbi Shërbimin Civil, sipas llojit



Burimi: Komisioni i Shërbimit Civil

Duke iu referuar Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian për vitet 2006 dhe 2007, vërehet një ndryshim dhe përmirësim i situatës që ka të bëjë me Administratën Publike në këto dy vite. Në Raportin e Progresit për vitin 2007 thuhet se “Qeveria e re ka bërë ndryshime të konsiderueshme në administratën publike nga ana strukturore, si dhe ekspertiza dhe kujtesa institucionale është stabilizuar dhe Ministritë i kanë dhënë përparësi më të madhe politikave dhe strategjive”.

Një nga treguesit e ecursë në reformat për administratën publike është edhe numri i ankimeve në lidhje me zbatimin e ligjit mbi shërbimin civil. Ky tregues paraqet si prirje përmirësime në zbatimin e ligjit. Grafiku më sipër paraqet ankesat në lidhje me zbatimin e ligjit të shërbimit civil, të kategorizuara sipas objektit të ankesave. Në vlerë absolute, numri i ankesave për vitin 2006 është 737 dhe për vitin 2007 është 380 ankesa, ku viti 2006 bën përjashtim në prirjet e sektorit, pasi dyfishimi i ankesave paraqitet edhe si rezultat i ristrukturimit të administratës qendrore. Në grafikun më sipër, ankesat me objekt masë disiplinore ulen nga 61.2% për 2006 në 42% për vitin 2007. Për të dy vitet, në ankesat me objekt masën disiplinore pjesa më e madhe është për largim nga shërbimi civil, sidomos në sektorin e doganave dhe tatimeve, me 45% të rasteve për vitin 2006 dhe 49% për vitin 2007. Për administratën qendrore, ankesat gjatë periudhës paraqiten në ulje, ku nga 37% për vitin 2006 zbresin në 20% për vitin 2007. Emërimet nga lista e pritjes pësojnë rritje të konsiderueshme me 25% më shumë në 2007 krahasuar me 2006.

Në lidhje me fushën e pagave, sipas Departamentit të Administratës Publike, gjatë periudhës 2006-2007 është realizuar unifikimi i sistemit të pagave në pjesën më të madhe të institucioneve dhe grupeve të nëpunësve, si dhe një rritje pagash mesatarisht 19.8% në vitin 2006 dhe 15% në vitin 2007. Ndërkohë, në vitin 2007, nëpunësve civilë/nëpunësve me kualifikime pasuniversitare, grada e tituj shkencorë u është njohur e drejta e përfitimit të një shtese, kur kualifikimi përkatës është në përputhje me përshkrimin e vendit të punës.

Në drejtim të përmirësimit të transparencës së administratës dhe krijimit të sistemit modern të menaxhimit të burimeve njerëzore ka përfunduar faza e parë e hedhjes së të dhënave në Regjistrin Qendror të Punonjësve të Administratës Publike. Miratimi i strategjisë ndërsektoriale të reformës për administratën publike do të krijojë themelin për orientimin e politikave për forcimin e mëtejshëm të administratës publike, si parakusht jetik për përballimin e sfidave integruese të vendit.

Gjithashtu, do të rishikohet dhe zbatimi i legjislacionit të shërbimit civil, si edhe do të forcohen kapacitetet e (ITAP) dhe Departamentit të Administratës Publike në drejtimin e shërbimit civil, drejt një administrate të pavarur, bazuar mbi meritë dhe profesionalizëm. Për këtë qëllim, me përparësi po

ndiqet zhvillimi i trajnimit dhe kualifikimit të nëpunësve civilë, në drejtim të planifikimit strategjik dhe bërjes së politikave zhvilluese. Zbatimi i projektit të “Brain Gain” financuar nga UN po jep një ndihmesë shumë të madhe në këtë aspekt. Funksionet e njësive të integrit Evropian në të 13 Ministritë e Linjës do të standartizohen dhe do të përgatiten programe të specializuara trajnimi për çështje që kanë të bëjnë me integrimin në BE.

2.7 DECENTRALIZIMI

Treguesi: Përbushja e parimeve të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore

Reforma për një sistem të qëndrueshëm administrativ dhe fiskal të decentralizuar për harkun kohor 2006-2007 është mbështetur në përbushjen e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, si edhe parimeve të kushtetutës. Proceset që janë zhvilluar në kuadër të reformës kanë synuar në rradhë të parë transferimin e përgjegjësisë dhe kompetencave sipas parimit të “subsidiaritetit”, që do të thotë që vendimet brenda strukturave qeverisëse duhet të merren sa me afër qytetarëve.

Brenda kësaj periudhe është hartuar kuadri ligjor bazë për zbatimin e reformës së transferimit të pronësisë drejt njësive të qeverisjes vendore, i cili përfshin miratimin e 468 akteve nënligjore. Nga këto, 214 VKM kanë të bëjnë me miratimin e listës së inventarëve të njësive të qeverisjes vendore, 61 VKM të tjera me miratimin e listës paraprake për kalime në pronësi apo në përdorim, si dhe 14 VKM për miratimin e listës përfundimtare të pronave që kalojnë në përdorim apo pronësi. Gjithashtu, janë në proces për t’u miratuar edhe 63 projektvendime të tjera për proceset në vijimësi. Ndërkohë, po vazhdon me ritme të përshpejtuara transferimi i pronave publike njësive të pushtetit vendore, që pritet të përmbyllet brenda periudhës 2008-2009.

Në lidhje me transferimet tek njësitë e qeverisjes vendore, ka përfunduar transferimi i shoqërive të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, duke u bazuar mbi parimin e moscopëzimit të sistemit dhe të ruajtjes së zonave të shërbimit. Si rrjedhojë, janë ngritur 25 shoqëri të ujësjellës-kanalizimeve, të cilat funksionojnë mbi bazën e një strukture dhe rregulloreje të përcaktuar. Gjatë periudhës 2006-2007 janë miratuar 169 VKM për transferimin e pyjeve dhe kullotave drejt njësive të qeverisjes vendore, i cili është një proces që ka përfunduar.

Ushtrimi i mandatit të të zgjedhurve vendore është ndryshuar në 4 vjet, duke dhënë kështu mundësi për zhvillim të konsoliduar vendor nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve dhe strategjive afatgjata. Nga ana teknike janë bërë ndryshimet përkatëse në Kushtetutë, pas një procesi të gjerë konsultimesh me gjithë aktorët e interesit.

Në lidhje me financat vendore është synuar që pushteti vendor të ketë mjetet e domosdoshme financiare për të ushtruar funksionet e përcaktuara me ligj. Në aspektin legjislativ është miratuar Ligji mbi “Huamarrjen Vendore” dhe është në proces projektligji “Për Financat Vendore”. Njëkohësisht, janë miratuar edhe aktet nënligjore të nevojshme për një skemë të veçantë granti në mbështetje të qeverisjes vendore.

Granti për pushtetin vendor është rritur. Për vitin 2007, transferta e pakushtëzuar është 12.625 miliard Lekë, me një rritje prej 1,359 miliard Lekë ose 10.7% më shumë se një vit më parë. Ndërkohë, rritja në total e granteve për vitin 2007 është 124% në krahasim me vitin 2006, dhe në vlerë absolute 2,6 miliard Lekë më shumë. Krahasuar me vitin 2005, ku granti ishte 7.3 miliard Lekë, për vitin 2007 granti është rritur me 58%.

Sfidë e sektorit mbetet përvijimi i thellimit të mëtejshëm të procesit, ku synohet forcim i vetëqeverisjes financiare vendore, sidomos në drejtim të përmirësimit të funksionimit të granteve. Në kuadër të decentralizimit do të ndërmerren nisma për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, sidomos në lidhje me zyrat e tatim-taksave, me qëllim rritjen e nivelit të mbledhjes së tyre, si edhe do të rritet bashkëpunimi me biznesin për të lehtësuar zbatimin e reformës së taksave. Gjithashtu, në qendër të vëmendjes do të jetë edhe transferimi i përgjegjësisë për fushat e shërbimit të kujdesit parësor, arsimit parauniversitar, me qëllim sigurimin e shërbimeve sa më cilësore pranë qytetarëve. Më tej, do të synohet përmbyllja e plotë e procesit të transferimit të pronave publike, si edhe mbështetja për sektorin e ujit tashmë të transferuar. Buxheti i shtetit synon të mbështesë më tej kryerjen e investimeve publike nga njësitë e qeverisjes vendore.

3 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SOCIAL

Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit është orientuar sipas politikave prioritare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Gjatë periudhës 2006-2007 janë hedhur hapa të rëndësishëm për përmbushjen e qëllimit kryesor të reformave për zhvillimin e barazpeshuar, harmonik dhe të qëndrueshëm të vendit. Në këtë kuadër, drejtimi kryesor ka qenë ndërtimi e përmirësimi i infrastrukturës bazë, krijimi i një klime mbështetëse për biznesin, si dhe rritja e mundësive për punësim.

3.1 INFRASTRUKTURA

Investimet në infrastrukturë i kanë dhënë hov zhvillimit të sektorit, duke luajtur një rol të konsiderueshëm në rritje për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe intensifikimin e lidhjeve ekonomike ndërmjet zonave të ndryshme në vend. Në këtë këndvështrim:

- Transporti ka qenë në qendër të vëmendjes, duke rritur investimet në ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor në përputhje me prioritetet kombëtare. Krahas politikës së zhvillimit të rrjetit rrugor kombëtar, i përfshirë pothuajse tërësisht në rrjetin kryesor rajonal (CORE network), investimet janë përqëndruar edhe në ndërtimin e rrugëve turistike dhe segmentëve rrugorë që ndërlidhin pikat e kalimit kufitar.
- Reformat në sektorin e energjetikës janë përqëndruar në procesin privatizues dhe hapjen reale të tregut, si edhe në investimet e mëtejshme në infrastrukturën prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse. Megjithatë, sektori u përball me vështirësi, duke kushtëzuar një prodhim të ulët, rritje të importit dhe, si rrjedhojë, furnizim të kufizuar me energji elektrike të konsumatorëve.
- Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve është orientuar drejt thellimit të mëtejshëm të decentralizimit/komercializimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe të nivelit të shërbimit për sektorin. Është rritur niveli i popullsisë që ka lidhje direkte të ujit të pijshëm në banesë, por duhet bërë më tepër në drejtim të zvogëlimit të humbjeve në sistem dhe të rritjes së normës së arkëtimit.
- Ndotja e ajrit mbetet një sfidë, sidomos në qytetet e mëdha dhe në zonat industriale, megjithë masat e ndërmarra në këtë drejtim.

3.1.1 TRANSPORTI

Treguesi: Numri i kilometrave të ndërtuara të rrjetit rrugor kombëtar

Investimet në rritje për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor, si dhe projekti prioritar madhor për ndërtimin e korridorit Durrës-Morinë, kanë karakterizuar periudhën 2-vjeçare 2006-2007, për sektorin e infrastrukturës rrugore. Krahas politikës së zhvillimit të rrjetit rrugor kombëtar, i përfshirë pothuajse tërësisht në rrjetin kryesor rajonal (CORE network), investimet janë përqëndruar edhe në ndërtimin e rrugëve turistike dhe të segmentëve rrugorë që ndërlidhin pikat e kalimit kufitar. Karakteristikë kryesore e kësaj periudhe ka qenë ndërtimi i rrugëve me standarte të larta me (2x2) kalime, me tunele dhe vepra arti të mëdha. Njëkohësisht, gjatë periudhës 2-vjeçare janë ndërtuar rrugë të tipeve me (2x1) kalime, gjithsej 89.4 km, si dhe janë sistemuar dhe asfaltuar 169 km rrugë.

Gjatë viteve 2006-2007 filluan dhe kanë vazhduar më tej zbatimi i projekteve të rëndësishme për ndërtimin e rrugëve si: tre fazat e Korridorit Durrës-Kukës-Morinë, Milot-Rrëshen, Rrëshen-Kalimash dhe Kalimash-Morinë, Korridori VIII-të (Lushnje-Fier, Vlorë-Levan), Korridori Veri-Jug (Tepelenë-Gjirokastrë), rrugë turistike (Vlorë-Llogara, Llogara-Dhërmi, Velipojë, Dardhë, Spille), rrugët kufitare (Liqenasi, Has-Qafë Prush), Mbikalimi i Kamzës, etj.

Krahas investimeve të konsiderueshme për rehabilitim dhe ndërtim, rrjeti rrugor është i kufizuar si në shtrirje dhe në cilësi, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, ndërsa shpenzimet e saj, ndonëse efektive, mbeten në nivelin e nevojave për rrjetin rrugor kombëtar.

Në tabelën më poshtë jepen numri total i kilometrave të rrjetit kombëtar ndërtuar gjatë viteve 2006-2007.

Numri i kilometrave të rrjetit rrugor kombëtar të ndërtuar	Viti		Gjithsej
	2006	2007	
Me financim të brendshëm	46.5	39.8	86.3
Me financim të huaj	15.0	27.4	42.4
Gjithsej	61.5	67.2	128.7

Burimi: MPPTT

Zbatimi i Strategjisë Sektoriale të transportit dhe i parashikimeve të Planit Kombëtar të Transportit, reformimi i kapaciteteve institucionale dhe shndërrimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Ent Publik, janë disa masa të ardhshme që parashikojnë në vijim përmirësimin e këtij treguesi.

Zhvillimi i shpejtë dhe i gjithanshëm në fushën e transportit rrugor këto vitet e fundit ka çuar në rritjen e numrit të automjeteve, duke e rënduar gjendjen e trafikut dhe të qarkullimit në të gjithë rrjetin rrugor. Gjendja e sinjalistikës rrugore jo sipas standarteve europiane dhe trafiku i rënduar nuk i përgjigjen plotësisht këtij zhvillimi dhe, për pasojë, nevoja për kompletimin e infrastrukturës rrugore, garantimin e sigurisë rrugore dhe veçanërisht përmirësimin në fushën e sinjalistikës vazhdon të mbetet e lartë.

Masat dhe politikat që do të ndërmerren në vijim për zhvillimin e mëtejshëm të Rrjetit Rrugor Kombëtar synojnë krijimin e një rrjeti rrugor unik transporti, që integron vendin me rajonin, mundëson afrimin me tregjet ndërkombëtare si edhe shpërndarjen e trafikut në mënyrë optimale, duke ulur nivelin e ndotjes dhe të aksidenteve. Për këtë, është e rëndësishme edhe vënia në funksionim të plotë të rrugëve turistike e kufitare, përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar nëpërmjet sistemit të menaxhimit të pasurive rrugore dhe privatizimit plotësisht të shërbimeve. Me miratimin e manualit shqiptar për projektimin dhe ndërtimin e rrugëve (standartet shqiptare), një rol të rëndësishëm do të luajë edhe forcimi i kapaciteteve projektuese dhe zbatuese të projekteve rrugore.


Integrimi në BE kërkon përshtatjen legjislative të kornizës ligjore të transportit me standartet dhe rregulloret ndërkombëtare. Prandaj, krijimi i një sistemi rregullator dhe ligjor sipas kërkesave dhe standarteve evropiane do të garantojë lehtësimin e hyrjes në treg të transportuesve, operimeve optimale të shërbimeve në transport në bazë të një konkurimi të nivelit të lartë, si dhe uljen e barrierave jo-fizike.

Treguesi: Numri i rasteve të vdekjeve në aksidente rrugore për 10,000 mjete

Aksidentet rrugore përbëjnë një ndër problemet më të rënda shëndetësore në Shqipëri dhe situata po përkeqësohet çdo ditë për shkak të rritjes së shpejtë të trafikut. Numri i aksidenteve konsiderohet shqetësues përkundërt numrit të vogël të popullsisë dhe nivelit të ulët të motorizimit. Arsyt kryesore të rritjes së numrit të aksidenteve në vitet e fundit janë:

- Rritja e fluksit të lëvizjes së mjeteve në akset kryesore
- Rritja e shpejtësisë së lëvizjes mbi normat e lejuara
- Moszbatimi i rregullave të qarkullimit nga drejtuesit e mjeteve

Sipas të dhënave të MPPTT-së mbi aksidentet e ndodhura këto pesë vitet e fundit rezulton që në vendin tonë numri mesatar i aksidenteve me vdekje për 10,000 mjete është 10-11, përkundërt 5.5 që e kanë vendet e Europës Qendrore e Lindore, pra rreth 2 herë më i lartë.




Burimi: MPPTT

Në grafikun më sipër tregohet se si ka evoluar treguesi i numrit të vdekjeve në aksidentet rrugore, si dhe raporti i numrit të vdekjeve për 10,000 mjete.

Disa nga drejtimet kryesore të Planit të Veprimit për përmirësimin e sigurisë rrugore për vitin 2008 janë: përmirësimi i cilësisë së rrugëve dhe sinjalistikës rrugore, në përputhje me standardet europiane, zbatimi i procedurave të auditimit të rrugëve, që nga momenti i projektimit e deri në realizim, forcimi i disiplinës së qarkullimit rrugor, pajisja me leje drejtimi mbi bazën e provimeve realiste dhe të pakorrptuara të kandidatëve për drejtues mjeteve, ristrukturimi i kontrollit teknik të mjeteve dhe edukimi masiv me rregullat e qarkullimit të gjithë grupmoshave, veçanërisht të moshës shkollore.

Treguesi: Numri i pasagjerëve

Aeroporti i vetëm që funksionon në Shqipëri, i dhënë me konçesion shoqërisë konçesionare “Tirana International Airport” (TIA) sh.p.k., filloi operimin aeroportual në prill 2005. Operimi sipas kësaj kontrate konçesionare ka bërë të mundur menaxhimin e aeroportit dhe shërbimeve aeroportuale nga një konsorcium ndërkombëtar, menaxhimin e sigurisë së aeroportit nga kompania ndërkombëtare ICTS dhe investimin në konstruksione të reja aeroportuale dhe ambjente të shërbimeve. Këto politika kanë patur për rezultat rritjen e efikasitetit të transportit ajror, afrimin me standardet europiane për liberalizimin e tregut, përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe kanë ndihmuar zhvillimin e turizmit dhe të biznesit. Në grafikun më poshtë tregohet ecuria e numrit të pasagjerëve në aeroportin Tirana International, si dhe numri i kompanive ajrore që operojnë në Shqipëri.



Burimi: MPPTT

Investimet e kryera nga TIA deri në fund të vitit 2007, vit në të cilin përfundoi dhe ndërtimi i terminalit të ri të pasagjerëve (mars 2007), arritën në vlerën 50 milion Euro. Si rezultat i tyre, aeroporti deri në fund të këtij viti ka përpunuar një fluks prej 1,107,323 pasagjerë, shifër e cila ishte parashikuar të arrihej në fund të vitit 2010. Gjithashtu, rritja e standarteve të sigurisë dhe niveli i lartë i shërbimeve aeroportuale kanë bërë të rritet fluksi i pasagjerëve dhe të ketë një rritje të ndjeshme të shoqërive ajrore që operojnë në aeroport.

Gjatë periudhës 2006-2007 kanë filluar operimin e tyre kompani prestigjioze, si British Airways, Adria Airways (në vitin 2006), Lufthansa (fillim të vitit 2007). Aktualisht, janë 13 kompani ajrore që ofrojnë fluturime duke lidhur Tiranën me 33 destinacione vendesh të tjera.

Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore, nëpërmjet shërbimeve të kryera nga Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) sh.a., lidhur me navigimin ajror të hapësirës së RSH-së, si dhe standardet e sigurta të shërbimit të trafikut ajror, kanë garantuar një fluks të sigurt, të shpejtë dhe efikas, si rezultat i të cilit ka një rritje të ndjeshme në të ardhurat për shoqëritë dhe rritje të standardeve në transportin ajror.

Treguesi: Koha mesatare e qëndrimit të anijes në port (sipas porteve)

Për të patur një analizë të ecurisë së zhvillimit të porteve, treguesi i përdorur përgjithësisht është koha mesatare e përpunimit të anijeve në port. Në përbërjen e këtij treguesi përfshihen:

- Koha e pritjes në radhë është koha që anijet kalojnë në kalatat e portit duke kryer procedurat doganore, kufitare, shëndetësore dhe të kapitenerisë;
- Koha e qëndrimit në kalatë për punë;
- Koha e qëndrimit në kalatë pa punë, ku përfshihen orët për kohë të keqe, difektet e mekanizmave, si dhe ditët e festave dhe të dielat;
- Koha e largimit nga kalata është koha që i duhet anijes për të përgatitur dokumentat pas përfundimit të përpunimit të ngarkesës.

Në tabelën më poshtë tregohet koha mesatare e përpunimit të anijeve në portet kryesore të vendit.

Porti	Viti 2006	Viti 2007
Porti Detar Durrës	2,7 ditë për anije	2,6 ditë për anije
Porti Detar Vlorë	2.4 ditë për anije	2.6 ditë për anije
Porti Detar Shëngjin	1.17 ditë për anije	1.33 ditë për anije
Porti Detar Sarandë	2 ditë për anije	2.3 ditë për anije

Burimi: MPPTT

Me qëllim për të rritur kapacitetin e portit të Durrësit për të përballuar fluksin e rritur të transportit në të ardhmen, si pasojë e përfundimit të rrugës Durrës-Kukës-Morinë, parashikohet ristrukturimi i aseteve ekzistuese të portit, thellimi i basenit, ndërtimi i terminaleve të reja të dedikuara, përmirësimi i superstrukturës ekzistuese, privatizimi i shërbimeve të portit, privatizimi i terminalit të kontejnerëve, si dhe ndërtimi i terminalit të ri të pasagjerëve. Nga ana e tyre, këto politika do të sjellin në vitet e ardhshme një rritje të trafikut të pasagjerëve dhe kamionëve.

Në portin e Vlorës, gjatë vitit 2007 është rritur tonazhi i mallrave dhe i anijeve të përpunuara. Për vitin 2008 parashikohet rritja e normës së përpunimit të mallrave si, çimento, gaz i lëngshëm, naftë bruto. Për të disiplinuar aktivitetin e përpunimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, po ndërtohen dy porte të reja të specializuara vetëm për përpunimin e tyre, përkatësisht porti i Porto Romanos, në Durrës dhe La Petrolifera Italo-Albanese, në Vlorë.


Në Portin e Shëngjinit, gjatë vitit 2007, krahas përpunimit të karburanteve, është rritur dhe përpunimi i hekurit. Pas thellimit të portit ka pasur një rritje në madhësinë e anijeve të përpunuara. Rritja e eksportit të inerteve dhe aktivizimi i transportit të pasagjerëve në vitet e ardhshme do të bëjë të mundur ruajtjen e treguesve ekonomikë dhe pas ndërprerjes së shkarkimit të karburanteve.

Në Portin e Sarandës, gjatë vitit 2007, ka pasur një rënie në numrin e anijeve dhe mallrave të përpunuara, për shkak se gjatë sezonit turistik anijet e mallrave zëvendësohen nga tragetet turistike. Me përfundimin e ndërtimit të kalatës së përpunimit të mallrave në Portin e Limionit, mallrat do të përpunohen në këtë kalatë dhe treguesi i kohës mesatare të përpunimit të mallrave për vitet në vazhdim do të përmirësohet.

Masa të rëndësishme janë ndërmarrë lidhur me sigurinë detare: Ligji Nr. 9281, 23.09.2004 “Për Sigurinë në Porte dhe Anije”, si dhe është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 115, 25.02.2005, Autoriteti Shtetëror i Sigurisë për Portet dhe Anijet në Drejtorinë e Politikave të Transportit Detar, pranë MPPTT-së. Aktualisht, në porte (Durrës Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin) janë krijuar Forcat e Sigurisë Portuale (FSP) sipas standardeve të Kodit ISPS, e cila është një forcë e re sigurie për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e territorit portual dhe zbatimin e kërkesave që rrjedhin nga legjislacioni ndërkombëtar dhe ai kombëtar në fuqi për sigurinë portuale. Objektivi kryesor në fushën e politikave të sigurisë detare, përveç mbrojtjes dhe sigurisë së territorit portual, mbetet dhe shpallja e porteve shqiptare në Organizatën Ndërkombëtare të Detarisë (IMO), si porte me një nivel të lartë sigurie.

3.1.2 ENERGJETIKA

Treguesi: Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike (GWh) sipas burimit



Burimi: KESH, korrik 2008


Gjatë periudhës 2006-2007, Shqipëria përvijoi me reformat në sektorin e energjetikës, duke u përqëndruar në proceset ristrukturuese e nismat ligjore për përmbushjen e detyrimeve të Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë për Europën Juglindore, si edhe investimet e mëtejshme në infrastrukturën prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse. Megjithatë, sektori u përball me një situatë të pafavorshme të kushteve atmosferike, gjë që kushtëzoi një prodhim mjaft të ulët, rritje të importit dhe si rrjedhojë furnizim të kufizuar me energji elektrike të konsumatorëve.

Grafiku i mësipërm paraqet ecurinë dhe karakteristikat kryesore të sektorit të energjisë elektrike. Zona e ngjyrosur tregon sasinë e përgjithshme të energjisë së prodhuar. Vija e trashë tregon sasinë e energjisë që iu vu në dispozicion rrjetit. Në thelb, e gjithë energjia elektrike në Shqipëri prodhohet nga hidrocentralet, ndërkohë që sistemi ka qenë i karakterizuar nga pamjaftueshmëria e prodhimit vendas. Kjo ka sjellë, si rrjedhojë, rritjen e importit të një sasive të konsiderueshme energjie për harkun kohor 2006-2007, krahasuar me periudhat e mëparshme. Megjithatë, kapacitetet e kufizuara të interkonjeksionit për të importuar në kohë sasive të nevojshme e bënë të vështirë plotësimin e kërkesës vjetore për energji elektrike, duke vijuar me fenomenin e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike (zona me katrorë sipër vijës së trashë).

Zbatimi i projekteve për përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me energji elektrike ka qenë në qendër të vëmendjes për periudhën 2006-2007. Në këtë drejtim kanë filluar punime në ndërtimin e TEC-it të Vlorës, HEC-i i Kalivacit, linja 400 kV e interkonjeksionit Shqipëri - Mali i Zi, nënstacioni 400 kV në Tiranë dhe Qendra e re Kombëtare Dispeçer në Tiranë. Deri tani janë dhënë me konçesion 27 HEC-e të vegjël, me një kapacitet total prej rreth 100 MW. Janë në proces negocimi TEC-et ekzistues të Fierit, HEC-i i Ashtës, Kaskada e Devollit, HEC-i i Skavicës.

Hapja reale e tregut të energjisë mbetet prioriteti i Qeverisë Shqiptare në këtë sektor, prioritet ky që bëhet edhe më i detyrueshëm pas nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Europën Juglindore në vitin 2005. Synimi kryesor do të jetë integrimi në tregun rajonal të energjisë elektrike. Hapja e këtij tregu do të nxisë tërheqjen e kapitaleve private dhe rritjen e ndjeshme të kapaciteteve prodhuese dhe furnizuese të sistemit elektroenergjetik shqiptar. Gjithashtu, me përparësi do të shihet hapja dhe liberalizimi i tregut të brendshëm të energjisë, si edhe rritja e kapaciteteve të prodhimit vendas të energjisë, me synim plotësimin e kërkesës agregate për energji dhe duke synuar një prodhim me kosto sa më të ulët dhe me ndikim sa më minimal në mjedis.

Treguesi: Konsumi energjetik krahasuar me PBB-në



Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

Në kuadrin e politikave energjetike, vëmendja është përqendruar në procesin e ristrukturimit të sektorit të energjisë, si një objekt kryesor i programit të reformave ekonomike me një ndikim të rëndësishëm për të gjithë ekonominë e vendit. Për këtë, procesi i reformimit të KESH-it po shkon në transformimin e tij nga një kompani vertikalisht e integruar drejt kompanive të ndara në përputhje me funksionet, si prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe furnizimi, si dhe korporatizimin e tyre. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) është ndarë plotësisht dhe nga 1 korriku 2007 vepron me status financiar të vetin. Është krijuar dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), që është regjistruar në Gjykatën e Tiranës si një subjekt i pavarur. Gjithashtu, një ecuri të mirë ka patur dhe në drejtim të privatizimit të sektorit të shpërndarjes së KESH-it, i cili parashikohet të përfundojë brenda vitit 2008.

Konsumi energjetik përkundrejt Produktit të Brendshëm Bruto (intensiteti energjetik), i paraqitur edhe në grafikun më sipër, rezulton me një ulje të lehtë, si rrjedhojë e konsumit më të ulët të burimeve energjetike. Konsumi energjetik për banorë (ktOE/Kapita) ka pësuar një rënie të lehtë gjatë harkut kohor 2006-2007 (grafiku sipër), si rezultat i totalit më të ulët të produkteve primare energjetike.

Për vitin 2007, Totali i Produkteve Primare Energjetike (TPPE) ka qenë në nivelin 2130 ktOE. Në produktet primare energjetike për vitin 2007, peshën më të madhe e zënë nafta dhe nënproduktet e saj me 64.2% përkundrejt totalit të burimeve, ndërkohë që energjia elektrike zë 23.5%, drutë e zjarrit 10%, qymyri 0.8% dhe gazi natyror 0.75% të totalit. Në lidhje me konsumin final të burimeve energjetike për vitin 2007, 67% e konsumit i referohet naftës dhe nënprodukteve të saj dhe më pas vjen konsumi i energjisë elektrike me 18.3% dhe konsumi i drutë të zjarrit me 12.5%.

Një tregues tjetër i rëndësishëm është vetëplotësimi i nevojave për burime energjetike, që luhet nga 50.6% për vitin 2006 në 40.7% për vitin 2007. Rënia që vihet re për 2007 ka patur si shkak, përveç importit të burimeve të naftës dhe nënprodukteve të saj, edhe shtimin në krahasim me një vit më parë të importit të energjisë elektrike shkaktuar nga një vit i thatë hidroenergjetik në vend.

Sistemi energjetik është përballur gjatë viteve 2006-2007 edhe me sfidën e rritjes së tarifave të energjisë elektrike. Qëllimi ka qenë mbulimi i kostove, si dhe eliminimi i ndërsbvencioneve ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve, për të lehtësuar fillimin e procesit të privatizimit të sektorit të energjisë elektrike. Rritja graduale e tarifave të energjisë elektrike, me qëllim për të mbuluar kostot, ishte një ndër arsyt kryesore edhe në zgjedhjen që Qeveria Shqiptare bëri për Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike. Në rritjen e çmimit të energjisë janë marrë parasysh konsumatorët e grupeve në nevojë, duke krijuar skema mbrojtëse sociale.

Përfundimi i privatizimit të sektorëve të KESH-it dhe reformat kyçe, si çmimi mbi bazën e tregut dhe rritja e mbledhjes së tarifave, janë thelbësore për një zgjidhje afatgjatë për krizën energjetike, duke lehtësuar varësinë nga importet dhe mbështetur rritjen ekonomike. Një sektor efikas energjetik është vendimtar për zhvillimin dhe rritjen afatgjatë ekonomike të Shqipërisë. Strategjia e energjisë


2007-2020 e vendos fokusin e angazhimit të reformave të Qeverisë Shqiptare për sektorin në sigurinë e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve. Në këtë drejtim, për periudhën në vijim synohet përfundimi i privatizimit të sektorit të shpërndarjes së KESH-it, thellimi i reformës për plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në përputhje me “acquis communautaire” të BE-së, përmirësime në menaxhimin financiar të KESH-it, si edhe në fuqizimin e përgjithshëm të sektorit.

3.1.3 FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET

Treguesi: Mundësia e furnizimit me ujë, shprehur në përqindjen e familjeve që raportojnë se kanë ujë të rrjedhshëm në banesë, sipas nivelit të të ardhurave.

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizime është një shërbim specifik dhe i një rëndësie të veçantë. Sigurimi i një furnizimi të vazhdueshëm për 24 orë/ditë me ujë cilësisht të pastër, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, është prioritet i Qeverisë Shqiptare. Transferimi i pronës së shoqërive ujësjellës-kanalizime në njësitë e qeverisjes vendore i shërben këtij qëllimi. Aktualisht, i është dhënë rrugëzgjdhje transferimit të shoqërive tek njësitë e qeverisjes vendore, duke patur parasysh ruajtjen dhe moscopëtimin e zonës së shërbimit, zyrtarizuar nëpërmjet VKM Nr. 660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësite të qeverisjes vendore”.

Për vitin 2007, prodhimi i ujit është zvogëluar me 14% krahasuar me vitin 2006, një tregues pozitiv, duke qenë se në shkallë vendi prodhimi i ujit është shumë më i lartë se kërkesat e llogaritura për ujë të pijshëm. Edhe treguesi faturim/shitje e ujit ka një ecure pozitive në vitin 2007 krahasuar me 2006, me një rritje prej rreth 9%. Përmirësimi i këtyre dy treguesve jep ndikimin e vet pozitiv në zvogëlimin e humbjeve me rreth 5%. Ky përmirësim ka ardhur si rezultat i investimeve në rikonstruksionet e rrjeteve të ujësjellësve, vendosjes së matësave të ujit, etj. Një familje cilësohet me ujë të pijshëm në banesë kur ka të instaluar sistemin e ujit të pijshëm brenda në banesë. Përqindja e familjeve që raportojnë se kanë ujë të pijshëm në banesë llogaritet si raport i familjeve me ujë të pijshëm në banesë mbi totalin e familjeve në vend e shumëzuar me 100. Shpërndarja e familjeve sipas kuintileve¹ (sipas pesë klasave) jep përqindjen apo numrin e familjeve me ujë të pijshëm në banesë, raportuar kundrejt numrit total të banesave përkatësisht në secilin prej kuintilive. Kuintilet e të ardhurave llogariten duke e renditur treguesin e të ardhurave për çdo familje në rend rritës dhe duke krijuar më pas pesë klasa (kuintile), ku secila përfshin 20% të familjeve. Në kuintilin e parë bëjnë pjesë 20% të familjeve me të ardhurat më të ulëta, ndërsa në kuintilin e pestë bëjnë pjesë 20% të familjeve me të ardhurat më të larta.



Burimi: INSTAT, Anketa e Buxhetit të Familjes 2006-2007, MPPTT

Përqindja e popullsisë që furnizohet me ujë, përkundrejt popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit², ka arritur në 76.4% në vitin 2007, duke u rritur me 2.7% në krahasim me vitin 2006. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i përmirësimit të nivelit të shërbimit nga ana e shoqërive. Raporti i popullsisë që shërbehet

¹ Të ardhurat mesatare për kuintile paraqiten: kuintili 1 me 11134,56 Lekë; kuintili 2 me 20711,73 Lekë; kuintili 3 me 29627,59 Lekë; kuintili 4 me 42954,55 Lekë; kuintili 5 me 86111,35 Lekë. Të ardhurat mesatare gjithsej 38140,89 Lekë.

² Popullsia që jeton në zonën e juridiksionit për 55 shoqëri ujësjellës-kanalizimet që monitorohen prej Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve

me lidhje direkte në banesë me popullsinë që jeton në zonën e juridiksionit rezulton të jetë 73% për vitin 2007, e cila është rritur me 1.4% krahasuar me vitin 2006. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i zgjerimit të rrjetit shpërndarës dhe njëkohësisht si rezultat i shtimit të kontratave me klientët familjarë. Ndërsa, përqindja e popullsisë e lidhur me sistemin e kanalizimeve të ujrave të zeza është 68%.

Performanca e Sektorit të Ujit është përmirësuar vitet e fundit. Me gjithë faktin se shërbimi në sektorin e ujit është përmirësuar, konsumatorët furnizohen me një mesatare prej 12-14 orë ujë në ditë. Të ardhurat e sektorit janë dyfishuar vitet e fundit, megjithatë kostot e operimit, të mirëmbajtjes dhe kapitale nuk mbulohen plotësisht. Kështu, 93% e popullsisë në zonat urbane dhe 45% në zonat rurale janë nën zonën e shërbimit të 53 ndërmarrjeve. Aplikimi i teknologjive bashkëkohore për ambalazhimin e ujit në shishe dhe prodhimin e një larmishmërie pijesh cilësore alkoolike dhe jo-alkoolike do të rrisë më tej vlerën e ujit të vendit tonë. Gjithashtu, roli i strukturave shtetërore do të vazhdojë të rritet në drejtim të disiplinimit të mëtejshëm të këtij aktiviteti dhe njëkohësisht në lehtësimin e procedurave për licensimin.


Megjithë progresin e arritur, duhet punuar për të përmirësuar rezultatet, duke filluar me pakësimin sasisë së ujit të pafaturuar dhe rritjen e normës së arkëtimit. Përmirësimi i tyre do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e performancës së shoqërive, në drejtim të zvogëlimit të humbjeve në sistem edhe në rehabilitimin dhe sistemimin e plotë të decentralizimit të shoqërive ujësjellës-kanalizime. Për këtë, me përparësi do të shihet hartimi i një master-plani për investimet në sektor, rritja e kapaciteteve të qeverisjes vendore dhe të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizime si edhe zgjerimi i procesit të vendosjes së matësve për të përmirësuar menaxhimin e kërkesës për ujë.

Përmirësimi i mëtejshëm i performancës së shoqërive ujësjellës-kanalizime është detyrë prioritare dhe e vazhdueshme për sektorin. Masat e ndërmarra në mbështetje të reformës janë në tre drejtime: Iniciativa ligjore, Iniciativa administrative, dhe Iniciativa për projekte dhe financime. Ndërmarrja dhe thellimi i reformës së decentralizimit/komercializimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime do t'u mundësojë shoqërive të vetëfinancohen, të kenë plane afat-gjata dhe të qëndrueshme me qëllim përmirësimin e treguesve të punës dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj konsumatorit. Planifikimi i fondeve për investime për vitin 2008 do të bëhet në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në projekt-ide të miratuara nga Drejtorisë së përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve (DPUK) mbi bazën e performancës së shoqërive.

Treguesi: Cilësia e furnizimit me ujë, e shprehur në përqindjen e kampioneve që dalin negative në testin për E.Coli dhe mbetje klori, të marra brenda një viti nga ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve

Standartet e cilësisë së ujit aprovuar në Këshillin e Ministrave më 1998 janë të detyrueshme të respektohen nga të gjithë furnizuesit e ujit (Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve). Në Ministrinë e Shëndetësisë, ISHP dhe Drejtoritë e Shëndetit Publik (DSHP-të) e rretheve funksionon Inspektoriati Sanitar Shtetëror, i cili monitoron dhe kontrollon zbatimin e rregullave higjieno-sanitare për projektimin, ndërtimin, rikonstruksionin dhe shfrytëzimin e veprave të furnizimit me ujë të pijshëm të përcaktuara në rregulloren higjieno-sanitare për kontrollin e cilësisë të ujit të pijshëm.

Procesi i monitorimit të ujit të pijshëm është një proces i vazhdueshëm, i cili kryhet nga DSHP-të e rretheve (laboratorët mikrobiologjikë dhe fiziko-kimikë) në të gjithë sistemin ujësjellës të shpërndarjes të zonave urbane, ndërsa në zonat rurale ky monitorim kryhet çdo tre muaj. Zgjedhja e 500 pikave të kontrollit është realizuar në bashkëpunim me Inspektoriatin Sanitar Shtetëror të rrethit dhe Ndërmarrjet e Ujësjellësave, e përcaktuar në bazë të numrit të popullsisë së çdo qyteti.



Burimi: ISHP³

Sidoqoftë, përputhja me disa nga parametrat normative është shumë e vështirë, pasi disa prej tyre janë më të larta se mundësitë e ofruara me teknologjinë ekzistuese të trajtimit të ujit në Shqipëri. Standartet për cilësinë e ujërave të përdorura janë të tilla që përputhja bëhet pothuajse e pamundur, për shkak të mungesës së impianteve të trajtimit të këtyre ujërave. Edhe pse natyra rigoroze e standarteve dikton cilësi të mirë të ujit, ky i fundit ndotet në tubacionet kryesore dhe rrjetet shpërndarëse për shkak të lidhjeve të paligjshme, vjetërimit të sistemeve, si edhe furnizimit me ndërprerje. Kjo konfirmohet nga përhapja në mënyrë të përsëritur e sëmundjeve me origjinë nga uji. Për vitin 2006, përqindja e kampioneve të marra për mbetje klori ka qënë 97% dhe për vitin 2007 është rritur në 99%. Sipas të dhënave që disponohen nga ISHP-ja, rezulton se treguesi i E-Col negativ është përmirësuar me 3%, ndërsa ai i klorit mbetës është përmirësuar me 2%. Vlerësimi i rreziqeve shëndetësore lidhur me konsumin e ujit të pijshëm dhe ndërhyrja dhe marrja e masave të shpejta për përmirësimin e cilësisë së ujit, me qëllim uljen e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e shpërthimeve epidemike me origjinë hidrike, përbën objektivin kryesor në fushën e Ujit dhe Higjienës.

Një rëndësi e madhe i është kushtuar financimit të projekteve për ndërtimin e Impianteve të Trajtimit të Ujrave të Ndotura, që do t'i shërbejë një popullsie prej 1.6 milion banorësh. Gjatë këtyre viteve kanë filluar të operojnë impiante për trajtimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura. Aktualisht, funksionojnë dy impiante për trajtimin e ujit të pijshëm, përkatësisht në Kavajë (Manskuria) dhe Tiranë (Bovillë). Pesë impiante të trajtimit të ujërave të ndotur, përkatësisht në Durrës, Lezhë, Sarandë, Pogradec dhe Korçë, janë në fazën përfundimtare të ndërtimit dhe parashikohen të finalizohen në vitin 2010. Miratimi i strategjisë sektoriale të ujësjellës-kanalizimeve përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së ujit dhe rritjes së performancës së ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve në nivel vendor.

³ Të dhënat janë marrë nga monitorimi i ujit të pijshëm nga DSHP-të e rretheve për testin E. Coli përkatësisht në 51 ujësjellësa

3.1.4 MJEDISI


Treguesi: Përqëndrimi mesatar vjetor në 4 qytete të 3 ndotësve të ajrit: PM10 (grimcat e imta); SO2 (dioksidi i sulfurit); dhe NO2 (dioksidi i azotit) Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan Cilësia e ajrit ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)

Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave (MMPAU), në kuadër të Vendimit 103 të Këshillit të Ministrave (mars 2002) për sistemin e mbikëqyrjes së mjedisit, ka financuar monitorimin e cilësisë së ajrit urban për vitet 2006 dhe 2007. Puna monitoruese është realizuar nga tre institucione: ISHP, Instituti i Hidrometrologjisë (IHM) dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve (AMP).

Për njohjen e nivelit të ndotjes së ajrit urban, gjatë viteve 2006 dhe 2007 monitorimi është realizuar në 7 qytete me 15 stacione, për 6 tregues: PM10 (grimca nën 10 mikron), LNP (lëndë e ngurtë pezull), NO2, SO2, O3, Pb. Treguesit e monitorimit të ajrit mjedisor të paraqitur në këtë raport përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij sipas standarteve të BE-së dhe të pasqyruar në Vendimin 803 të Këshillit të Ministrave (dhjetor 2003). Në Tiranë, monitorimi është realizuar në 7 stacione, në Elbasan në 3 stacione, në Durrës në 1 stacion dhe në Shkodër në 1 stacion.

Një numër faktorësh kritikë ndikojnë në cilësinë e ajrit brenda zonave urbane. Nga këta, më kryesorët janë tymrat e shkarkimit nga automjetet në nyjat e trafikut (si stacionet e autobusëve dhe aeroport), të cilat prodhojnë nivele të larta të ndotësve të ajrit, si edhe përmbajtja e lartë e grimcave të pluhurit, sidomos në Tiranë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet vlerat mesatare vjetore të tre treguesve të monitoruar në katër qytetet për vitet 2006-2007, të krahasuara me normat mesatare vjetore të Standartit Shqiptar dhe të BE-së. Treguesi PM10 (grimcat e imta) mat pluhurin e prodhuar nga djegia e karburanteve dhe aktiviteti ndërtues; SO2 (dioksidi i sulfurit) është një ndotës i prodhuar kryesisht nga djegia e karburanteve nga automjetet dhe aktiviteti industrial; dhe NO2 (dioksidi i azotit) është një ndotës i prodhuar nga djegia e karburanteve nga automjetet.



Burimi: MMPAU

Grafiku tregon se gjatë periudhës 2006-2007 vlerat mesatare vjetore të dy treguesve SO2 dhe NO2 janë brenda normave të lejuara të Standartit Shqiptar dhe të BE-së.

Ndotja nga LNP përbën një nga problemet kryesore për cilësinë e ajrit urban, megjithëse kjo shifër është përmirësuar në krahasim me vitin 2005. PM10 është aktualisht ndotësi kryesor që vjen nga shkarkimi i automjeteve dhe është karakteristike e makinave të vjetra që përdorin si lëndë djegëse dizelin. Gjithashtu, ndërtimi dhe infrastruktura në ndërtim kontribuojnë në rritjen e PM10.

Transporti mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban, për shkak të shkarkimit të automjeteve, dhe është karakteristike për makinat e vjetra dhe që punojnë me naftë. Automjetet e

vjetra shkarkojnë disa herë më shumë ndotës në krahasim me makinat e reja me konvertor. Një rëndësi të veçantë ka dhe cilësia e lëndës djegëse që përdoret nga automjetet, e cila në vendin tonë është e një cilësie më të ulët se ajo e vendeve të BE-së.

Më problematikë për përmbajtjen e PM10 mbeten stacioni Tirana, ku vlerat e saj kapërcehen rreth 2 herë dhe Tirana 4 ku vlerat e lejuara tejkalohen në masën 3-4 herë. Në qytetin e Tiranës, treguesi i PM10 tejkalon në masa të ndryshme vlerat e lejuara në katër stacione, kurse në dy stacione ka përmirësime dhe PM10 rezulton brenda normave të vendit.

Në qytetin e Elbasanit, në zonën industriale, në stacionin Elbasani 3, përmbajtja e PM10 është 2% mbi normë, në Elbasan 1, niveli i PM10 është 30% mbi normë, kurse në stacionin Elbasani 2, PM10 është 2 herë mbi normë.

Në qytetin e Durrësit dhe Shkodrës përmbajtja e PM10 gjatë 2006-2007 jepet në të njëjtat nivele, ku vlerat tejkalojnë normat e lejuara në masën 20-25%.

Për këtë, me propozim të MMPAU-t, janë miratuar në Këshillin e Ministrave Vendimi 147 (mars 2007), udhëzimet numër 6 (tetor 2007) që synojnë të përmirësojnë cilësinë e naftës dhe benzinës, si dhe rregullorja e përbashkët numër 3 (mars 2007), e cila do të sjellë përmirësime të tjera lidhur me pakësimin e pluhurave nga mbetjet e ndërtimit. MMPAU ka në proces forcimin e kontrollit nëpërmjet inspeksioneve, për zbatimin e parimit “ndotësi paguan” dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Përmirësimi i mëtejshëm i treguesve mjedisorë kërkon forcimin e kapaciteteve administrative në fushën e mjedisit dhe rritjen e bashkëpunimit me ministrinë e tjera të linjës si dhe me pushtetin vendor.

Cilësia e ajrit dhe monitorimi i tij mbetet një sfidë edhe për vitin në vazhdim. Ndërmarja e politikave për uljen e çlirimit të gazeve nga burimet kryesore ndotëse, si edhe forcimi i legjislacionit në këtë fushë, përbëjnë një hap të rëndësishëm në përmirësimin dhe në ndryshimin e ndjeshëm të cilësisë së ajrit.

3.2 EKONOMIA E TREGUT

Rritja ekonomike është mbështetur nga politikat stabilizuese makroekonomike, të cilat janë orientuar drejt mbajtjes së një inflacioni relativisht të ulët dhe të qëndrueshëm, uljes së deficitit të përgjithshëm dhe pakësimit të borxhit publik.

Arritja dhe ruajtja e stabilitetit makroekonomik, si dhe angazhimi për forcimin e mëtejshëm të tij, përbëjnë një garanci për suksesin e zbatimit të masave dhe politikave. Kjo është arritur nëpërmjet rritjes së disiplinës fiskale, përmirësimit të administrimit të burimeve, rritjes së efikasitetit të shpenzimeve publike dhe krijimit të stimuljeve në favor të zhvillimit të biznesit privat.

Gjithashtu, duhet theksuar që investimet publike në raport me PBB-në janë rritur gjatë viteve të fundit dhe kanë qënë në një masë të konsiderueshme më të lartë se sa deficitin e përgjithshëm. Një pjesë e mirë e tyre janë financuar prej të ardhurave të shtetit.

Në kuadrin e politikave ekonomike dhe përmirësimeve institucionale dhe ligjore për periudhën 2006-2007, Shqipëria ka pasur një normë reale rritjeje ekonomike në nivele të qëndrueshme prej 5.5-6%. Rritja e produktit të brendshëm bruto për frymë ka ndikuar në rritjen e standartit të jetesës, krahasuar edhe me vendet e rajonit.

Vërehet një rritje e eksporteve, sidomos e mallrave me origjinë të pastër të ekonomisë shqiptare, ku përfshihen grupet e “mineraleve, lëndëve djegëse”.

Tërheqja e investimeve të huaja direkte ka qënë në rritje, ndonëse krahasuar me vendet e rajonit paraqitet një fluks i investimeve për frymë relativisht i ulët. Një rol të rëndësishëm në rritjen e IHD-ve ka patur privatizimi i shoqërisë Albtelecom.

Përmirësimi i ndjeshëm i klimës së biznesit i detyrohet reformës rregullatore të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare. Megjithatë, krahasuar me Vendet e Europës Juglindore, duhet ecur në drejtim të ndërmarrjes së lehtësirave fiskale, me qëllim thithjen e më shumë investimeve të huaja.

Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikqyrja e tregut, si një nga fushat e rekomanduara nga për t'u zhvilluar më tej nga Bashkimi Europian, është orientuar drejt hapave të mëtejshme në plotësimin e kuadrit ligjor.

Është përmirësuar niveli i treguesit të qeverisjes elektronike, si pasojë e disa politikave të ndërmarra për lehtësimin e regjistrimit të biznesit, prokurimin elektronik, ofrimin e shërbimeve elektronike për taksat, përdorimi i gjerë i teknologjisë së informacionit në arsim.

Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Popullsia	milionë	3,08	3,10	3,12	3,13	3,15	3,16
Inflacioni (mesatar)	%	5.2	2.4	2.9	2.4	2.4	2.9
Kursi i Këmbimit	Lek/USD	140.2	121.9	102.8	99.9	98.1	90,4
	Lek/EURO	132.4	137.5	127.7	124.2	123,1	123,6

Produkti

PBB	miliardë Lekë	622,7	694,1	750,8	814,8	891,0	980,1
Rritja reale e PBB-së	%	4.2	5.8	5.7	5,7	5.5	6.0
PBB për banor	mijë Lekë	201,3	223,1	240,1	259,3	282,8	310,0

Financat Publike

Të ardhurat totale	% të PBB	24.8	24.1	24,6	25,1	25,8	25,7
Shpenzimet totale	% të PBB	30.9	29.0	29.6	28,5	29.0	29.1
Shpenzimet kapitale	% të PBB	6.1	4.5	5.1	4.7	5.7	5.8
Deficiti i përgjithshëm	% të PBB	-6.1	-4.9	-5.1	-3.5	-3.3	-3.5
Borxhi publik total	% të PBB	63.9	61.5	56.5	57.4	55.5	52.8
Borxhi i brendshëm	% të PBB	41.9	40.5	39.3	40.2	39.2	37.7
Borxhi i jashtëm	% të PBB	22.1	21.1	17.1	17.3	16.3	15.0

Bilanci i Pagesave


Bilanci tregtar	% të PBB	-26.1	-23.3	-21.7	-22.4	-22.9	-26.5
Eksportet	% të PBB	7.5	7.8	8.2	8.0	8.7	9.9
Ritja e eksporteve	%	2.4	13.3	23.0	9.2	19.0	24.7
Importet	% të PBB	-33.5	-31.1	-29.9	-30.5	-31.6	-36.5
Ritja e importeve	%	5.2	0.3	12.1	13.9	15.4	26.1
Transfertat	% të PBB	13.4	14.2	13.2	12.7	13.4	12.4
Bilanci i llogarisë korente	% të PBB	-9.0	-6.6	-5.8	-9.0	-6.5	-10.5
Investimet e huaja direkte	% të PBB	3.0	3.1	4.5	3.2	3.5	5.9
Bilanci i pagesave	% të PBB	0.7	1.8	4.0	1.9	2.9	1.9

Burimi: MF 2007, Drejtoria e Makroekonomisë

3.2.1 FINANCAT PUBLIKE

Treguesi: Inflacioni-bilanci i pagesave të dhëna nga politikat fiskale

Gjatë periudhës 2006-2007, Shqipëria ka patur rezultate tepër të dukshme përsa i përket stabilitetit të çmimeve. Inflacioni është karakterizuar nga norma të ulëta, krahasuar me ekonomitë e vendeve të tjera. Grafiku i mëposhtëm, paraqet rritjen ekonomike dhe normën e inflacionit në vitet 2006 e 2007.



Burimi: MF, FMN

Gjatë viteve të fundit, përfshirë dhe vitet 2006 e 2007, si inflacioni mesatar vjetor ashtu edhe ai i fundvitit kanë qenë të stabilizuar në nivele të moderuara, brenda intervalit të synuar nga BSH. Megjithatë, në periudha të shkurtra ndër-vjetore, inflacioni ka devijuar lehtësisht nga intervali objektiv, kryesisht për shkak të goditjeve të paparashikuara dhe faktorëve spekulativë, të cilët qëndrojnë përtej kontrollit të Bankës Qendrore.

Çmimet e konsumit kanë qenë relativisht të qëndrueshme, duke shënuar një periudhë pozitive lidhur me përmbushjen e objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Norma mesatare vjetore e inflacionit për vitet 2006-2007 ka qenë brenda pikësnyimit optimal të tij, përkatësisht 2.4% e 2.9%.

Norma mesatare vjetore e inflacionit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2006 ka rezultuar rreth 2%. Periudha e inflacionit të ulët dhe të qëndrueshëm deri në mars 2006 vijoi me një tendencë në rritje e këtij treguesi, duke arritur në qershor vlerën 2.4%. Gjashtëmujori i dytë i vitit 2006 shënoi norma vjetore paksa më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2005 (+0.1%), ndërsa inflacioni mesatar për të gjithë vitin 2006 ishte në të njëjtin nivel me atë të një viti më parë, në nivelin 2.4%. Rritja në normën e inflacionit gjatë gjysmës së dytë të vitit reflektoi rritjen e çmimit në produktet bujqësore, si pasojë e ofertës në rënie të prodhimit bujqësor për shkak të kushteve jo të mira të motit. Tendencë në rritje e çmimeve të importit, për shkak të rritjes së inflacionit në vendet partnere, si dhe rritja e çmimit të naftës gjatë muajve maj dhe qershor 2006, kanë shtuar edhe më tej ndikimin e faktorëve pro-inflacionistë në ekonomi.

Norma mesatare e inflacionit për periudhën janar-dhjetor 2007 ishte 2.9%, duke mbetur mjaft pranë targetit pikësor optimal prej 3% të Bankës së Shqipërisë. Muajt gusht, shtator e tetor shënuan normat më të larta të inflacionit gjatë gjithë vitit, përkatësisht me 4.2%, 4.4% e 4.2%. Rritja në çmimet e produkteve ushqimore, e ndikuar pjesërisht nga pakësimi i prodhimit të brendshëm bujqësor dhe nga rritja e çmimit të drithërave dhe produkteve të tjera ushqimore në tregun botëror, ishin shkaktarët kryesorë të ndryshimit të rritjes së normës vjetore të inflacionit. Në fundin e vitit 2007, norma e inflacionit pësoi një ulje të lehtë, duke shënuar nivelin 3.1%. Me qëllim arritjen e objektivit të saj kryesor, mbajtjen e inflacionit në intervalin 2-4%, BSH rriti tre herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2007, në çdo rast me nga 0.25 pikë përqindje, duke e çuar atë nga 5.5% në qershor në 6.25% në nëntor të po këtij viti.


Treguesi: Raporti borxh i brendshëm ndaj PBB, krahasuar me vendet e Europës Juglindore

Të ardhurat totale të buxhetit të shtetit në raport me PBB-në janë rritur nga viti në vit, ndërsa deficitit buxhetor ka ndjekur një ecuri në rënie krahasuar me periudhën 2000-2004, duke arritur kështu në nivele lehtësisht të menaxhueshme. Gjatë viteve 2006 e 2007, deficitit ishte përkatësisht 3.43% e 3.26% e PBB-së. Gjithashtu, investimet publike gjatë këtyre viteve kanë qenë në një masë të konsiderueshme më të larta se sa deficitit i përgjithshëm, gjë e cila reflekton qartë një menaxhim më eficient të shpenzimeve buxhetore.

Financimi i deficitit buxhetor në Shqipëri është mbështetur kryesisht nga burimet e brendshme, huamarrja e brendshme dhe të ardhurat nga privatizimi. Por, edhe financimi i huaj ka patur rol të rëndësishëm. Borxhi i jashtëm përbëhet kryesisht nga marrëveshjet e nënshkruara nga Qeveria Shqiptare me kreditorët për financimin e veprave të rëndësishme publike dhe projekte të përbashkëta për përmirësimin e infrastrukturës, sektorit të energjisë, furnizimit me ujë, shëndetësisë dhe arsimit.

Politika e menaxhimit të borxhit publik gjatë viteve 2006-2007 ka njohur përmirësime të mëdha dhe ka qenë në përputhje me objektivat e vendosura. Politika e ndjekur ka pasur si objektiv kryesor të saj financimin e deficitit buxhetor me kosto sa më të ulët, duke vlerësuar dhe mbajtur nën kontroll riskun dhe koston e tij.

Gjatë dy viteve të fundit, si rrjedhojë e uljes graduale të deficitit buxhetor dhe një përmirësimi të ndjeshëm në menaxhimin e tij, treguesit e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm të Shqipërisë janë përmirësuar. Stoku i borxhit publik është ulur gradualisht, nga 59.7% të PBB-së në vitin 2000 në rreth 55.4% e 52.8% të PBB-së përkatësisht për vitet 2006 e 2007. Ky raport është brenda parametrave të Traktatit të Mastroitit, i cili përcakton nivelin 60% si kufiri maksimal i stokut të borxhit ndaj PBB-së. Huamarrja e re në tregun e brendshëm ka qenë në rënie, si rrjedhojë e uljes së vazhdueshme të deficitit fiskal, si dhe të ardhurave nga privatizimi i disa kompanive. Më poshtë paraqitet raporti i borxhit total publik ndaj PBB-së përgjatë periudhës 2000-2007.



Burimi: MF


Struktura e borxhit publik ka ardhur duke ndryshuar lehtësisht në favor të borxhit të huaj. Në këtë mënyrë, i është dhënë hapësirë më e madhe biznesit vendas për t'u financuar me kredi e për të rritur kapacitetet e tij në favor të zhvillimit e rritjes ekonomike të vendit. Megjithatë, stoku i borxhit të jashtëm ndaj PBB-së mbetet relativisht i ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Niveli i vjetor i rritjes së borxhit të jashtëm deri në vitin 2003 (më pas është në rënie) qëndron nën nivelin e rritjes vjetore të ekonomisë. Gjithashtu, kostot e borxhit janë në nivele konstante dhe është rritur pesha që zënë në këtë borxh instrumentat financiarë afatgjatë.

Në drejtim të zgjatjes së afatit të maturimit të borxhit të brendshëm dhe përmirësimit të raportit borxh i brendshëm - borxh i jashtëm, me qëllim uljen e riskut të borxhit publik dhe mbështetjes së zhvillimit ekonomik, gjatë viteve të fundit u ndoq një politikë e hedhjes në treg të instrumentave të

borxhit afatgjatë duke zëvendësuar ata afatshkurtër. Kjo ka rezultuar në një strukturë më të mirë të borxhit për vitin 2007, e përbërë prej 65.5% borxh afatshkurtër dhe 34.4% borxh afatgjatë, nga 77.5% dhe 22.4% përkatësisht një vit më parë (2006).

Të ardhurat totale në raport me PBB-në janë rritur nga viti në vit, ndërsa deficitin buxhetor ka patur rënie, duke arritur kështu në nivele lehtësisht të menaxhueshme. Gjithashtu, investimet në vitet e fundit kanë qenë në një masë të konsiderueshme më të larta se sa deficitin i përgjithshëm, gjë e cila tregon që një pjesë e tyre janë financuar nga të ardhurat e shtetit.

Stoku i borxhit të jashtëm ndaj PPB-së është relativisht i ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit, dhe niveli vjetor i rritjes së borxhit të jashtëm deri në vitin 2003 (më pas është në rënie) qëndron nën nivelin e rritjes vjetore të ekonomisë. Gjithashtu, kostot e borxhit janë ulur dhe është rritur pesha që zënë në këtë borxh instrumentat financiarë afatgjatë. Grafiku i mëposhtëm paraqet raportin e borxhit total publik ndaj PBB-së në disa prej vendeve të rajonit.




Burimi: MF

Ekonomia shqiptare vazhdon të ketë rritje të vazhdueshme dhe marrëveshjet për kreditë e nënshkruara kanë qenë me terma tregtare, që tregojnë rritjen e kapacitetit huamarrës të ekonomisë, përmbushjen e detyrimeve dhe rritjen e kredibilitetit të Qeverisë tek institucionet dhe organizmat e ndryshme financiare ndërkombëtare.

3.2.2 EKONOMIA

Treguesi: Investimet e huaja direkte për frymë, krahasuar me vendet e EJL (€)



Burimi: Raporti i Tranzicionit i BERZH, 2007

Ecuria e thithjes së investimeve të huaja direkte (IHD), për harkun kohor 2006-2007, ka qenë në rritje, ndonëse krahasuar me vendet e rajonit paraqitet një fluks relativisht i ulët i investimeve për frymë. Bazuar në indeksin e performancës së fluksit të IHD-ve 2004-2006 të UNCTAD⁴, Shqipëria arrin të tërheqë më shumë IHD në raport me madhësinë e ekonomisë së saj, duke u renditur në vendin e 60-ta ndër 141 vendet e studiara. Fluksi i investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2007 vlerësohet të ketë pësuar një rritje prej rreth 84% kundrejt vitit 2006, duke arritur në shifrën prej rreth 465.6 milion euro, ose 147.2 Euro për frymë. Një rol të rëndësishëm në rritjen e fluksit vlerësohet të kenë pasur përmirësimi i ndjeshëm i klimës së biznesit, aktivitetet promovuese, privatizimi i shoqërisë Albtelecom, si edhe zbatimi i kontratave konçesionare në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Përpjekjet janë përqëndruar në një sërë masash që kanë pasur si qëllim garantimin e biznesit të huaj, ngritjen e strukturave frytdhënëse për shërbimin ndaj investitorëve ekzistues, si dhe informimin dhe promovimin e mundësive për investime. Politikat për nxitjen e investimeve të huaja dhe të nxitjes së biznesit, në përgjithësi gjejnë pasqyrim në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2007-2013, miratuar me VKM në korrik të vitit 2007.


Në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit është punuar në drejtim të eliminimit të pengesave të panevojshme administrative, janë ulur numri i licencave për biznesin, është krijuar Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), zbatohet ligji i ri për konçesionet⁵, i cili ofron shanse të mëdha për ndërtimin e veprave të infrastrukturës në energji, në turizëm, shërbime, etj. Është miratuar dhe po zbatohet ligji i zonave ekonomike⁶, ndërsa janë shpallur tashmë zonat ekonomike: parku industrial Spitallë-Durrës me sipërfaqe 870 ha, zona Industriale në Koplik-Shkodër, zona ekonomike në Shëngjin në Lezhë. Një punë e konsiderueshme është bërë në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve promovuese, me krijimin nga Qeveria Shqiptare në vitin 2006 të Agjencisë Shqiptare për Biznesin dhe Investimet (Albinvest).

⁴ UNCTAD, WIR 2004-2006

⁵ Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Konçesionet"

⁶ Ligji Nr.9789, datë 19.07.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike"

Treguesi: Shumëllojshmëria e eksporteve. Pjesa e katër sektorëve (tekstile, këpucë, metale dhe minerale) në totalin e eksporteve



Burimi: METE

Eksportet e mallrave kanë rezultuar me një rritje mjaft të ndjeshme gjatë periudhës 2006-2007, ku viti 2006 paraqet një rritje 17.5% ndaj 2005, ndërsa në vitin 2007 janë rritur me 25.5% ndaj vitit 2006. Treguesit e tregtisë së mallrave me jashtë të Shqipërisë, në vijueshmëri përgjatë viteve të fundit, kanë rezultuar me rritje, ku volumi i mallrave në vitin 2006 ka qenë me një rritje prej 15.2% ndaj 2005 dhe për 2007 me një rritje prej 25.8% kundrejt vitit 2006. Përbërja e shkëmbimeve tregtare është e njëjtë për të dy vitet, përkatësisht 20.5% eksporte dhe 79.5% importe. Volumi i shkëmbimeve të mallrave me jashtë në vitin 2006 ka qenë 42.1% e PBB-së, ndërkohë që për vitin 2007, ky raport është rritur në 48.5% të PBB-së, duke treguar një hapje gjithnjë e më të madhe të ekonomisë shqiptare.



Grafiku më sipër tregon ecurinë e eksportit të katër sektorëve më të rëndësishëm në totalin e eksporteve për periudhën 2001-2007. Eksporti me material porositësi (fason), që përmbledh grupin e “tekstile dhe artikuj tekstile”, “veshjet e këmbëve”, “lëkurët dhe artikujt prej tyre”, vazhdon të dominojë eksportet e mallrave edhe për periudhën 2006-2007, përkatësisht në masën 56.7% dhe 50.5%. Gjatë kësaj periudhe vërehet një rritje e peshës specifike edhe të eksporteve me origjinë të pastër të ekonomisë shqiptare⁷, ku përfshihen grupet “minerale, lëndë djegëse”, me rritje nga 7.5% në 2005 në 15.4% në 2006 dhe “materiale ndërtimi” që zënë 17% të eksporteve për vitin 2006 dhe 15.8% për vitin 2007. Rritje të ndjeshme në eksport kanë pësuar minerali i kromit, nafta bruto materialet e ndërtimit (çimento, tulla, gëlqere, gurë dekorativë etj), si dhe shumë artikuj të tjerë.

Megjithëse ka një rritje të kënaqshme të eksporteve, përsëri deficitit tregtar vazhdon të thellohet si rezultat i bazës së ulët të eksporteve në krahasim me bazën e importeve. Deficitit në rritje i volumit tregtar tregon se ekonomia shqiptare akoma nuk ka arritur të shfrytëzojë në mënyrë të plotë kapacitetet e saj dhe të bëhet konkurruese, duke shfrytëzuar avantazhet e saj krahasuese.

Për periudhën në vijim, një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet zbatimit të mëtejshëm të projekteve që nxisin më tej eksportet, si: (i) Fondi i Konkureshmërisë, përfitues i të cilit janë NVM-të që merren me eksport ose kanë potenciale për të eksportuar. Sektorët që kanë përfituar më shumë nga ky projekt janë ato të agro-përpunimit, mobilerisë, konfeksioneve, prodhimit të artikujve prej metali, etj, duke patur një shtrirje të bizneseve në të gjithë territorin e vendit; dhe (ii) Fondi i garantimit të kredive për eksport, i cili ka filluar të zbatohet nga mesi i vitit 2007.

⁷ Produkte që sipas rregullave ndërkombëtare të origjinës marrin origjinën e vendit ku realizohet pjesa më e madhe e vlerës së shtuar të produktit, zakonisht mbi 50% e vlerës. Këto produkte realizohen me lëndë të parë nga burimet natyrore të vendit si dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Treguesi: Pengesat administrative. Radhitja në anketën ‘Si të Bësh Biznes’ (sipas treguesve krahasuar me vendet e EJL-së)



Burimi: Doing Bussines 2007, 2008

Klima për zhvillimin e biznesit ka ecuri mjaft pozitive, sidomos me procesin e reformës rregullatore të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare. Kjo reformë ka si qëllim të përmirësojë dhe garantojë një ambient miqësor, transparent, të thjeshtë dhe të parashikueshëm për biznesin, si gur themeli për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomiko-shoqëror. Megjithatë, krahasuar me Vendet e Europës Juglindore duhen bërë ende mjaft përpjekje për t'u përmirësuar. Në grafikët më sipër paraqitet radhitja e Shqipërisë sipas Anketës "Si të bësh biznes" për vitet 2006 dhe 2007. Shihet se në pjesën më të madhe të fushave ka përparim të dukshëm nga viti 2006 në vitin 2007, si p.sh. hapja e një biznesi, licensimi i një biznesi, punësimi në një biznes privat, import/eksporti, kontrata apo mbyllja e biznesit. Ndërsa mbetet shumë për të bërë në drejtim të thithjes së investimeve të huaja, përse i përket marrjes së kredisë dhe garantimit të një prone të sigurtë për biznesin, Shqipëria vijon të ketë një ecuri mjaft pozitive.

Në kuadër të reformës rregullatore, dy janë arritjet më të mëdha në fushën e biznesit: reforma në regjistrimin e biznesit, si dhe hapat pozitive të ndërmarra në fushën e licensimit. Reforma në regjistrimin e biznesit⁸ lidhet me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) në shtator 2007 në Tiranë. Brenda dy muajve në vijim u hapën sportele të reja në bashkitë e Tiranës, Elbasanit, Shkodrës, Durrësit, Gjirokastrës, Fier, Kukës dhe Korçë. Ngritja e këtyre qendrave përfaqëson një realitet të ri, duke ofruar një proces regjistrimi krejtësisht administrativ, me një ndalesë të vetme, në një ditë dhe me kosto vetëm 100 Lekë. Reforma në licensim është një ndër fushat më problematike, për shkak të dokumentacionit shumë kompleks që kërkohej të dorëzohet nga subjektet për marrjen e një licence, si edhe për shkak të afateve kohore shumë të zgjatura.

Grupi i Licensimit ka rishikuar dhe shqyrtuar 166 licenca, leje dhe autorizime, nga të cilat janë propozuar të hiqen 104 prej tyre. Ky grup, i ngritur në kuadër të platformës së Reformës Rregullatore, ka në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet shtetërore, biznesi, shoqëria civile dhe bota akademike. Në reformë janë përfshirë sektorët: (i) miniera dhe hidrokarbure; (ii) punë publike dhe transport; (iii) shëndetësi; (iv) bujqësi dhe ushqim; (v) mjedis, pyje, peshkim dhe administrimi i ujërave; (vi) dogana; (vii) gjueti; (viii) arsim dhe (ix) turizëm.

Për vitet në vijim duhet të ndërmerren nisma për fuqizimin e kapaciteteve të Qendrave të Regjistrimit në nivel vendor dhe të agjensive publike, me qëllim garantimin e standarteve të mbrojtjes së konsumatorit.

⁸ Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

3.2.3 MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE MBIKQYRJA E TREGUT

Treguesi: Plotësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e konsumatorit

Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikqyrja e tregut është një nga fushat zhvillimi i të cilës është vlerësuar nga Bashkimi Europian në Raportet e Progresit të viteve 2006-2007. Megjithatë, janë dhënë orientime për hedhjen e hapave të mëtejshme në plotësimin e kuadrit ligjor përkatës me aktet e nevojshme ligjore dhe nënligjore, në përputhje me Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA, si edhe me planin e veprimeve të Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikqyrjes së Tregut. Në SKZHI është përcaktuar si tregues për këtë fushë: përqindja e të intervistuarve që pranojnë se ndihen të mbrojtur nga masat ekzistuese për mbrojtjen e konsumatorit. Duke qenë se ky tregues nuk është i përfshirë aktualisht në anketat e opinionit publik, në vend të tij është paraqitur informacion në lidhje me plotësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e konsumatorit, i cili ka qenë edhe në fokus të masave të ndërmarra për këtë sektor.

Gjatë periudhës 2-vjeçare 2006-2007 përfundoi hartimi dhe miratimi në Kuvendin e Shqipërisë i ligjit të ri *“Për mbrojtjen e konsumatorëve”*. Ky ligj do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në treg, nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe ngritjes së institucioneve përkatëse. Gjatë analizës krahasuese të kryer për ligjet e mbrojtjes së konsumatorëve të vendeve të Rajonit, të bërë në kuadër të projektit të të financuar nga GTZ-ORF (Fondi i Hapur Rajonal për Reformën Ligjore), komponenti për mbrojtjen e konsumatorit, ky ligj është cilësuar si ligj që ka zbatuar në një stil perëndimor strukturën, detajet dhe terminologjinë e përdorur në direktivat evropiane të fushës së konsumatorëve.

Më tej, është hartuar ligji *“Për sigurinë e Përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Produkteve Jo-Ushqimore”*, i cili ka siguruar bazën për aktivitetet e mbikqyrjes së tregut në drejtim të sigurisë së produkteve, si dhe për hartimin e akteve nënligjore që trupëzojnë Direktivat e Përqasjes së Re (New Approach) në legjislacionin shqiptar. Ligji i sigurisë së produkteve është cilësuar i përafëruar me legjislacionin evropian të fushës së sigurisë së produkteve, gjatë procesit të shqyrtimit të tij nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme për Ndërmarrjet (DG Enterprise) në Komisionin Evropian. Gjithashtu, janë hartuar aktet nënligjore në zbatim të ligjit horizontal të sigurisë së produkteve, të cilat plotësojnë legjislacionin teknik të produkteve, duke transpozuar direktivat përkatëse të Përqasjes së Re.

Aktet ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura sigurojnë rritjen e shkallës së përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin evropian të këtyre fushave, si dhe një dallim më të qartë ndërmjet çështjeve të mbikqyrjes së tregut dhe ato të mbrojtjes së konsumatorit. Gjithashtu, ky legjislacion është hartuar në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin e progresit për vitet 2006 dhe 2007, detyrimeve që rrjedhin nga neni 76 i MSA-së, si dhe të prioriteteve të Dokumentit të Partneritetit Evropian.


Gjatë vitit 2007 është miratuar nga Këshilli i Ministrave Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut, për të cilën është kryer procesi i hartimit dhe konsultimit në harkun kohor 2006-2007. Kjo strategji përcakton piketat e orientimit për zhvillimin e sektorit me qëllim rritjen e nivelit të mbrojtjes së konsumatorëve. Në periudhën në vijim, politikat e sektorit do të orientohen në zbatim të masave për përmbushjen e objektivave të kësaj strategjie.

Vëmendja do të përqëndrohet kryesisht në procesin e hartimit të akteve nënligjore, forcimit të kapaciteteve institucionale, miratimin dhe trupëzimin e plotë të direktivave përkatëse të legjislacionit të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, etj. Më konkretisht, do të vijohet me masat për ngritjen dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, si një institucion administrativ përgjegjës për Sigurinë Ushqimore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit; ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si strukturë përgjegjëse të mbikqyrjes së tregut; adaptimin e paketës ligjore në fushën e higjienës në ushqim, etj.

3.2.4 TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Treguesi: Gatishmëria elektronike


Bazuar në të dhënat mbi gatishmërinë e qeverisjes elektronike në raportin e Kombeve të Bashkuara “UN e-Government Survey 2008”, Shqipëria renditet në vendin e 86-të ndër 182 vende të shqyrtuara në këtë raport, me një rritje prej 14 vendesh kundrejt vëzhgimit të kryer në vitin 2005. Në grafikun e mëposhtëm jepet indeksi për qeverisjen elektronike për Shqipërinë për periudhën 2004-2008, krahasuar me vendet e tjera të Europës Juglindore për vitin 2008.



Burimi: UN e-Government Survey 2008

Përmirësimi i nivelit të këtij treguesi ka ardhur si pasojë e disa politikave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare të tilla si: regjistrimi i biznesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit duke ulur kohën e nevojshme për regjistrim nga 42 ditë në 1 ditë; ligji i ri i prokurimeve publike i cili lejon prokurimin elektronik që do të ndikojë në uljen e kostos së përgjithshme të prokurimeve; reforma në sistemin e taksave, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve elektronike për taksat; pajisja me kabinete informatike e shkollave të mesme.

Treguesi i gatishmërisë për qeverisjen elektronike llogaritet nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara dhe përbëhet nga disa tregues të tjerë si, treguesit e infrastrukturës, të gatishmërisë së të dhënave, të aksesit në web, si dhe treguesi i edukimit. Ky tregues paraqet rëndësi pasi pasqyron nivelin e shërbimeve të kryera elektronikisht (online) dhe gatishmërinë e qeverisë për të realizuar shërbimet publike elektronikisht (online).



Burimi: UN e-Government Survey 2008

Për periudhën në vijim, do të synohet përfundimi i procesit dhe miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Shoqërisë së Informacionit, si një udhërrëfyese e rëndësishme e reformave në sektor. Gjithashtu, politikat e sektorit do të përqëndrohen në vazhdim në: (i) përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, (ii) zhvillimin e mëtejshëm të qeverisjes elektronike, (iii) përmirësimin e shërbimeve publike përmes teknologjisë së komunikacionit (në fushën e prokurimit elektronik, regjistrimit të biznesit, tatim-taksave, financave publike, etj), (iv) politikat për rritjen e cilësisë në arsimim përmes teknologjisë së informacionit, (v) përmirësimin e legjislacionit për shoqërinë e informacionit, etj.

3.3 POLITIKA SOCIALE

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim ndan të njëjtin qëllim me atë të Axfordës së Lisbonës për të tërhequr në tregun e punës dhe për të mbajtur të punësuar sa më shumë njerëz, si një instrument jetësor “që mbështet rritjen ekonomike, kohezionin social, si dhe lufton varfërinë”⁹. Në këtë kapitull paraqiten arritjet e politikave sociale të ndërmarra në kuadër të SKZHI-së gjatë periudhës 2006-2007, të renditura sipas treguesve në fushat përkatëse.

Niveli i papunësisë është ulur përmes zbatimit të projekteve të nxitjes së punësimit, zgjerimit të rrjetit të qendrave publike të formimit profesional me fonde të buxhetit të shtetit, etj. Janë bërë hapa me rëndësi për integrimin gjinor nëpërmjet nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave në përgjithësi, apo të grupeve më të papërkrahura si gratë rome, viktimat e trafikut, gra të moshuara dhe gra invalide. Megjithatë, duhet synuar në politika nxitëse për të rritur pjesëmarrjen e gruas në nivelet vendim-marrëse.

Thellimi i decentralizimit dhe zbatimi i politikave dhe programeve sociale ka sjellë rritjen e mbulimit me ndihmë ekonomike të shtresave në nevojë dhe identifikimin më të mirë të familjeve realisht në nevojë. Si rezultat i ritmeve të larta të zhvillimit të vendit, gjatë këtyre viteve është bërë e mundur që një numër i konsiderueshëm njerëzish të dalin nga varfëria. Numri i kontribuesve në sistemin e pensioneve ka prirje rritjeje, megjithatë politikat për reformimin e sektorit mbeten një sfidë për periudhën në vijim.

Treguesit e përfshirë për funksionimin e shërbimit shëndetsor, si vdekshmëria foshnjore e vdekshmëria amtare janë në nivele kënaqshme, sidoqoftë mbetet mjaft për të bërë në rritjen e nivelit të shërbimeve shëndetësore të ofruara.

Niveli i përfshirjes në përgjithësi në arsim është rritur, si rezultat i zbatimit të një sërë reformash e politikash në drejtim të përmirësimit cilësor të procesit mësimor, ngritjes së kapaciteteve akademike, laboratorike e shkencore, integritet të instituteve kërkimore-shkencore në universitete, si dhe fuqizimit dhe shtrirjes së arsimit profesional.

Zbatimi i përparësive të SKZHI-së, të cilat synojnë trajtimin e përjashtimit social dhe përmirësimin e sistemit të monitorimit të përjashtimit social, do të shihen me përparësi. Në këtë kuadër do të identifikohen masat që duhet të ndërmerren, të tilla si ofrimi i mundësisë për të krijuar të ardhura dhe pasur akses në shërbime për të gjithë, si edhe ndihma për personat që janë më në nevojë, sidomos me problemet e romëve. Shumë i rëndësishëm është zbatimi si duhet i masave tashmë të identifikuar, si edhe hartimi i një sistemi për zbulimin e personave që shkojnë drejt përjashtimit (përjashtimi është një proces), duke marrë në konsideratë të ardhurat, punësimin, arsimimin, shëndetin, sipas modelit të BE-së.

⁹ Komunikatë e Komisionit, Politika për Kohezionin në mbështetje të Rritjes dhe Vendeve të Punës: Udhëzimet Strategjike të Komunitetit 2007-2013, COM(2005) 0299


3.3.1 PUNËSIMI

Treguesi: Shkalla e papunësisë sipas grupmoshave dhe gjinisë (%)

Në fund të vitit 2006, niveli i papunësisë është ulur në rreth 13.8% nga 14.1% në vitin 2005, përkatësisht me 3,000 të papunë. Niveli i papunësisë vazhdon të mbetet më i lartë tek femrat në masën 16.8%, krahasuar me nivelin e papunësisë tek meshkujt rreth 11.%. Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2007, numri i personave të regjistruar si punëkërkuar të papunë është ulur nga 149,794 në 142,821, duke ndikuar në nivelin e papunësisë që arrin në 13.2%, e cila është 0.6% më e ulët se në vitin 2006. Të dhënat që kanë dalë nga vërtetimi i parë i Forcave të Punës i kryer në qershor 2007 tregojnë se gjatë këtij muaji numëroheshin 185,000 të papunë, përlogaritur sipas standardeve të ILO-s dhe BE-së.

Shkalla e papunësisë për këtë periudhë është 13.5%, e cila rezulton të jetë më e lartë në grupmoshat e reja deri në rreth 30 vjeç. Ky tregues është më i lartë tek meshkujt e grupmoshave të reja deri në 29 vjeç në krahasim me femrat, ndërsa për grupmoshat 35-49 vjeç treguesi është më i lartë për femrat. Në grupmoshat mbi 50 vjeç vihet re një prirje më e lartë për të kërkuar punë, sidomos tek meshkujt. Analiza tregon se femrat përbëjnë rreth 48.5% të numrit të të papunëve të regjistruar në zyrat e punësimit.

Një analizë e papunësisë sipas zonave tregon se kjo dukuri vazhdon të mbetet e lartë në zonën veriore të vendit, sidomos në rrethet Laç, Has, Tropojë, Pukë, Shkodër, Malësi e Madhe, Mirditë, etj. Pavarësisht se popullsia e kësaj zone zë vetëm 23% të popullsisë së vendit, papunësia atje është në nivelin 23.2%, i cili është shumë më i lartë se në çdo zonë tjetër e vendit.



Burimi: INSTAT

Në fund të vitit 2007, numri i të punësuarve rezulton të ketë pësuar ulje në sektorin shtetëror, ndërsa në sektorin privat jo-bujqësor ky numër shënon një rritje me 5,000 të punësuar më shumë se në vitin 2006. Struktura e punësimit sipas sektorëve për të punësuarit në moshë 15-64 vjeç tregon që punësimi në sektorin shtetëror përbën vetëm 15% të punësimit në total. Sipas aktiviteteve ekonomike, niveli i punësimit ka një përqëndrim më të lartë të të punësuarve në bujqësi me rreth 47.5%, në tregti me rreth 11%, në industri përpunuese me rreth 8.8%, në ndërtim me rreth 8.3%. Femrat e punësuarat kanë një pjesëmarrje më të madhe në sektorin privat bujqësor, ndërkohë që meshkujt janë më të angazhuar në sektorin privat jo-bujqësor (femrat përbëjnë vetëm afro ¼ e të punësuarve në sektorin privat jo-bujqësor).

Shkalla e papunësisë vjen gradualisht në ulje sa më shumë rritet niveli i arsimit për popullsinë që jeton në zonat urbane, ndërsa nuk vihen re diferenca në zonat rurale.

Politikat e nismat e ndërmarra në fushën e punësimit kanë patur për qëllim uljen e nivelit të papunësisë e njëkohësisht punësimin e plotë, përmirësimin e cilësisë së produktivitetit në punë dhe forcimin e kohezionit social. Këto janë mbështetur në zbatimin e projekteve të nxitjes së punësimit; zbatimi i projektit pilot në qytetin e Tiranës për punësimin e të rinjve që kanë mbaruar arsimin e lartë; krijimi i

qendrës së lëvizshme të formimit profesional për zonën verilindore; zgjerimi i rrjetit të qendrave publike të formimit profesional me fonde të buxhetit të shtetit; ndërtimi i qendrave në qytetet e Durrësit dhe Gjirokastrës, etj. Një numër rreth 28,000 punëkërkues të papunë janë punësuar nëpërmjet shërbimit të Zyrrave të Punësimit, Këshillimit dhe Ndërmjetësimit. Nga aplikimi i programeve të nxitjes së punësimit janë punësuar 4,503 punëkërkues të papunë, nga të cilët 2,000 janë nga grupet e veçanta.

Përmirësimet në shërbimin e punësimit, zbatimit të programeve aktive e pasive dhe formimit e trajnimit profesional kanë bërë të mundur funksionimin e tregut të punës. Këto politika kanë patur për qëllim orientimin e shërbimeve të punësimit drejt kërkesës së tregut të punës dhe krijimin e një sistemi modern dhe unik të shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin.

Në programet e nxitjes së punësimit me përparësi janë trajtuar grupet e veçanta si, përfituesit e skemave të mbështetjes me të ardhura, femrat, të papunët mbi 50 vjec, romët, punëkërkuesit e papunë, të rinjtë 16-25 vjec, personat me probleme sociale, etj. Në vijim, do të vazhdohet të mbahet në qendër të vëmendjes: (i) ndërtimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve të partneritetit me aktorë të tjerë në tregun e punës; (ii) përmirësimi i kontakteve me ndërmarrjet e biznesit; (iii) vazhdimi i procesit të zhvillimit të teknologjisë së informacionit (IT) në shërbimet e punësimit si një faktor kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve; (iv) zhvillimi i burimeve njerëzore; (v) krijimi i një sistemi unik dhe cilësor të AFP-së, i aftë për të kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale dhe qytetarisë aktive të të rinjve dhe të rriturve; si dhe (vi) ofrimi i kualifikimeve profesionale në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, në kuadrin e integritit rajonal dhe Evropian.


3.3.2 BARAZIA GJINORE

Treguesi: Shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, sipas përkufizimit standard dhe atij të zbutur

Pjesëmarrja e gruas në tregun e punës përbën një nga treguesit kryesorë të fuqizimit ekonomik të saj, si dhe ridimensionon rolin e saj në drejtim të sigurimit të të ardhurave në familje. Megjithatë, të dhënat tregojnë se ka pabarazi midis femrave dhe meshkujve në pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës dhe kryesisht kjo vërehet në treguesit statistikorë të burimeve të punës, si dhe në punësim.

Pjesëmarrja e gruas në tregun e punës pati një rënie të ndjeshme gjatë viteve të tranzicionit. Siç e tregon edhe analiza e nivelit të punësimit sipas gjinisë në periudhën 1996-2006, niveli i punësimit të femrave ka qenë dukshëm më i ulët se ai i meshkujve. Nëse analizojmë pjesëmarrjen e femrave në popullsinë ekonomike jo-aktive, vërejmë se ato përbëjnë 53% të saj, ndërsa për meshkujt ky tregues është 31%. Ndërkohë, niveli i punësimit të meshkujve për vitin 2006 është 58.8% dhe i femrave 38.2%. Megjithëse akses i gruas në arsimim është i barabartë me burrat, kjo nuk u siguron grave të njëjtat mundësi në tregun e punës. Të dhënat e të punësuarve në sektorin shtetëror tregojnë se gratë zënë përqindje më të lartë të punësimit në profesione të tilla si, specialiste apo nëpunëse të thjeshta, pozicione këto më pak të paguara krahasuar me profesione të tilla si, ligjvënës, nëpunës dhe drejtues të lartë, politikëbërës, etj.

Gjatë muajit qershor 2007, nga Instituti i Statistikës u krye për herë të parë Anketa specifike për Forcën e Punës pranë familjeve në nivel kombëtar, e cila jep një informacion më të gjerë mbi shkallën e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Në bazë të të dhënave të kësaj ankete dhe në përputhje me përkufizimin e Bashkimit Europian për punësimin, rezultojnë rreth 200,000 të punësuar në moshë 15-64 vjeç. Niveli i punësimit është më i lartë për meshkujt, me 64% krahasimisht me femrat me 49%. Në grafikun më poshtë jepet niveli i punësimit sipas gjinisë dhe sektorëve për grupmoshën 15-64 vjeç, në vitin 2007.



Burimi: MPÇSSHB

Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, si edhe integrimi gjinor, janë pjesë e politikave sociale, ekonomike dhe politike të qeverisë. Në mars të vitit 2006 u krijua dhe filloi të funksionojë Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta, pranë MPÇSSB-së. Krijimi i kësaj drejtorie synoi fuqizimin e mekanizmit qeveritar për barazi gjinore dhe shanse të barabarta në një nivel më të lartë, duke qënë një objektiv i rëndësishëm edhe në programin e qeverisë 2006-2009.

Në vijim, gjatë vitit 2006 filloi procesi i hartimit, konsultimit dhe lobimit të projektligjit *“Për barazinë gjinore në shoqëri”* dhe në dhjetor 2006 u miratua Ligji Nr. 9669 *“Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”*. Në këtë kuadër, gjatë periudhës 2006-2007 është realizuar një fushatë e gjerë aktiviteteve kundër dhunës në familje, në lidhje edhe me procesin konsultues për përgatitjen e paketës së akteve nënligjore. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar sensibilizimit të opinionit publik, si dhe të të gjithë aktorëve mbi çështjet e barazisë gjinore dhe mbi respektimin e të drejtave të grave dhe vajzave.

Gjatë periudhës 2006-2007 është punuar në drejtim të integritit të çështjeve gjinore në politikat qeveritare në nivel qendror dhe vendor, duke fuqizuar rrjetin e pikave të kontaktit në nivel ministrie dhe prefekturë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre mbi përkatësinë gjinore dhe integrimin gjinor. Gjithashtu, është realizuar edhe ngritja e rrjetit të pikave të kontaktit për barazinë gjinore në nivel bashkie. Më tej, është dhënë një kontribut i rëndësishëm në hartimin dhe konsultimin e Raportit të III Kombëtar të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas (CEDAW).

Programet për nxitjen e punësimit të grave dhe vajzave në përgjithësi dhe i grupeve më të marginalizuara si, gratë rome, viktimat e trafikut, gra të moshuara dhe gra invalide mbeten në fokusin e aktiviteve në fushën e barazisë gjinore. Një element i rëndësishëm që do të ndikojë në zbatimin më të mirë të këtyre politikave është edhe ngritja e një sistemi statistikash gjinore, i cili do të realizohet gjatë vitit të ardhshëm, në kuadrin e Programit “Një OKB”.

3.3.3 MBROJTJA SOCIALE


Treguesi: Mbulimi dhe programimi i ndihmës ekonomike, përqindja e njerëzve në varfëri të skajshme që përfitojnë ndihmë.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, mbështetur në Ligjin 9355 (mars 2005), filloi reformimin e sistemit të mbrojtjes sociale, duke synuar zbutjen e varfërisë nëpërmjet përmirësimit të indikatorëve të matjes së varfërisë dhe shkallës së mbulimit të nevojave për zbutjen e saj. Ky reformim synon gjithashtu përmirësimin e sistemit të pagesave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe ngritjen e shërbimeve komunitare të decentralizuara, sa më pranë klientëve. Njëkohësisht, kjo çon në rritjen si të përgjegjësisë së pushtetit vendor dhe të angazhimit të shoqërisë civile në ofrimin e këtyre shërbimeve, në përputhje me standartet e reja. Për mbulimin e nevojave nga buxheti i shtetit, gjatë vitit 2007 u caktuan 2,6 miliard Lekë për programin e ndihmës ekonomike (NE) për 16.5% e popullsisë.

Në periudhën 2006-2007, programet e ndihmës ekonomike, pagesës dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetja e shërbimeve sociale të decentralizuara e komunitare që janë ngritur e zhvilluar, janë konsideruar si programe komplementare me impakt në uljen e varfërisë të grupeve, familjeve dhe individëve në nevojë. Ndihma ekonomike programohet sipas treguesve të hartës së varfërisë, mbi bazën e treguesve LSMS 2002 / LSMS 2005. Numri i familjeve të varfëra identifikohet sipas hartës së varfërisë, ku përcaktohet përqindja e popullsisë dhe numri i familjeve që jeton me më pak se 2 USD në ditë për person për çdo bashki/komunë. Përqindja e popullsisë që jeton me nën 2 USD në ditë për person për vitin 2006 rezulton rreth 18.7%, ndërsa për vitin 2007 rezulton 16.7% të popullsisë.

Persona në varfëri të skajshme konsiderohen të gjithë ata që jetojnë me më pak se 1 USD në ditë (për person). Sipas LSMS 2002, niveli i varfërisë të skajshme në Shqipëri vlerësohet në nivelin e 5% të popullsisë. Sipas LSMS 2005, niveli i varfërisë të skajshme ka pësuar rënie, duke shënuar vlerën 3%. Sipas hartës së varfërisë dhe vlerësimeve të treguesve administrativë, niveli i varfërisë së skajshme vlerësohet 2.8-3%. Në përputhje me hartën e varfërisë dhe vlerësimeve të treguesve administrativë, në periudhën 2006-2007 është programuar dhe shpërndarja e fondeve të ndihmës ekonomike (NE) në njësitë vendore.

Në skemën e ndihmës ekonomike përfitojnë rreth 93,000 familje, përkatësisht 437,000 persona. Duke vlerësuar varfërinë e skajshme me 3%, rezulton se 14,000 persona ose rreth 3,000-3,500 familje jetojnë në varfëri të skajshme.



Burimi: MPÇSSHB

Gjatë periudhës 2006-2007 e në vazhdim janë zgjeruar kufinjtë e përfitimit të familjeve të varfëra. Ndërkohë, në funksion të uljes së varfërisë janë marrë masa për përsosjen e sistemit të shpërndarjes së NE-së dhe rritjes së transparencës. Më konkretisht, është përsosur metodologjia e vlerësimit të varfërisë në përputhje me të dhënat e LSMS; është rritur masa e mbulimit të nevojave dhe është rritur forca e kontrollit për përjashtimin e rasteve abuzive dhe garantimin e përfshirjes së familjeve realisht në nevojë.

Në vijim të këtyre masave, NE do të kushtëzohet me punë komunitare, duke synuar që skema e saj të shndërrohet nga një skemë pasive në aktive. Kjo gjë do të çojë jo vetëm në dhënien e rezultateve të menjëhershme në përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitet, rrugëve, pastrimit, veprave ujore në fshat, por edhe në pakësim të numrit të personave dhe familjeve të cilët nuk kanë pranuar të marrin pjesë në këto skema.

Programet e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar (PAK) vlerësohen si plotësuese, që ndikojnë bashkarisht në uljen e varfërisë. Duke vlerësuar se rreth 55% e numrit të personave me aftësi të kufizuar janë pjesëtarë të familjeve që trajtohen edhe me NE, rezulton se, nga 8.1 miliard Lekë që janë caktuar për PAK në vitin 2007, rreth 4.4 miliard Lekë të programit të PAK ndikojnë drejtpërsëdrejti për uljen e varfërisë të familjeve të varfëra që përfitojnë NE.

Për vitin 2008, zbutja e varfërisë të skajshme do të mbështetet edhe me përmirësime ligjore për të rritur fondet, në mënyrë të veçantë duke rritur tavanin e NE-së nga 7,000 Lekë në 7,500 Lekë në muaj. Kjo gjë do të krijojë mundësinë që familjet me shumë fëmijë të marrin më shumë ndihmë financiare.

Niveli i varfërisë për person do të ulet nën 10% deri në vitin 2013, në përputhje me treguesit e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës, që është kryer nga INSTAT.

Në përfundim, do të hartohet një kuadër i plotë ligjor për politikën sociale, për të siguruar mbrojtjen e duhur për të gjithë qytetarët; do të garantohet përfshirja e individëve dhe familjeve të varfëra në skemën e ndihmës ekonomike dhe programe të tjera sociale, si dhe do të plotësohen më mirë nevojat e përfituesve nga këto programe.

3.3.4 PËRFSHIRJA SOCIALE

Treguesi: Shkalla e popullsisë në varfëri absolute

Rritja e barabartë dhe gjithpërfshirëse është shumë e rëndësishme për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social. Politikat sociale të ndërmarra, kombinuar me nxitjen e zhvillimit ekonomik, kanë qenë efikase dhe kanë sjellë si rrjedhim që një numër i konsiderueshëm njerëzish të dalin nga varfëria. Sidoqoftë, varfëria mbetet shqetësimi i politikës shqiptare, pasi edhe shkalla e varfërisë është nga më të lartat në Europë. Në këtë kuadër, vlen për t'u përmendur hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Përfshirjes Sociale, mbi bazën e një Plani Veprimesh kundër Varfërisë dhe Përfshirimit Social të vendeve anëtare të BE.

Varfëria absolute matet mbi bazën e një konsumi real mujor për frymë dhe vitet e fundit ka pësuar rënie të konsiderueshme, si rezultat i ritmeve të larta të zhvillimit të vendit. Në kushtet e Shqipërisë, si treguesit e varfërisë absolute edhe ata të varfërisë relative janë të rëndësishëm, sepse japin një panoramë më të gjerë të ndryshimeve për statusin e asistencës sociale të popullsisë. Treguesit e varfërisë në Shqipëri bazohen në vlerësimin e konsumit dhe jo në të ardhurat, sepse informacioni mbi të ardhurat nuk është shumë i saktë në krahasim me informacionin mbi konsumin. Kufiri i varfërisë absolute përcaktohet në raport me një shportë artikujsh ushqimorë (dhe jo-ushqimorë), duke lehtësuar krahasimin në kohë dhe ndërmjet grupeve të popullsisë.

Varfëria absolute, e matur mbi bazën e një konsumi real mujor për frymë nën 4,891 Lekë me çmimet e vitit 2002, ka rënë nga 25.4% në 2002 në 18.5% në 2005. Varfëria absolute e skajshme, e matur mbi bazën e një konsumi real mujor për frymë nën 3,041 lek me çmimet e vitit 2002, për të arritur edhe atë pjesë të popullsisë që do ta kishte të vështirë edhe plotësimin e nevojave bazë ushqimore, ka rënë nga 4.7% në 3.5%.

Për të bërë të mundur një analizë të varfërisë gjatë viteve 2006 dhe 2007 mund t'i referohemi disa treguesve të monitorimit të matur në mënyrë periodike. Një individ cilësohet i varfër nëse niveli i tij i shpenzimeve për frymë bie nën një nivel minimal të nevojshëm për të përmbushur nevojat bazë ushqimore dhe jo-ushqimore. Ky nivel minimal i konsumit përkufizohet si kufiri i varfërisë, e cila shënon kufirin ndarës midis shtresave të varfëra dhe të pasura. Përqindja e popullsisë që jeton me nën 2 USD në ditë për person për vitin 2006 rezulton rreth 18.7%, ndërsa për vitin 2007, rezulton 535,000 banorë ose 16.7 % të popullsisë.

Gjithashtu, një faktor kryesor që ndikon tek varfëria është papunësia afatgjatë. Një rënie të varfërisë gjatë dy viteve të fundit e pasqyron shkalla e papunësisë afatgjatë, një tregues Laeken i përcaktuar si tregues monitorimi në dokumentin e Strategjisë së Përfshirjes Sociale.

Personat që jetojnë në familje ku asnjë anëtar nuk punon, jetojnë në varfëri të plotë. Të dhënat statistikore për këto lloj familjesh tregojnë se, gjatë vitit 2006, në Shqipëri kishte rreth 485,000 persona që jetonin në familje të papuna pa asnjë të ardhur. Gjatë vitit 2007, kjo shifër ka zbritur në 415,000 persona, gjë që tregon se brenda këtij viti rreth 70,000 persona kanë dalë nga niveli i varfërisë. Kjo ka ardhur si rezultat i zbatimit të politikave të ndryshme sociale dhe ato të punësimit që qeveria ka ndërmarrë, si dhe nga zhvillimi ekonomik i vendit dhe hapja e vendeve të reja të punës.

Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) bën të mundur monitorimin e prirjeve dhe karakteristikave të varfërisë. Kjo anketë është kryer për herë të fundit në vitin 2005 dhe pritet të kryhet përsëri brenda vitit 2008. Të dhënat që do të dalin nga ky vërtetim do të japin një pasqyrë dhe analizë të hollësishme të ecures së treguesve të varfërisë gjatë periudhës 2005-2007.

Treguesi: Përqindja e konsumit të kuintilit më të varfër të popullsisë ndaj konsumit kombëtar

Llogaritja e kufirit ushqimor është përqëndruar në një shportë ushqimore që konsumohet nga shtresat e varfëra. Duke u nisur nga rekomandimet e FAO-s mbi konsumin minimal të kalorive sipas moshës dhe gjinisë, e duke përshtatur këto kërkesa për kalori me shpërndarjen e popullsisë në Shqipëri, është vlerësuar që konsumi për frymë në ditë duhet të jetë 2,288 kalori të marra. Bazuar në këtë përlogaritje, përqindja e popullsisë në varfëri të skajshme vlerësohet rreth 3% ose 96,000 banorë.

Në konsumin e popullsisë janë përfshirë konsumi për ushqim dhe pije jo-alkoolike, shpenzimet jo-ushqimore e artikuj familjarë, shërbime (gaz, telefon, energji elektrike), arsim, dhe shpenzime për kujdes personal e transport.

Në konsum nuk përfshihen vlera mesatare e qerasë, shpenzimet për shëndetin dhe vlera e mallrave me afat të gjatë përdorimi. Përqindja e konsumit të kuintilit më të varfër të popullsisë ndaj konsumit kombëtar është 10.9%.

Për të bërë të mundur një analizë të hollësishme lidhur me ecurinë dhe progresin e treguesve të monitorimit si: shkalla e popullsisë në varfëri absolute dhe përqindja e konsumit të kuintilit më të varfër të popullsisë ndaj konsumit kombëtar, qeveria ka parashikuar fondin përkatës për kryerjen e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) për vitin 2008.

3.3.5 SIGURIMET SHOQËRORE


Treguesi: Përqindja e varësisë së sistemit - raporti midis numrit të përfituesve dhe kontribuesve

Në këtë sektor, treguesit më të rëndësishëm janë shkalla e zëvendësimit të pensioneve dhe shkalla e varësisë së sistemit. Bazuar në të dhënat statistikore, niveli i këtyre treguesve për vitet 2006-2007 paraqitet si më poshtë:

<i>Norma e varësisë</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	
Kontribues	522,530	535,362	102.5
Pensione pleqërie	423,354	423,603	100.1
Norma e varësisë	1.23 : 1	1.26 : 1	

Burimi: ISSH

Ndërsa numri i kontribuesve në vitin 2007 kundrejt vitit 2006 është rritur mesatarisht me 2.5%, për shkak të vazhdimit të reformës graduale të rritjes së moshës së daljes në pension, numri i pensionistëve është rritur vetëm me 0.1%. Më poshtë jepet një paraqitje grafike:



Burimi: ISSH

Mbështetur në numrin e kontribuesve në fund të vitit 2007, sipas zhvillimeve aktuale dhe objektivave të synuara për vitin 2008, parashikohet që ky numër të arrijë në fund të vitit mbi 555,000; për subjektet juridike dhe fizike, objektivi është 410,000 kontribues, ndërsa për sektorin bujqësor 145,000. Kjo do të bëjë që raporti i varësisë në fund të vitit 2008 të jetë 1.4 kontribues për 1 pension të pleqërisë.

Treguesi: Norma e zëvendësimit (raporti midis pagës dhe pensionit)

Për shkak të rritjes më të lartë në përqindje të pagave në krahasim me rritjen e pensioneve në fund të vitit 2007 konstatohet një ulje në vlerën e normës së zëvendësimit. Megjithatë, për të rritur të ardhurat e pensionistëve është aplikuar një sistem i qëndrueshëm kompensimi për të ardhurat minimale, i cili për rritjen e çmimit të energjisë dhe të bukës është i njëjtë për të gjithë pensionistët, pavarësisht nga masa e pensionit. Gjatë vitit 2007 është aplikuar për pensionistët e qytetit një kompensim për të ardhurat minimale prej 1,260 Lekë në muaj, ndërsa për pensionistët e fshatit 690 Lekë në muaj.

Për të bërë krahasimin e normës së zëvendësimit në dy vite do të duhej të merrej në analizë llogaritja e një norme zëvendësimi për sistemin, e cila do të mbante parasysh krahasimin e të ardhurave mesatare me pagën mesatare neto.

<i>Treguesi</i>	<i>Viti 2006</i>	<i>Viti 2007</i>
Paga		
Paga mesatare neto	21,229	23,897
Pensioni mesatar		
Të ardhura mesatare	10,113	11,953
Pensioni mesatar	9,081	10,236
Shkalla e zëvendësimit		
Të ardhura mesatare	47.64	50.02
Pensioni mesatar	42.77	42.83

Burimi: ISSH


Për vitin 2008 nuk parashikohen skema të reja kompensuese, por duke filluar nga muaji korrik parashikohet një rritje e pensioneve në masën 10% për qytetin dhe 15% për fshatin. Kjo rritje do të vazhdojë të jetë një kontribut i mëtejshëm në strategjinë e zhvillimit dhe sidomos në uljen e varfërisë. Për vitin 2008 parashikohet një normë mesatare zëvendësimi rreth 49.4%. Norma e zëvendësimit është problematike për kontribuesit që kontribuojnë me pagë maksimale, për të cilët aktualisht norma mesatare e zëvendësimit është jo më e lartë se 35%, por me prirje drejt uljes. Ky element dhe të tjerë përbëjnë çështje për zgjidhje, të cilat e bëjnë të domosdoshme ndërmarjen e reformave.

3.3.6 SHËNDETËSIA

Treguesi: Shkaqet e vdekjeve sipas grup-sëmundjeve për 100,000 banorë (sipas gjinisë)

Sistemi Shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik dhe shërbimet në pjesën më të madhe ofrohen kryesisht nga shteti. Shërbimi shëndetësor diagnostifikues dhe kurues është i organizuar në shërbimin parësor, shërbimin spitalor dytësor, dhe spitalor terciar, të cilat ofrohen nga institucione publike dhe private. Shërbimet e shëndetit publik dhe të këshillimit shëndetësor ofrohen në kuadrin e shëndetit parësor dhe mbështeten e mbikqyren nga ISHP.

Në lidhje me këtë, statistikat tregojnë se një pjesë relativisht e lartë e vdekjeve dhe sëmundjeve në Shqipëri vijnë si pasojë e duhan-pirjes, abuzimit me alkolin, pakujdesisë në rrugë, përdorimit të drogave ilegale, mënyrës së të ushqyerit dhe stresit si një dukuri e re e shoqërisë moderne. Inaktiviteti fizik është një faktor i cili përbën një rrezik potencial për hipertensionin, sëmundjet e arterieve koronare të zemrës, etj. Shkaqet e vdekjeve janë analizuar nga INSTAT mbi bazën e skedës së vdekjes në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar Statistikor të Sëmundshmërisë ICD-9. Sipas INSTAT, struktura e vdekshmërisë së përgjithshme për vitet 2002-2006 ka mbetur pothuaj e pandryshuar.



Burimi: INSTAT


Sipas grafikut rezulton se sëmundjet e qarkullimit të gjakut, tumorale, aparatit të frymëmarrjes, gastrointestinale, infektive, urogenitale dhe insultet cerebrale zënë peshën më të madhe në strukturën e vdekshmërisë së përgjithshme. Vdekshmëria nga sëmundjet e aparatit të qarkullimit është më e përhapur kryesisht te femrat, përkatësisht në rastin e sëmundjeve të enëve të gjakut të trurit, ndërsa te meshkujt në sëmundjet iskemike të zemrës në masën 64%. Sëmundjet tumorale janë veçanërisht në tumoret malinj të aparatit tretës, të frymëmarrjes dhe urogenitale janë të theksuara kryesisht në moshat mbi 50 vjeç. Tumorët malinj të aparatit tretës rezultojnë të jenë dy herë më shumë tek meshkujt se tek femrat, të aparatit të frymëmarrjes janë 3 herë më shumë tek meshkujt, të kockave dhe të gjirit janë 3 herë më shumë tek femrat se tek meshkujt, dhe të organeve urogenitale janë 2 herë më shumë tek meshkujt se tek femrat. Në grupin e dëmtimeve traumatike, helmimeve dhe aksidenteve, rreth 88% e vdekjeve ndodhin nga aksidentet dhe 13% nga traumat dhe helmimet. Vdekjet nga sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes zënë vendin e katërt në strukturën e përgjithshme të shkaqeve të vdekjeve për 100,000 banorë. Për të përmirësuar shëndetin e popullatës dhe për të përmirësuar si rrjedhim këta tregues, Ministria e Shëndetësisë ka instaluar një mekanizëm stimulimi për mjekët e përgjithshëm për të ndjekur në mënyrë periodike të sëmurët kronikë; janë kryer fushata promovimi për dieta të shëndetshme sidomos në grupmoshat e reja, si dhe janë ndërmarrë iniciativa në kuadër të sëmundjeve të kancerit të gjirit. Gjithashtu, Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Duhanit dhe ka miratuar Ligjin Nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

Treguesi: Shkalla e vdekshmërisë foshnjore dhe shkalla e vdekshmërisë amtare

Niveli i disa treguesve si jetëgjatësia, vdekshmëria dhe sëmundjet kronike janë të krahasueshme me vendet e zhvilluara, ndërsa treguesit si vdekshmëria foshnjore e vdekshmëria amtare janë të krahasueshme me ato të vendeve në zhvillim. Sidoqoftë, gjendja shëndetësore e popullsisë mbetet një shqetësim dhe shumica e treguesve përsa i përket rezultateve për shëndetin nuk krahasohen në mënyrë të kënaqshme me nivelet që konstatohen në Rajonin e Evropës Juglindore dhe janë nën mesataren e Rajonit të Evropës. Ndryshimet e shumta që kanë ndodhur 15 vitet e fundit kanë kontribuar për përshejtimin e tranzicionit demografik dhe epidemiologjik.

Cilësia e kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën duhet të forcohet në mënyrë të ndjeshme, në qoftë se Shqipëria përpaket t'i përafrojë përqindjet e vdekshmërisë së nënave dhe atë foshnjore me mesataren e rajonit. Me gjithë uljen e konsiderueshme që arriti gjatë 50 viteve të fundit, vdekshmëria foshnjore, vdekshmëria e fëmijëve nën pesë vjeç dhe vdekshmëria e nënave janë ende ndër më të lartat në Rajonin e Evropës dhe pasqyrojnë më shumë cilësinë e ulët të kujdesit para lindjes, obstetrik dhe pas lindjes, se sa përdorimin e këtij kujdesi.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten treguesit e vdekshmërisë foshnjore dhe amtare, të cilët në Shqipëri karakterizohen nga nivele relativisht të larta (ndonëse në ulje nga viti në vit), shoqëruar me ulje të nivelit të lindshmërisë.



Burimi: MSH

Shifrat zyrtare të MSH-së, bazuar në raportimet e institucioneve shëndetësore publike, tregojnë një vdekshmëri foshnjore prej 16/1,000 lindje gjallë në vitin 2000 dhe 12/1,000 lindje gjallë në 2007, që është ulur nga 35.4/1,000 në vitin 1993. Vitet e fundit shënohet një ecuri në rënie sic shihet edhe nga të dhënat zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë. Për vitin 2007 rezultojnë 33.163 lindje fëmijësh dhe 186 raste vdekjesh. Në vitin 2013, shkalla e vdekshmërisë foshnjore do të ulet në 5 vdekje për 1,000 lindje të gjalla.

Një nga treguesit më domethënës të shëndetit të nënës është vdekshmëria amtare, ecuria e së cilës dëshmon një ulje të nivelit të saj nga viti në vit, duke arritur në përgjysmimin e nivelit të vitit 1990. Për vitin 2007, shifrat e raportuara nga Drejtoria e Statistikës Shëndetësore dhe Teknologjisë së Informacionit në MSH tregojnë se vdekshmëria amtare është 14.5 për 100,000 lindje të gjalla. Reduktimi me dy të tretat i vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç dhe me tre të katërtat i vdekshmërisë amtare deri në vitin 2015 është një nga sfidat për të ardhmen.

Në kuadër të ndjekjes së objektivave po zbatohet sistemi i manaxhimit të integruar të sëmundjeve të fëmijërisë në zona të vështira të vendit; promovimi shëndetësor, kujdesi paralindjes, promovimi i “Spitaleve Mik të Fëmijës” për të promovuar ushqimin e gjirit të nënës, promovimi dhe vënia në dispozicion e metodave moderne të planifikimit familjar, dhe kujdesi për shëndetin riprodhues.

Shëndeti Riprodhues (shëndeti i nënës dhe fëmijës dhe planifikimi familjar) përbën një fushë veprimi me rëndësi themelore në kujdesin shëndetësor në Shqipëri. Në nivelin e Kujdesit Shëndetësor Parësor,


shërbimet e shëndetit riprodhues ofrohen në fshat në qendrat shëndetësore dhe ambulancat, ndërsa në qytet ofrohen në konsultoret e gruas, konsultoret e fëmijëve dhe qendrat e planifikimit familjar. Mbulesa vaksinale e lartë është dëshmi e vëmendjes së duhur të strukturave shëndetësore. Struktura të specializuara në qendër (ISHP) dhe në rrethe (Drejtoritë e Shëndetit Publik) sigurojnë zbatimin e skemës standarde të vaksinimit. Për sa i përket vdekshmërisë foshnjore për 1,000 lindje të gjalla, të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë rezultojnë të jenë në nivele të ndryshme nga INSTAT, si pasojë e burimeve të ndryshme të marrjes të të dhënave¹⁰.

Në kuadër të procesit të decentralizimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor të ndërmarrë këto dy vitet e fundit është përpunuar paketa bazë e shërbimeve, e cila në thelb ka shërbime të shëndetit riprodhues: kujdesi për gruan shtatzanë, kujdesi për gruan pas lindjes, kujdesi për foshnjat dhe fëmijët, vaksinimi dhe planifikimi familjar. Gjithashtu, do të synohet rritja e kujdesit për zhvillimin psikosocial dhe mendor të fëmijës, si pjesë e zhvillimit të shëndetshëm i fëmijës, duke u shtrirë përtej masave për mbijetesën dhe rritjen fizike. Kjo do të arrihet duke bashkëpunuar me pediatër dhe mjekë familjeje, me profesionistë të tjerë të shëndetit, të cilët punojnë në shkolla dhe në struktura të tjera. Kujdes do të vazhdohet të tregohet edhe për shërbimin shëndetësor në shkolla, ku funksionojnë shërbimi i mjekut dhe ai stomatologjik.

¹⁰ Të dhënat e INSTAT bazohen në numrin e vdekjeve të foshnjave marrë në regjistrin e vdekjeve pranë gjëndjes civile, ndërsa të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë merren nga klinikat dhe spitalet në vend.

3.3.7 ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Treguesi: Shkalla neto e regjistrimit në arsimin e mesëm: Numri i studentëve që ndjekin klasën 9-12 në krahasim me popullsinë e grup-moshës përkatëse (14-17-vjeç) (sipas gjinisë)



Burimi: MASH, 2008

Arsimi është në qendër të vëmendjes të politikave prioritare të qeverisë dhe ka njohur mjaft përmirësime gjatë periudhës 2006-2007. Rritja e treguesve në arsim ka ardhur si rezultat i zbatimit të një sërë reformash lidhur me fuqizimin e kapacitetit politikbërës, menaxhues e vendimmarrës, përmirësimin cilësor të procesit mësimor, ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe fuqizimin dhe shtrirjen e arsimit profesional. Gjatë viteve 2006-2007 është punuar për aktualizimin e reformës për strukturën e re të sistemit të arsimit të mesëm, mbi bazën e strukturës së arsimit të detyruar 9-vjeçar. Në vitin 2006 filloi gjerësisht zbatimi i projekteve që synonin pajisjen e të gjitha shkollave të sistemit arsimor parauniversitar me laboratorë të informatikës, si dhe ngritjen e kapaciteteve e ofrimin e trajnimeve të personelit mësimor dhe mirëmbajtës. Më tej, në 2006 u zbatua për herë të parë Matura Shtetërore, nëpërmjet së cilës realizohet një vlerësim i jashtëm kombëtar për arritjet e nxënësve të shkollave të mesme, një proces i ri për pranimet në institucionet e arsimit të lartë publik.

Një tregues i rëndësishëm është shkalla neto e regjistrimit në arsimin e mesëm, ecuria e të cilit është paraqitur në grafikun më sipër, bashkë me të dhëna të tjera të rëndësishme për sektorin. Për vitin shkollor 2007-2008, ky tregues, përfshi këtu arsimin e mesëm me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme, u paraqit në nivelin 57.6%, ku shpërndarja sipas gjinisë ishte 29% femra dhe 28.6% meshkuj. Ndërkohë, krahasuar me vitin e shkuar shkollor 2006-2007, ky tregues ishte në nivelin 55%, rezultat që përfaqëson një rritje prej 2.5%. Njëkohësisht, kjo rritje prej 2.5% është më e madhe edhe se rritja prej 2% nga viti 2005-2006 (53%) në vitin 2006-2007 (55%). Gjatë vitit shkollor 2008-2009, për shkak se për herë të parë ndodh kalimi i nxënësve në klasën e nëntë të sistemit 9-vjeçar, nuk do të ketë tërheqje në arsimin e mesëm. Duke marrë parasysh reformat e ndjekura deri tani, nivelin e arritur si rezultat i tyre, si dhe vazhdimin e zbatimit të tyre, parashikimi për shkallën neto të regjistrimit në vitin 2009-2010 është 60%.

Krahasuar me vendet e rajonit dhe me mesataren e Europës, Shqipëria shfaq ende një nivel të ulët të shkallës neto të regjistrimit në arsimin e mesëm, edhe pse vitet e fundit kjo shkallë ka qenë vazhdimisht në rritje. Kështu, vende si Maqedonia (80%), Serbia (82%) e Kroacia (84%) janë shumë pranë nivelit mesatar europian, i cili qëndron në rreth 85%. Me thellimin e mëtejshëm të reformave tashmë të nisura synohet që shkalla neto e regjistrimit të jetë në një rritje minimale prej 2.5% për vitin 2009. Synimi strategjik është që në vitin 2013 shkalla neto e regjistrimit në arsimin e mesëm të rritet deri në 76%, ndërsa përqindja e tërheqjes në arsimin e mesëm të jetë në masën 86%.

Politikat që janë ndjekur gjatë kësaj periudhe kanë synuar gjithashtu rritjen e përqindjes së nxënësve që frekuentojnë arsimin profesional. Gjatë kësaj periudhe është përgatitur dhe drafti i Kornizës Shqiptare

të Kualifikimeve në përshtatje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Gjithashtu, janë përmirësuar programet e reja mësimore për të gjitha llojet e shkollave tekniko-profesionale, janë ofruar lehtësira për nxënësit që do të ndjekin këtë lloj arsimimi, etj.

Në vijim të mbështetjes të sektorit të arsimit profesional do të synohet forcimi i sistemit të AFP-së, si dhe zbatimi i politikave për nxitjen e formimit dhe zhvillimit profesional në përgjigje të kërkesave të tregut. Do të vijohet me përmirësimin e programeve mësimore të AFP-së, do të nxiten, do të jepen bursa për nxënësit që do të vazhdojnë këto shkolla, pavarësisht kriterëve ekonomike. Ndërkohë, do të bëhet e mundur që në arsimin e përgjithshëm të zhvillohen dhe module të lëndëve profesionale, me synim përfshirjen e një mase më të madhe nxënësish në arsimimin profesional.

Në proces është konsolidimi i Maturës Shtetërore si strukturë dhe po pasurohet me elementë të rinj si Këshillimi për Karrierën, etj. Për periudhën në vijim, rritja e mëtejshme e treguesve të sektorit do të sigurohet edhe nga programi i filluar në vitin 2006 “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, i mbështetur nëpërmjet kredive të Bankës Botërore, Bankës Evropiane të Investimeve dhe Bankës së Këshillit të Evropës, në të cilin janë sintetizuar një sërë objektivash dhe qëllimesh të politikave arsimore.

3.3.8 ARSIMI I LARTË

Treguesi: Numri i studenteve në arsimin e lartë, sipas statusit me kohë të plotë / të pjesshme


Zgjerimi dhe forcimi i sistemit të arsimit të lartë përbën një përparësi në kuadrin e politikave të zbatuara dhe atyre në vijim të qeverisë shqiptare. Në mënyrë që të plotësohen nevojat e vendit, është e nevojshme të krijohen njëkohësisht mundësi për arsimim të lartë të të gjithë atyre që dëshirojnë të përfitojnë prej tij. Për këtë, duhet të sigurohet numri i nevojshëm i personelit akademik me kualifikim të përshtatshëm. Raporti aktual student/personel akademik (rreth 26) është më i lartë se mesatarja e BE (20), por në stadin aktual të zhvillimit të vendit, ky nivel mund të konsiderohet deri diku i pranueshëm. Në vitin 2006-2007 u arrit që mbi 90% e atyre që përfunduan shkollën e mesme të regjistrohen në arsimin e lartë (pa përfshirë shkollimet jashtë vendit).

Gjatë harkut kohor 2006-2007 janë zbatuar një sërë masash me synim: (i) reformimin e kurrikulës në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, për të qenë të njëjta në programe studimi të ngjashme në institucione të ndryshme të arsimit të lartë, në modularizimin e lëndëve; (ii) futjen e krediteve si masë për punën e studentëve; (iii) rritjen e mundësive të mobilitetit të studentëve; (iv) organizimin e formave të studimit me kohë të pjesshme apo në distancë, të orientuar drejt të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Në këtë kuadër, u hartua dhe miratua Ligji “Për Arsimin e Lartë” në maj 2007 dhe ka vazhduar puna për nxjerrjen e akteve nënligjore, kryesisht për organizimin e studimeve në të tre ciklet e studimit, përcaktimin e standarteve për programet e studimit dhe strukturat organizative, menaxhimin e universiteteve, duke ju siguruar atyre lirinë akademike dhe autonominë financiare.

Gjatë vitit 2006-2007, të gjitha institucionet e arsimit të lartë u përfshinë në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm për akreditimin e tyre. Për herë të parë, nëpër institucionet e arsimit të lartë u ngritën dhe funksionuan grupet e vlerësimit të brendshëm. Në procesin e akreditimit u përfshinë edhe institucionet private të arsimit të lartë.

Në sistemin e arsimit të lartë për vitin 2006-2007 janë rregjistruar 86,178 studentë, nga të cilët 82,267 rezultojnë në arsimin e lartë publik, ndërsa në arsimin e lartë jo-publik rezultojnë 3,911 studentë. Një numër 22,395 studentë rezultojnë të jenë rregjistruar në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe me korrespondencë dhe 63,783 studentë në sistemin me kohë të plotë. Për vitin shkollor 2007-2008, numri i studentëve të regjistruar në arsimin e lartë është 88,438, ku në arsimin publik janë regjistruar 78,932 studentë dhe në atë jo-publik 9,506. Numri i studentëve në sistemin me kohë të plotë në këtë periudhë është 71,795.



Burimi: MASH

Numri i studentëve në arsimin e lartë është rritur në sajë të politikave të ndërmarra për nxitjen e të rinjve për t'u arsimuar, shtimit të kapaciteteve të universiteteve, si dhe shtimit të programeve të reja të studimit, duke i bërë ato më tërheqëse për ta si dhe më të përshtatshme me tregun e

punës. Rritja e numrit të studentëve është mbështetur edhe me rritjen e numrit të pedagogëve, si dhe integrimin e instituteve kërkimore shkencore tek universitetet, duke rritur kështu kapacitetet akademike, laboratorike e shkencore.

Numri i studentëve në formën e studimeve me kohë të pjesshme nuk është rritur; kjo formë studimi është në procesin e reformimit, me synim rritjen e cilësisë dhe arritjen e standardeve europiane. Pranimet e reja në arsimin e lartë publik janë rritur me 1.17% në krahasim me vitin akademik paraardhës. Në këtë vit shkollor u hap Universiteti Publik Aleksandër Moisiu në Durrës. Po kështu, në 2006 u hapën Filiali i Universitetit të Tiranës në Sarandë dhe në 2007 në Kukës, duke u kthyer në qendra të zhvillimit të këtyre zonave. Në këtë periudhë u hapën dhe 9 universitete të reja jo-publikë, duke rritur 3.3% numrin e studentëve në arsimin jo-publik në krahasim me një vit më parë.

Sipas publikimeve të OECD-së, numri i studentëve shqiptarë që studjojnë jashtë shtetit, në vendet anëtare të OECD-së, për vitin 2005-2006, ka qenë 15,244, ndërsa për vitin shkollor 2006-2007 ka qenë 17,429 studentë. Numri më i madh i studentëve paraqitet në Itali, Greqi, Gjermani, Turqi, Francë, etj. Për përthithjen e këtyre kapaciteteve intelektuale në shërbim të zhvillimit të vendit u ndërmor në vitin 2006 iniciativa e projektit "Brain Gain", mbështetur nga PNUD-i.

Për të mbështetur zhvillimin e shpejtë të burimeve njerëzore në arsimin e lartë, Qeveria Shqiptare ka filluar të zbatojë që në vitin 2007 një program të veçantë të emërtuar "Fondi i Ekselencës", i cili ofron bursa për studimet e doktoratës dhe postdoktoratës në universitetet e huaja të njohura, si edhe mbështet studentët shqiptarë që kryejnë studimet e nivelit master në një nga 10 universitetet më të mira të botës.

3.4 ZHVILLIMI URBAN, RURAL DHE RAJONAL

Nxitja e zhvillimit të barazpeshuar të rajoneve të vendit ka qenë pikë kyçe për orientimin e politikave të zhvillimit urban, rural dhe rajonal.

Politikat e ndërmarra në vitet e fundit janë përqëndruar në vijimin e procesit të legalizimit të zonave informale, rehabilitimin e sipërfaqeve publike, si dhe kryerjen e investimeve në infrastrukturën dhe shërbimet publike. Investimet publike për përmirësimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës publike kanë qenë të orientuara dhe harmonizuara me prioritetet për zhvillimin e turizmit.

3.4.1 PLANIFIKIMI HAPËSINOR

Treguesi: Përqindja e bashkive të pajisura me një plan urban sipas ligjit të urbanistikës

Zhvillimi urban në vitet e fundit është përpjekur të adresojë sfidat e kontrollit mbi territorin dhe planifikimin strategjik hapësinor, të orientuar nga një vizion i qartë i reformave për zhvillimin e vendit.

Për periudhën 2006-2007, në lidhje me treguesin e përqindjes së bashkive të pajisura me një plan urban sipas Ligjit Nr. 8405 dt.17.09.1998 “Për Urbanistikën” në fuqi, janë miratuar kryesisht plane rregulluese që nxisin zhvillimin ekonomik dhe turizmin në vend. Në tabelën e mëposhtme paraqiten zonat të cilave u është miratuar detyra e projektimit apo plani urbanistik.

Nr.	Datë	Miratimet nga KRRTRSh
1	07.02.2006	Miratimi i Studimit Rajonal dhe Mjedisor të zonës Selitë, Sauk, Farkë, Lundër, Mullet dhe Petrelë.
2	26.05.2006	Miratimi i Detyrës së Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Tiranës.
3	01.06.2006	Miratimi i studimit urbanistik të zonës në perëndim të Qytetit të Tiranës (Komuna Kashar), me sipërfaqe 235.5 ha.
4	04.08.2006	Miratimi i Detyrës së Projektimit për Masterplanin e Komunës Dajt
5	21.11.2006	Miratimi i Detyrës së Projektimit për Studimin e Integruar të Zonës Turistike Rrashbull-Golem-Karpen
6	01.03.2007	Miratimi i Detyrës së Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Fshatit Voskopojë
7	22.05.2007	Miratimi i Studimit Urbanistik të Qendrës së Qytetit të Kavajës.
8	26.10.2007	Miratimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Fierit.
9	26.10.2007	Miratimi i Studimit Urbanistik të Qendrës së Qytetit të Durrësit

Burimi: MPPTT


Mbetet ende mjaft për të bërë në drejtim të përfundimit të planeve të përgjithshme rregulluese të qyteteve: Durrës, Kamëz, Shkodër, Lushnjë, Vlorë, Gjirokastrë, Berat, Korçë, të cilat kanë filluar të hartohen gjatë vitit 2007 në kuadër të Projektit për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës (LAMP), me fonde të buxhetit, Bankës Botërore, Qeverisë Suedeze dhe Qeverisë Japoneze. Më tej, është në përfundim hartimi i Planit të Zhvillimit të Bregdetit të Jugut, nëpërmjet përmirësimit të metodologjisë dhe konceptit të planifikimit të zonave bregdetare, që ka për qëllim zhvillimin e integruar të turizmit me aktivitetet social-ekonomike e mjedisore për zonën jugore të vendit.

Gjatë kësaj periudhe janë miratuar një sërë projektligjesh të rëndësishme në lidhje me legalizimin e ndërtimeve informale, ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik të përfutur nga fotografimi ajror dixhital, ligji për policinë ndërtimore, etj. Ndërkohë, ende pritet të përfundojë hartimi i projektligjit për Planifikimin Hapësinor, i cili do të adresojë një sërë problematikash të sektorit.

3.4.2 ZHVILLIMI RAJONAL

Treguesi: Niveli i Zhvillimit Socio-Ekonomik

Integrimi në BE kërkon një realizim të politikës rajonale kombëtare të harmonizuar me politikën rajonale të BE-së. Një hap i parë në këtë drejtim është hartimi dhe miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal (SNZHR) në nëntor të vitit 2007. Strategjia konsiderohet si një dokument kyç në orientimin dhe koordinimin e politikave sektoriale për një rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm, nëpërmjet mobilizimit të potencialeve ekonomike dhe njerëzore të rajoneve dhe zbutjes së diferencave të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror ndërmjet rajoneve. Zbatimi i kësaj strategjie përfshin (i) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit të qarqeve, në të njëjtën linjë me prioritet kombëtare të zhvillimit (ii) zbatimin e politikave rajonale kombëtare të harmonizuar me politikat rajonale të BE-së, duke mbështetur arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit lidhur me zhvillimin rajonal. Kuadri i politikave të SNZHR-së orientohet drejt vizionit të Qeverisë për një rritje të barazpeshuar dhe të qëndrueshme ekonomike-shoqërore të të gjithë zonave të vendit, sidomos atyre malore dhe periferike.



Burimi METE, 2008

Niveli i zhvillimit rajonal të qarqeve monitorohet nëpërmjet treguesit të zhvillimit ekonomik-shoqëror. Ky tregues përllogaritet mbi bazën e disa treguesve që janë: (i) treguesi i nivelit të varfërisë mbi mesataren kombëtare në përqindje; (ii) niveli i papunësisë së qarkut në raport me mesataren kombëtare në përqindje; (iii) të ardhurat e qeverisjes vendore mbi mesataren kombëtare në përqindje; (iv) mundësia e furnizimit me ujë mbi mesataren kombëtare në përqindje; (v) numri i vizitave shëndetsore mbi mesataren kombëtare në përqindje; (vi) niveli i arsimit të detyruar në raport me mesataren kombëtare në përqindje.

Në grafikun më sipër paraqitet ecuria e treguesit të zhvillimit ekonomik-shoqëror i të gjithë qarqeve për vitin 2007, i krahasuar me mesataren kombëtare. Nga grafiku konstatohet qartë se qarqet me zhvillim më të ulët, nën nivelin 75%, janë Dibra, Kukësi, Lezha dhe Shkodra,


Gjatë periudhës 2006-2007 janë hedhur hapat e parë në drejtim të vënies në zbatim të Planit të Veprimit të SNZHR-së. Ngritja e strukturave institucionale dhe hartimi i kuadrit bazë ligjor për zbatimin e SNZHR-së kanë qenë në qendër të vëmendjes së debatit dhe përpjekjeve për krijimin e strukturës institucionale për zbatimin e SNZHR-së.

3.4.3 ZHVILLIMI RURAL

Treguesi: Madhësia mesatare e njësive ekonomike bujqësore (ha) Krahasuar me vendet e EJT-së

Zhvillimi i sektorit bujqësor dhe i ekonomisë rurale jo-bujqësore është orientuar drejt zhvillimit të integruar rural, i cili përfshin edhe zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve, ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit, si edhe menaxhimin efektiv në konsolidimin e tokës bujqësore.

Në këtë kuadër, kujdes i veçantë do t'i kushtohet nxitjes së formimit të fermave të mëdha bujqësore, me synimin që pas vitit 2013 madhësia mesatare e njësive ekonomike bujqësore të arrijë 1.8 ha. Aktualisht, madhësia mesatare e fermës në Shqipëri është 1.1 ha, e cila krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor paraqitet e fragmentarizuar në parcela më të vogla. Grafiku i paraqitur jep pozicionimin e Shqipërisë kundrejt vendeve të rajonit.



Burimi: MBUMK

Struktura e fermave bujqësore në Shqipëri reflekton mënyrën se si është realizuar privatizimi i tokës bujqësore. Pas privatizimit të tokës bujqësore në Shqipëri, copëzimi i tokës ka vazhduar si rezultat i dukurisë së trashëgimisë. Rreth 70% e fermave në Shqipëri ndodhen në zonat malore, ku nga këto vetëm 35% janë ferma të orientuara drejt tregut, duke qenë se janë më pranë zonave urbane dhe në tokat më pjellore. Në Bullgari, toka bujqësore është 6,2 milion ha, ku 77% është tokë arë dhe 23% kullota. Kullotat në 29% të tyre janë private, ku 33% janë pronë e kooperativave, ndërsa 71% e kullotave janë shtetërore.

Sipas regjistrimit të kaluar, 71% e tokës bujqësore në vend zotërohet nga 354,626 pronarë dhe mesatarja për fermë luhet në 1.1 ha. Nga vendet e rajonit, Bullgaria ka një madhësi mesatare të fermës prej 2 ha të shpërndarë në 4-5 parcela, Rumania paraqitet me madhësi mesatare prej 2.28 ha të shpërndarë në 3-4 parcela, ndërsa në Serbi madhësia mesatare e fermave është 3,68 ha.


Në Rumani, totali i tokës bujqësore është 14.8 milion ha dhe përfaqëson 63% të territorit të vendit. Gjatë reformës së tokës, rreth 9.4 milion ha tokë u privatizua, pa llogaritur rreth 1.3 milion ha të privatizuara që janë në zonat malore, ndërkohë që 4.09 milion ha kanë mbetur pronë shtetërore. Fermat me madhësi më pak se 1 ha zënë 45%, fermat me madhësi 1-2 ha përbëjnë 24% dhe fermat me më shumë se 2 ha zënë 31% të totalit të tokës bujqësore. Në Serbi, rreth 80% e tokës bujqësore është e privatizuar dhe numërohen rreth 778,891 ferma, nga të cilat ato nën 2 ha zënë 12% të tokës arë dhe 25% të tokës arë e zënë fermat me mbi 10 ha të shpërndara në 2-3 parcela.

Vëmendje e veçantë do i kushtohet vazhdimin të politikave të zhvillimit rural, si mënyra më efektive për të ulur varfërinë në zonat rurale. Për këtë arsye, përmirësimi dhe konsolidimi i fermave të vogla shihet me përparësi. Në kuadër të zhvillimit të integruar po nxitet konsolidimi i fermave nëpërmjet ngritjes dhe fuqizimit të shoqatave të fermerëve, nxitjes së efektivitetit të fermave me futjen e teknologjisë bujqësore, krijimin e mundësive për hyrje në treg të fermerëve. Realizimi i këtyre nismave do të çojë në forcimin e sistemit të marketingut dhe nivelit të arsimit teknik të operatorëve të fermave, i cili do të ndikojë pozitivisht në konkurrueshmërinë e tregut dhe përballimin e kërkesave ndaj produkteve ushqimore.

Treguesi: Numri i kilometrave të rrugëve rurale që janë ndërtuar

Krahas nxitjes së rritjes së prodhimit dhe krijimit të mundësive për punësim në zonat rurale, një element i rëndësishëm i zhvillimit rural të integruar ka qenë ndërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës rurale. Rehabilitimi dhe përmirësimi i menaxhimit të infrastrukturës rurale ka përfshirë rrugët rurale, kullimin dhe ujitjen, si dhe furnizimin e zonave rurale me ujë dhe energji elektrike. Infrastruktura rurale dhe shtrimi i rrugëve rurale ka si qëllim përmirësimin e aksesit në shërbimet bazë dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik për popullsinë rurale, përfituese në zonat e rrugëve të rehabilituara.

Një tregues i rëndësishëm i ndërhyrjeve në infrastrukturën rurale është edhe numri i kilometrave të rrugëve rurale që janë ndërtuar. Në total, numri i përgjithshëm i projekteve të zbatuara gjatë viteve 2006-2007 është 111 projekte, që do të thotë 220 km rrugë rurale dhe dytësore. Me ndërtimin e rrugëve rurale, jo vetëm është përmirësuar infrastruktura në këto zona, por është mundësuar hyrja në treg e ekonomive të vogla bujqësore, si edhe nxitur zhvillimi i aktiviteteve për rritjen e punësimit.



Burimi: FSHZH

Sipas grafikut të mësipërm, projektet janë shtrirë në të gjitha qarqet e vendit, duke u përqëndruar më tepër në zonat me rëndësi ekonomike dhe sociale, si zonat kufitare, turistike, si edhe zonat që janë nyje të korridoreve të rëndësishëm të transportit në vend. Projektet për përmirësimin e infrastrukturës janë përzgjedhur duke u nisur nga vlerësimi i tipareve teknike, ekonomike, si edhe funksioni shoqëror për zonën. Këto investime publike kanë kontribuar në përmirësimin e nivelit të jetesës, si edhe uljen e varfërisë.

Zhvillimi i bujqësisë është prioritet për qeverinë dhe zhvillimi i vendit në këtë sektor do të përqëndrohet në ndërtimin e infrastrukturës rurale, që është baza mbi të cilën do të ngrihen edhe ndërtime të tjera.

3.4.4 BUJQËSIA

Treguesi: Prodhimtaria në bujqësi dhe në agropërpunim (Lekë/të punësuar).

Prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e fermës kanë pasur prirje të dukshme rritjeje. Kontributi i bujqësisë në PBB është i lartë e arrin në 21%, ndërsa numri i të punësuarve në bujqësi ka arritur në 58%. Prodhimi blegtoral zë rreth 46% të prodhimit të përgjithshëm të sektorit, i ndjekur nga bimët e arave me rreth 44% dhe pemtaria me rreth 11%. Prodhimtaria, prodhimi dhe të ardhurat nga bujqësia mbeten akoma mjaft të ulta, krahasuar me vendet e BE-së, si rezultat i disa faktorëve prodhues kryesorë dhe efikasitetit të ulët të përdorimit të atyre ekzistues.

Treguesi: Pjesa e prodhimeve bujqësore të shitura për vitin 2006 rezulton të jetë rreth 35%¹¹ dhe për vitin 2007 rreth 36%. Kjo ka rezultuar sipas vlerësimeve të përafërta, pasi aktualisht nuk ka statistika për këtë tregues. Parashikohet që treguesi të vendoset për t'u llogaritur duke marrë të dhënat e duhura në programin statistikor të vitit 2008.


Prodhimtaria në bujqësi është vështirë të llogaritet, pasi nuk ka të dhëna të qarta për numrin e të punësuarve në këtë sektor. Gjithashtu, dhe nga ana e INSTAT-it ende nuk është llogaritur vlera e shtuar në bujqësi. Për prodhimtarinë në agropërpunim është marrë për bazë produkti bruto i agroindustrisë. Në këtë sektor, për vitin 2006 produktiviteti rezulton të jetë 46,431 milionë Lekë dhe në vitin 2007 ai është rritur deri në 47,970 milionë Lekë.

Sfidat kryesore për politikë-bërësit në sektorin e bujqësisë janë transformimi i bujqësisë, larg prodhimit të orientuar për konsum, në një sektor modern dhe konkurrues, paralelisht me krijimin e mundësive për të ardhura alternative për popullsinë rurale që po largohet nga ky sektor. Reformat e politikave bujqësore duhen ndërmarrë brenda kontekstit të kërkesave aktuale dhe atyre të perspektivës së BE-së, përfshirë harmonizimin me legjislacionin dhe standartet e evropiane, si edhe me përmirësimin e konkurrencës nëpërmjet rritjes së prodhimit dhe cilësisë.

¹¹ Për vlerësimin e pjesës së prodhimeve bujqësore të shitura është patur parasysh numri i fermave që operojnë dhe shesin në treg, i cili konsiderohet të jetë rreth 70%. Duke qenë se mesatarja e të punësuarve në fermë është rreth 2 persona, rezulton që pjesa e prodhimeve bujqësore të shitura të jetë rreth 35%.

Treguesi: Vëllimi i eksporteve në bujqësi dhe agroindustri (mijë Lekë)

Eksportet në bujqësi dhe agroindustri kanë ardhur në rritje. Produktet agroindustriale me rritje më të shpejtë janë perimet e përpunuara, bimët medicinale dhe uji mineral. Pesha e eksportit të produkteve bujqësore dhe agropërpunuese në vitet e fundit vazhdon të mbetet në nivele të ulta. Në vitin 2007 eksportet e këtij sektori arritën vlerën prej 7,473 milion Lekë ose 7.3% e totalit të eksporteve, e cila përfaqëson një rritje prej 12.5% ndaj vitit 2006. Ndërsa në vitin 2006, ky sektor ka arritur në një vlerë 6,643 milion Lekë ose 7.9% të totalit të eksporteve, një rritje me 19% ndaj vitit 2005.



Burimi: MBUMK

Produktet bujqësore, për grupet “Peshk dhe kafshë guaskore të nënujshme”, janë rritur në 2006 me 41.5% krahasuar me vitin 2005 dhe në 2007 me 36.5% më shumë se në vitin parardhës. Në grupin e “Farëra vajore, bimë industriale dhe medicinale, ushqim për kafshët”, për vitin 2006, ka rezultuar një rritje prej 4.9% (krahasuar me vitin 2005) dhe në vitin 2007 rritja ka vazhduar duke arritur në 14.7% (krahasuar me vitin 2006).

Vlera e eksportit në grupet “Ushqimet e përgatitura prej mishi, peshku, molusqe, etj”, krahasuar me vitin 2005, është rritur me 29.9% në vitin 2006. Por, kjo vlerë ka pësuar ulje me 9.3% në vitin 2007, duke mos ruajtur ecurinë e rritjes së vitit 2006.


Grupi “Pije, alkool dhe uthull” ka pësuar gjithashtu rënie me 3.2% në 2006, por vlera e saj përgjithshme është rritur në 2007 në nivelin 31.2%. Për grupin “Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit”, vlera e eksportit në vitin 2006 ka ardhur duke rënë në 24.7%, por kjo vlerë është rritur një vit më pas në nivelin 45.4%. Destinacionet kryesore të eksporteve agro-ushqimore janë Italia, Kosova, Greqia, Gjermania dhe SHBA.

Në rritjen e eksporteve kanë ndikuar një numër faktorësh që kanë të bëjnë me rritjen e investimeve private në agroindustri (për vitin 2006 dhe 2007 janë investuar përkatësisht mbi 20 dhe 30 milion Lekë); rritjen e prodhimit vendas, sidomos në perime dhe fruta, në sajë të politikave subvencionuese të qeverisë për vitet 2007 dhe 2008; mbështetjen e zhvillimit të tregjeve bujqësore përmes investimeve të Qeverisë dhe Bankës Botërore, që ka ndodhur dhe pritjet të vazhdojë edhe më vonë.

Në kuadër të rritjes dhe mbështetjes për eksportet në bujqësi dhe agroindustri, rëndësi do i jepet edhe vazhdimësisë së kontrolleve veterinarë dhe fitosanitare, duke synuar përfitimin maksimal nga konçesionet tregtare në kuadër të MSA-së.

3.4.5 TURIZMI

Treguesi: Numri i turistëve sipas rajoneve të origjinës



Burimi: MTKRS

Turizmi në dy vitet e fundit ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm dhe gjithashtu edhe infrastruktura turistike ka përmirësuar të dukshëm. Njësitë akomoduese janë shtuar dhe janë përmirësuar standartet e shërbimit. Investimeve në infrastrukturën rrugore, sidomos në zonat turistike, i është kushtuar vëmendja e duhur.

Më sipër janë paraqitur dy grafikë. Në panelin e majtë, numri i përgjithshëm i vizitorëve të huaj ditorë është zbrërthyer sipas qëllimit të udhëtimit: pushime (pushime, zbavitje, vizitë në miq e të afërm), biznes dhe të tjera (vizita shëndetësore, etj). Të dhënat janë të përmuajshme dhe merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit, e cila e mbledh informacionin statistikor në të gjitha pikat e kalimit kufitar, tokësor, detar dhe ajror. Numri i vizitorëve të huaj në vitin 2007 ka një rritje me 19% krahasuar me vitin 2006, dhe krahasuar me vitin 2005 rritja është 46%¹².

Në panelin e djathtë paraqitet numri i vizitorëve të huaj sipas nënshtetësisë. Janë grupuar vizitorët nga vende të rajonit, vendet fqinje, vende të Europës Qendrore dhe Lindore, vende të Europës Veriore dhe Perëndimore, si edhe të tjerë. Numrin më të madh të vizitorëve për vitin 2007 e kanë vizitorët nga Kosova (KO) 31%, Maqedonia (MK) 24%, Mali i Zi (MN) 11%, Italia (ITA) 9% Greqia (GRE) 6%, Britania e Madhe 6%, etj. Raportet e vizitorëve nga Europa Veriore dhe Perëndimore (EVP), ashtu si vendet e Europës Qendrore dhe Lindore (EQL), të cilat janë një grup i synuar në perspektivën afatgjatë, janë rritur në mënyrë të dukshme. Numrin më të madh të vizitorëve të huaj e përbëjnë europianët me 92% dhe më pas amerikanët me 5%, aziatikët me 2% dhe të tjerë me 1%.

Në vitin 2007, numri i vizitorëve të huaj me netë qëndrimi është 966,900, ndërsa vizitorë ditorë 131,800 persona. Këtu nuk janë llogaritur emigrantët shqiptarë, që sipas përkufizimit të turistit nga Organizata Botërore e Turizmit, edhe ata konsiderohen të tillë. Strategjia e Turizmit ka përcaktuar si objektiv deri në vitin 2012 arritjen në një numër prej 1,25 milion vizitorë dhe rritjen e kontributit të turizmit në PBB me 15% të PBB-së.

Qeveria ka si objektiv zhvillimin e turizmit të interesit të veçantë (kulturor dhe mjedisor), të kombinuar me turizmin e plazhit dhe të biznesit. Për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të zhvillimit të turizmit, politikat në sektorin e turizmit janë të orientuara drejt menaxhimit të integruar të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

¹² Janë llogaritur vetëm të huajt, ndërsa emigrantët nuk janë përfshirë, megjithëse sipas OBT-së dhe përkufizimit të turistit duhen llogaritur edhe emigrantët, sepse nuk jetojnë në Shqipëri.

4 SHTOJCË: RAPORTI I OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË MIJËVJEÇARIT PËR VITIN 2007

OZHM 1: Zhdukja e varfërisë të skajshme, urisë dhe dimensioneve të tjera të varfërisë

Synimi 1: Përgjysmimi ndërmjet viteve 2002 dhe 2015 i përqindjes së njerëzve që jetojnë në varfëri të skajshme

Synimi 2: Ulja ndërmjet viteve 2002 dhe 2015 e përqindjes së njerëzve që vuajnë nga keqyshqyerja

Synimi 3: Ulja ndërmjet viteve 2002 dhe 2015 e papunësisë për të arritur standardet e BE-së

Synimi 4: Krijimi i një sistemi të hapur tregtar dhe financiar për zhvillimin ekonomik gjithëpërfshirës

Synimi 5: Vënia në dispozicion e teknologjive të informacionit e të komunikimit

Synimi 6: Rritja e mundësisë për energji elektrike për të gjithë

Treguesit	Burimi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Synimi 2015
Shkalla e varfërisë absolute (%)	LSMS	25.4	m ¹³	m	18.5	m	m	13
Shkalla e varfërisë së skajshme (%)	LSMS	4.7	m	m	3.5	m	m	0
Pjesa e 20% më të varfërve ndaj konsumit në rang kombëtar (%)	LSMS	14	m	m	8.2	m	m	>13
Frekuenca e nënpeshës tek fëmijët nën 5 vjeç (%)	LSMS	m	m	m	8	m	m	8
Norma e papunësisë (%)	INSTAT	15.8	15	14.4	14.1	13.8	13.5	10
Investimet e huaja direkte (FDI) (milion USD)	INSTAT ¹⁴	153	158	277	224	259	463 ¹⁵	600
Përdoruesit e linjave telefonike fikse (për 100 persona)	PM ^{**}	7.4	8.3	8.6	11.3	m	m	58
Përdoruesit e celularëve (për 100 persona)	PM	27.2	35.8	39.4	48.9	60.8 ¹⁶	m	78
Kompjuterat personalë (për 100 persona)	PM	1.17	1.37	1.5	1.73	3.81	m	35
Përdorues interneti (në %)	PM	0.39	0.98	2.35	6.01	14.98	m	35

*m - mungon ** PM - Projekti i Mijëvjeçarit

Të dhënat e Anketës për Matjen e Standardeve të Jetesës (LSMS) dëshmojnë një përparim të dukshëm drejt uljes së varfërisë, e cila do ta lejojë Shqipërinë të arrijë synimet e saj. Modeli i zhvillimit ishte i suksesshëm në nxjerrjen e mijëra njerëzve nga niveli i varfërisë. Ulja e varfërisë ka qenë më e dukshme në Tiranë, në zonat urbane dhe malore; varfëria në zonat malore u ul me 22%, nga 47% në 2002 në 25% në 2005¹⁷. Një analizë më e thellë e varfërisë nxjerr në pah si më poshtë: (i) varfëria është kryesisht një fenomen i përqëndruar në zonat rurale; një në katër persona në zonat rurale është i varfër; tre në katër persona jetojnë në fshat; (ii) brenda zonave rurale, varfëria është më e përhapur në zonat malore, megjithëse vihet re një ulje e madhe e varfërisë edhe në këto zona; (iii) varfëria është më e lartë tek kryefamiljarët meshkuj në moshë të re dhe më e ulët tek kryefamiljarët gra; dhe (iv) ulja e varfërisë ka ndodhur më shumë për shkak të rritjes ekonomike sesa të shpërndarjes.

¹³ Nuk ka burime alternative të dhënash ndaj atyre të LSMS-së. LSMS-ja tjetër pritet të publikojë rezultatet në 2009, me të dhëna nga viti 2008.

¹⁴ Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

¹⁵ Burimi: Banka e Shqipërisë, 2008, Raporti 2007

¹⁶ Burimi për abonentët e celularëve, kompjuterët personalë dhe përdoruesit e internetit: Faqja e internetit e Projektit të Mijëvjeçarit

¹⁷ Banka Botërore, 2007: Shqipëria - Zhvillimi urban, migracioni dhe ulja e varfërisë: vlerësimi i varfërisë

Popullsia e varfër në zonat rurale mbështetet kryesisht në një bujqësi jo-efikase dhe në përgjithësi niveli i punësimit jashtë sektorit bujqësor është i ulët. Fermat e vogla nuk janë produktive dhe prodhimtaria aktuale përbën vetëm një të tretën e kapacitetit prodhues ekzistues. Nga ana tjetër, zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme është i kufizuar, sepse rentabiliteti i këtyre ndërmarrjeve në zonat rurale, veçanërisht në zona të largëta, është i ulët kryesisht për shkak të infrastrukturës akoma të varfër (të trashëguar), nivelit të ulët arsimor, etj.

Ndërmjet zhvillimit ekonomik e uljes së varfërisë dhe rrezikut të përjashtimit social ekziston një lidhje pozitive, e cila kërkon hartimin e politikave që: (i) nxisin zhvillimin ekonomik në të gjithë sektorët, si mënyra më e mirë për të ulur varfërinë; (ii) u ofrojnë njerëzve mundësi në burime (njohuri, tokë dhe burime financiare), veçanërisht atyre që jetojnë në zona rurale e që bazohen në fermat e vogla, dhe i kushtojnë vëmendjen e duhur grupeve më të prekshëm (atyre në zonat e pazhvilluara, romëve dhe egjiptianëve dhe familjeve të reja); (iii) zhvillojnë kapitalin social që është një parakusht për veprimin e nevojshëm kolektiv në fermat e vogla dhe për zhvillimin e ekonomisë sociale në përgjithësi. Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të mbrojtjes dhe të përfshirjes sociale në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 (SKZHI) trajtojnë problemet e përjashtimit social.

Shqipëria ka bërë hapa të shpejtë për uljen e varfërisë absolute dhe asaj të skajshme. Synimet që lidhen me varfërinë absolute dhe të skajshme së shpejti do të rishikohen në kuadër të rishikimit të OZHM-ve, me qëllim paraqitjen e synimeve të reja dhe ambicioze për varfërinë relative sipas modelit të Bashkimit Evropian. Treguesi për papunësinë tregon se niveli i përqindjes së papunësisë është në rënie. Duke parë prirjen aktuale dhe nevojën për të arritur standartet e BE-së, ai duket se është aq sa duhet ambicioz.

Frekuenca e nënpeshës tek fëmijët nën 5 vjeç është 8% (ku 1% quhet e rëndë dhe 7% mesatare). Kjo tregon që Shqipëria tashmë e ka arritur objektivin e synuar. Duke marrë në analizë tre treguesit e kequshqyerjes (nënpesha, rakitizmi dhe humbja e peshës), rezulton që ka probleme serioze me treguesin e rakitizmit (për vitin 2006 ishte 22%)¹⁸. Meqenëse synimi për tendencën e nënpeshës tek fëmijët nën 5 vjeç është arritur tashmë, do të rishikohet ky synim dhe për këtë do të merren në analizë edhe dimensionet e tjera të kequshqyerjes.

Investimet e huaja direkte janë rritur së tepërmi në vitin 2007, në 465.6 milion euro ose 84% më shumë sesa në vitin 2006. Privatizimi i Altelecom dhe blerja e aksioneve nga të huajt në sektorin financiar përbën pjesën më të madhe të IHD-ve. Ecuria aktuale tregon që Shqipëria do të arrijë synimin e vendosur për investimet e huaja shumë më përpara vitit 2015 (sipas parashikimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar deri në vitin 2012). Politikat mbështetëse të Qeverisë Shqiptare për IHD-të, përfshirë iniciativën “Shqipëria një Euro”; politikat për mbështetjen e zhvillimit të parqeve industriale; politikat për pakësimin e pengesave administrative¹⁹ dhe uljen e korrupsionit, si dhe politika të tjera, janë hartuar për të sjellë rezultate edhe në këndvështrimin e investimeve për mjedisin.

Shqipëria ka bërë përparime të shpejta në drejtim të përdorimit të internetit. Në vitin 2005, përdoruesit e internetit përbënin 6% të popullsisë, shifër e cila u rrit me 2.5 herë në vitin 2006, ose 15% e popullsisë. Qeveria Shqiptare është në procesin e hartimit të Strategjisë për Shoqërinë e Informacionit që synon të rrisë aksesin në internet përmes përmirësimit të teknologjisë së informacionit, të përmirësimit të teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në shkollë, të përmirësimit të shërbimeve elektronike, etj. Në këtë kuadër janë duke u zbatuar një numër projektesh të tilla si Shkollat TIK, GovNet, etj. Përmirësimi i marrjes së informacionit në internet dhe rritja e numrit të shërbimeve përmes internetit për qytetarët dhe bizneset do të kontribuojë në rritjen e numrit të përdoruesve të internetit. Synimi që deri në vitin 2015, 35% e popullsisë të përdorë internetin, është i arritshëm për Shqipërinë. Kjo mbështetet në faktin se “mosha dixhitale” është një prioritet në programin e punës të Qeverisë Shqiptare dhe ka filluar të zbatohet në të gjithë sektorët e zhvillimit të vendit.

Numri i kompjuterave personale për 100 persona është larg nga objektivi (niveli për 2006 është 3.8 dhe synimi për 2015 është 35), por ritmet e rritjes së përdorimit të kompjuterave personale dhe politikat nxitëse të qeverisë për sektorin e teknologjisë së informacionit rrisin mundësitë për të arritur objektivin.

¹⁸ Burimi: www.unicef.org/infobycountry/albania_statistics.html

¹⁹ Koha për regjistrimin e një biznesi është ulur në mënyrë drastike, nga 45 ditë në vetëm 1 ditë

Megjithëse po bëhen përparime, në lidhje me treguesin për përdorimin e internetit, Shqipëria është aktualisht larg BE-27. Aksesit i BE-27 në internet për vitin 2007 ishte 54% (19% për Bullgarinë, 25% për Greqinë dhe 83% për Holandën). Duke pasur parasysh progresin e bërë për përdorimin e internetit dhe nevojën për të arritur standartet e BE-së, bazuar në zhvillimin e shpejtë në drejtim të përdorimit të internetit, ky synim do të rishikohet për të qenë më ambicioz.

Monitorimi i nivelit të varfërisë dhe reduktimit të saj bazohet kryesisht tek të dhënat e marra nga LSMS. Ndërkohë, ka filluar procesi i monitorimit të Strategjisë Ndërsektorale të Përfshirjes Sociale, si pjesë e një sistemi monitorimi që ka në qendër të vëmendjes përjashtimin social. Në këtë mënyrë është adresuar shqetësimi për shpërndarjen e popullsisë së varfër - për zonat, grupet etnike, shtresat sociale, etj. Të dhënat do të grumbullohen çdo vit dhe do të publikohen në internet nga MPÇSSHB-ja për publikun e gjerë dhe politikë-bërësit.

OZHM 2: Arritja e një arsimimi bazë universal cilësor

Synimi 7: Garantimi i ndjekjes së arsimit fillor 100% nga djemtë dhe vajzat deri në vitin 2015

Synimi 8: Zbatimi i masave për të siguruar përmirësimin e cilësisë së arsimit fillor

Synimi 9: Përafrimi i treguesve financiarë të arsimit fillor me vendet e OECD-së

Treguesit	Burimi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Synimi 2015
% neto e regjistrimit në arsimin fillor [1-4]	MASH	92.5	94	95	89	89	94	100
% neto e regjistrimit në arsimin bazë [1-9]	MASH	m	94	97	94	94	94	100
% e përfundimit të arsimit fillor [1-4]	MASH	88	98	86	98	99	95	pp**
% e përfundimit të arsimit bazë [1-9]	MASH	98	98	97	98	98	96	pp
% e braktisjes së arsimit fillor [1-4]	MASH	2	2	1.2	0.95	0.94	0.89	0
Numri mesatar i viteve të shkollimit	MASH	m	10.5	m	m	8.5	8.5	>13.5

*m - mungon **pp - e papërcaktuar në raportin paraprak 2004 për OZHM-të

Ndërmjet viteve 2006 dhe 2007 ka pasur një përmirësim të rëndësishëm në nivelin e regjistrimit neto në arsimin fillor. Niveli i përfundimit të arsimit bazë prej vitit 2005 ka qëndruar konstant. Megjithatë, prirjet në lidhje me numrin mesatar të viteve të shkollimit paraqesin si nevojë rishikimin e synimeve të përcaktuar për vitin 2015. Njëfarë rënie është vënë re në treguesit e përfundimit të arsimit fillor dhe bazë midis viteve 2006 dhe 2007. Luhatjet në lidhje me regjistrimin dhe përfundimin e arsimit fillor (raportet e viteve 2004 dhe 2005 e nxjerrin gjithashtu në pah) kërkojnë trajtimin e problemit të përjashtimit. Përmirësimi i treguesve për të arritur tek ata të synuarit kërkon përpjekje dhe masa specifike, më konkretisht:

- Zbatimin e politikave të identifikuar tashmë për ristrukturimin e ofrimit të shërbimit arsimor (vendndodhjen e shkollave, motivacionin dhe trajnimin e mësuesve, etj.) për të plotësuar nevojat e zonave urbane dhe atyre rurale. Ristrukturimi do të ndjekë ndryshimet demografike e migratore;
- Ofrimin e arsimit të veçantë në përpunje me kërkesat e grupeve në nevojë, si familjet më të varfëra, zonat më të paprivileguara, romët (një ndër katër fëmijë romë mbetet i paarsimuar)²⁰ dhe grupe të tjerë;
- Një vëmendje më të madhe për të shmangur përfshirjen e fëmijëve në aktivitete ekonomike (puna e fëmijëve) dhe në martesat e fëmijëve. Të dhënat e vitit 2006 tregojnë se nga 12% e fëmijëve - 9% e vajzave dhe 14% e djemve - janë përfshirë në aktivitete ekonomike dhe 8% e fëmijëve (vajza) martohen para se të arrijnë moshën 14 vjeç²¹.
- Ngritjen në nivele rajonale të organizmave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sikurse është parashikuar në SKZHI.

Arsimi është prioritet në programin politik të Qeverisë Shqiptare dhe konsiderohet si një nga prioritetet më të rëndësishme të Qeverisë Shqiptare në strategjinë e re për arsimin për periudhën 2007-2013 të hartuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës në kuadrin e SKZHI-së. Programi Buxhetor Afatmesëm (MTBP) për vitet 2009-2011 e trajton arsimin si një ndër sektorët me mbështetje më të madhe financiare. Në vitin 2007, krahasuar me vitin 2006, buxheti për arsimin është rritur në mënyrë të konsiderueshme, me 22%. Shpenzimet publike për arsimin janë rritur nga 2% e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PPB) në vitin 2005 në 3.4% të PPB-së në vitin 2007²². Cilësia e arsimit, veçanërisht në zonat rurale, mbetet gjithashtu në qendër të vëmendjes së politikave të qeverisë. Për këtë, projekti "Cilësi dhe Barazi në Arsim" i mbështetur nga Banka Botërore po kontribuon në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe në përfshirjen e grupeve të përjashtuar.

²⁰ Burimi: Qeveria shqiptare, 2008, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

²¹ Burimi: www.unicef.org/infobycountry/albania_statistics.html

²² Ato janë rritur me 4% të PPB-së në 2008

Synimet në fushën e arsimit do të rishikohen me qëllim vendosjen e treguesve realisht të arritshëm. Shumica e tyre janë përcaktuar të jenë në nivel 100%. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka përcaktuar një synim shumë ambicioz për numrin mesatar të viteve të shkollimit (në vitin 2013 do të arrijë në 15 vite). Ky është një synim në të vërtetë shumë ambicioz nisur nga të dhënat e vitit 2006, por është një shifër ende e ulët po të krahasohet me nivelin e BE-së (për vitin 2004 mesatarja e BE-së ishte 17.4 vite, ndërsa Sllovenia e kishte 16.2). Buxheti i arsimit është rritur, por ai është ende nën nivelin mesatar të BE-së (BE-27 për vitin 2005 shpenzoi për arsimin mesatarisht 5.03% të PPB-së; Malta shpenzoi 2.93% të PPB-së dhe Danimarka shpenzoi 8.28% të PPB-së). Bazuar në politikat e nisura tashmë, është i domosdoshëm hartimi dhe paraqitja e synimeve ambicioze për cilësinë e arsimit, me qëllim që të trajtohet çështja e cilësisë së tij.

Aktualisht, ekziston një sistem relativisht i mirë monitorimi, i cili bazohet kryesisht në të dhënat administrative, të grumbullura rregullisht nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, por edhe në të dhënat e vëzhgimeve të kryera nga INSTAT. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka miratuar tashmë një sistem monitorimi vjetor. Sistemi i monitorimit mbulon pjesërisht edhe cilësinë e arsimit nëpërmjet përfshirjes në të të treguesve të tillë si: numri i kriterëve që janë zbatuar për performancën, numri i shkollave të inspektuara dhe të audituara, vlerësimi i jashtëm i shprehive matematikore, etj. Gjithashtu, lidhur ngushtë me cilësinë e arsimit janë edhe një grup tjetër treguesish si: numri i mësuesve të trajnuar, rritja e rrogave, ndërtimi i klasave të reja, pajisjet shkollore, laboratorët, përmirësimi i kurrikulave të mësimdhënies, etj.

Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të monitorimit të cilësisë së arsimit parashikohet të kryhet në kuadër të vënies në veprim të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Arsimit (SIMA), i cili do të sjellë ndryshime pozitive. Në këtë mënyrë, do të arrihet krijimi i një sistemi të plotë dhe bashkëkohor për monitorimin e arsimit. Në përputhje të plotë me treguesit e OZHM-së, ky sistem do të marrë në konsideratë edhe të dhënat e grumbulluara për sektorin privat.

OZHM 3: Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i gruas

Synimi 10: Eliminimi i pabarazisë gjinore në arsimin fillor dhe 9-vjeçar, mundësisht deri në vitin 2005

Synimi 11: Eliminimi i pabarazisë gjinore në institucionet e zgjedhura dhe pozicionet vendimmarrëse në qeverisjen qendrore e atë vendore.

Treguesit	Burimi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Synimi 2015
Raporti i vajzave me djemtë në arsimin fillor [1-4]	MASH		0.94	0.93	0.93	0.927	0.927	1
Raporti i vajzave me djemtë në arsimin e mesëm të ulët [5-9]	MASH		0.92	0.94	0.94	0.923	0.923	1
Përqindja e grave deputete në parlament (%)	Parlamenti	5.7	5.7	5.7	7.1	7.1	7.1	30
Përqindja e grave të punësuar jashtë sektorit bujqësor (%)	INSTAT	32.6			32.4	47	47	50

Përparimi i kryer është i rëndësishëm përse i përket punësimit të grave jashtë sektorit të bujqësisë. Me rezultatin prej 47% të arritur deri tani, punësimi i grave në punë jashtë bujqësisë është tashmë shumë pranë synimit. Të dhënat e tjera tregojnë se papunësia tek gratë është 17%, ndërsa papunësia tek burrat është vetëm 12.1%. Vetëm 17% e kompanive private menaxhohen nga gratë. Kjo shifër është edhe më e vogël për zonat rurale (15%). Në fushën e punësimit në sektorin e arsimit shifrat konfirmojnë një pozitë më të mirë për gratë. 49% e stafit mësimdhënës të punësuar në sektorin e arsimit janë gra. Vlerësohet se ulja e varfërisë është më e ngadaltë për gratë sesa për burrat. Shifrat në lidhje me barazinë në arsimin fillor dhe të mesëm tregojnë për një rënie të lehtë midis viteve 2005 dhe 2007.

Vendet e zëna nga gratë në parlament në vitin 2007 mbeten të pandryshuara që prej zgjedhjeve të vitit 2005 dhe janë larg nga synimi. Duhet të përmendet se përfaqësimi i grave në organet e zgjedhura dhe në pozicionet ekzekutive është shumë i ulët. Në nivel parlamenti, vetëm 7.1% e parlamentarëve janë gra. Në qeverisjen qendrore - nivele të ndryshme - vetëm 11 gra janë në pozicione të larta ekzekutive (ministre, zëvendësministre dhe sekretare e përgjithshme). Në pushtetin vendor, vetëm 2% e të zgjedhurve në pozicione të larta (kryetar komune, kryetar bashkie dhe kryetar qarku) janë gra²³. Një pabarazi e tillë ndodh kryesisht për shkak të ekzistencës në vazhdim të stereotipeve gjinore në arsim që kanë lidhje me pozitën gjinore brenda familjes dhe në jetën shoqërore, si dhe të mjedisit politik aspak miqësor ndaj grave.

Qeveria Shqiptare ka bërë përparime të dukshme për të ecur drejt zbatimit të standardeve dhe normave të përcaktuara nga Konventa Kundër çdo lloj Diskriminimi të Grave (CEDAW), Platforma për Veprim e Pekinit, Traktati i Komisionit Evropian dhe politikat përkatëse. Institucionalisht, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe partnerët vendorë kanë marrë disa hapa për të rregulluar gradualisht monitorimin e të drejtave të grave në nivel vendor dhe kombëtar. Në vitin 2004, u miratua ligji i parë në vend për Barazinë Gjinore (LBGJ)²⁴. Me qëllim që legjislacioni të përafrohej më shumë me standardet e BE-së, tashmë është në rrugë e sipër një rishikim i ligjit ekzistues dhe janë përgatitur amendamente të cilat po shqyrtohen. Në vitin 2006, Qeveria Shqiptare miratoi ligjin e parë në vend për dhunën në familje dhe tani po përgatit aktet nën-ligjore për të garantuar zbatimin e plotë të ligjit në nivel lokal e kombëtar.²⁵

Për më tepër, Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje (SKBGJDFH 2007-2010), strategjia e parë e këtij lloji në vend. Aspektet kryesore të strategjisë

²³ Qeveria e Shqipërisë, 2007, Strategjia për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës në Familje

²⁴ Ligji Nr. 9198 datë 1.07.2004 "Mbi Barazinë Gjinore në Shqipëri", amenduar në 2006.

²⁵ Ligji Nr. 9669 datë 18.12.2006 "Mbi Masat kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare"

janë krijimi i një kuadri ligjor²⁶ dhe institucional që garanton barazinë gjinore, rrit përfaqësimin e grave në vendimmarrje duke bërë ndryshime në kodin elektoral, garanton fuqizimin ekonomik të grave, duke iu ofruar mundësi të bëhen sipërmarrëse dhe duke hartuar programe të veçanta për punësimin e grave, shmangien e pabarazive gjinore në arsim, ofrimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional për mbrojtjen e grave nga trafikimi, etj. Më tej, vendimi për të përfshirë SKBGJDHF-në në SKZHI ofron një mundësi të rëndësishme për të siguruar integrimin e prioriteteve të barazisë gjinore në strategji më të gjera sektoriale dhe ndërsektoriale që po zbatohen tani në të gjithë vendin.

Synimet e nxitjes së barazisë gjinore dhe të fuqizimit të gruas janë shumë ambicioze. Aktualisht, ato pasqyrojnë më shumë ambicien për integrimin e grave, sesa përpjekjet që duhen bërë për arritjen e synimeve. Disa synime, si përqindja e grave në parlament dhe përqindja e grave në punë të paguara jashtë sektorit bujqësor janë parashikuar të jenë edhe më të larta sesa mesatarja e BE-së (për vitin 2004, shifrat janë përkatësisht 24.3% dhe 45.3%)²⁷. Këto synime do të rishikohen për tu bërë realisht të arritshme.

Sistemi për monitorimin e barazisë gjinore ekziston, por nevojitet të përmirësohet për të qenë më efektiv. Mekanizmat e barazisë gjinore do të ngrihen për të monitoruar me efektivitet Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje. Monitorimi dhe përmirësimi i analizës së statistikave të ndara sipas seksit, me qëllim për të kuptuar më mirë situatën e grave dhe përparimet e bëra në drejtim të barazisë gjinore, mbeten prioritet i qeverisë.

²⁶ Ligji për barazinë gjinore është miratuar në korrik 2008. Projekt-ligji përfshin arsimin, punësimin dhe pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje. Sipas ligjit për barazinë gjinore, 30% e posteve më të larta në vendimmarrje duhet të zihen nga gratë.

²⁷ Burimi: Shqipëria: Raporti për OZHM, 2005

OZHM 4: Ulja e vdekshmërisë foshnjore

Synimi 12: Ulja e vdekshmërisë foshnjore tek moshat nën 5 vjeç në 10/1.000 lindje të gjalla deri në vitin 2015

Treguesit	Burimi	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Synimi 2015
Vdekshmëria foshnjore për 1000 lindje të gjalla	MSH	17.4	17.5	15.5	15.1	14.7	13	12	10
% e vdekshmërisë tek moshat nën 5 vjeç për 1000 lindje të gjalla	MSH	20.1	20.1	20.7	na	18	18	m*	10
Përqindja e fëmijëve të vaksinuar kundër fruthit, rubeolës dhe parotitis (%)	MSH	>95	95	94	96	97	94.8	97.6	95

*m - mungon

Përqindja e vdekshmërisë foshnjore po ulet vazhdimisht dhe niveli i vitit 2007 është shumë pranë nivelit të synuar për vitin 2015. Për këtë, niveli i parashikuar për vitin 2015 pritet të arrihet më parë se ky vit. Gjithashtu edhe përqindja e vdekshmërisë tek fëmijët e moshës nën pesë vjeç është në rënie, por jo me të njëjtin ritëm uljeje me atë të vdekshmërisë foshnjore. Bazuar në nivelin e rënies ndërmjet viteve 1990 dhe 2006 (6.1% në vit)²⁸, supozohet që do të arrihet niveli i synuar për vitin 2015.

Synimi i vdekshmërisë foshnjore do të rishikohet në mënyrë që të jetë më ambicioz dhe në përputhje me nivelin e BE-së. Niveli i vdekshmërisë foshnjore i BE-25 ishte 5 për 1,000 lindje për vitin 2005 (Suedia 2.4 për një mijë dhe Rumania 15 për një mijë). Vdekjet e fëmijëve të porsalindur përbëjnë numrin më të lartë të vdekjeve tek foshnjat dhe fëmijët. Niveli i vdekshmërisë foshnjore duhet të jetë më i ulët se “përqindja e vdekjeve tek fëmijët nën pesë vjeç”²⁹, meqenëse “vdekshmëria foshnjore” është pjesë përbërëse e “vdekshmërisë së fëmijëve nën pesë vjeç”.

Tashmë ekziston sistemi i monitorimit për vdekshmërinë foshnjore. Për këtë, do të punohet që raportet statistikore të jenë më shumë të publikuara në internet për publikun dhe studiuesit.

Përqindja e fëmijëve të vaksinuar kundër fruthit është e lartë dhe konsiderohet si një shifër e mirë kur krahasohet me nivelin global. Megjithatë synimi (95%) tashmë është arritur dhe tejkaluar, përsëri shqetësim përbëjnë dallimet midis grupeve të ndryshme dhe mbetet një sfidë plotësimi i përqindjeve të fundit, duke ofruar shërbim të barabartë për fëmijët e të gjitha kategorive.

²⁸ Përlllogaritjet nga UNICEF: www.unicef.org/infobycountry/albania_statistics.html

²⁹ Të dyja objektivat janë aktualisht të njëjta

OZHM 5: Përmirësimi i shëndetit të nënës

Synimi 13: Ulja deri në përgjysmim e nivelit të vdekshmërisë amtare ndërmjet viteve 2001 dhe 2015

Treguesit	Burimi	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Synimi 2015
Vdekshmëria amtare për 100,000 lindje të gjalla	MSH	22.7	25.9	21.3	12.0	23.2	16.7	14.5	11
Përqindja e vizitës së parë të shtatzënisë gjatë tremujorit të parë (%)	MSH	41.7	42	47	47	43	m *	43	70
Nxitja e lindjeve të ndjekura nga personel shëndetësor i kualifikuar (%)	MSH	m	m	m	m	m	100	m	>98

*m - mungon

Në lidhje me vdekshmërinë amtare ekziston një prirje e qartë rënieje. Duke pasur parasysh prirjen e përgjithshme dhe rënien e mprehtë në vitet 2006 dhe 2007 krahasuar me nivelin e vitit 2005, supozohet se synimi për nivelin e vdekshmërisë amtare do të arrihet deri në vitin 2015. Bazuar në prirjen e të dhënave të së shkuarës, niveli pritet të jetë 12.3 në vitin 2008 dhe 10.1 për vitin 2009. Përlllogaritja supozon se sistemi i përgjithshëm i mbështetjes për shëndetin e nënës do të përmirësohet, ashtu siç ka ndodhur edhe në të kaluarën.

Në lidhje me vizitat e periudhës së paralindjes, të dhënat administrative dhe ato të anketave³⁰ tregojnë të njëjtin rezultat: 97.1% e grave shtatzëna marrin kujdes shëndetësor profesional gjatë shtatzënisë së tyre. Pjesa e grave shtatzëna që marrin kujdes shëndetësor profesional gjatë tre muajve të parë të shtatzënisë mbetet ende e ulët.

Të gjitha lindjet tani kryhen me ndihmën e një profesionisti të kualifikuar dhe 98% e lindjeve kryhen në kushte institucionale (maternitet).

Synimet në lidhje me vdekshmërinë amtare nuk janë mjaft ambicioze dhe për këtë duhen të përshtaten me nivelin e vendeve të BE-së. Vdekshmëria mesatare amtare në vendet e BE-së për vitin 2002 ishte 5.5 për 100,000. Vendorsja e synimeve më ambicioze në këtë drejtim, si për vdekshmërinë amtare ashtu edhe për kujdesin para lindjes, kërkon nxitjen e politikave më ambicioze për të përparuar më me shpejtësi drejt përmirësimit të shëndetit të nënës.

Aktualisht ekziston një sistem për grumbullimin e të dhënave për shëndetin e nënës, i cili përbëhet nga një komponent administrativ dhe një komponent anketash periodike. Përmirësimi i bashkëpunimit midis organeve të ndryshme që grumbullojnë të dhëna është i nevojshëm për të prodhuar të dhëna më të besueshme dhe në kohën e duhur, mundësisht në formën e një baze të dhënash të integruar dhe të përdorshme në internet.

³⁰ UNICEF: Sondazhi MICS 2006 dhe të dhënat e Ministrisë së Shëndetsisë

OZHM 6: Lufta kundër HIV/SIDA dhe tuberkulozit³¹

Synimi 14: Të ndalet dhe të përmbysset raporti i përhapjes e virusit HIV/SIDA deri në vitin 2015

Synimi 15: Të ndalet dhe të përmbysset raporti i nivelit të vdekshmërisë nga tuberkulozi deri në vitin 2015

Treguesit	Burimi	2003	2004	2005	2007	Synimi 2015
Niveli i shpeshtësisë së infektimit me HIV/SIDA te të rriturit (15-19 vjeç) (%)	MSH	(185)*		<0.1	(255)*	pp
Numri i personave që e bëjnë vullnetarisht testin për HIV	MSH	250	350	1000	338	50.000
Niveli i paralajmëruar i tuberkulozit për 100,000 persona	MSH	20	20	18	16	13
Përqindja e vdekjeve nga tuberkulozi	MSH	4.5	3.5	3.5	3.1	2.5

*Numri i personave të prekur; pp - i papërcaktuar

Numri i personave të prekur nga HIV nga viti 1993 deri në vitin 2007 është i vogël, ndërsa aktualisht rezulton të ketë arritur në 255 persona. Megjithatë, niveli i shpeshtësisë së infektimit me HIV/SIDA te të rinjtë mund të rritet dhe kjo duke përfshirë disa faktorë si: migracionin, hezitimin për përdorimin e prezervativëve që lidhet me pabarazinë e përhapur mes burrave e grave dhe rritjen e përdorimit të rrugës intravenoze të marrjes së drogës.

Numri i njerëzve që e kanë kryer vullnetarisht testin e HIV në vitin 2007 është i vogël, vetëm 338 persona. Ky numër është shumë më i ulët sesa ai i vitit 2005. Niveli i treguesit është larg synimit prej 50,000 personash që duhet të bëjnë vullnetarisht testin për HIV deri në vitin 2015. Rritja e mundësive për të kryer testin për HIV është themelor. Pavarësisht mënyrës sekrete të testimit e këshillimit për HIV/SIDA dhe të përshtatur me natyrën e të rinjve, apo mësimet në shkollë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe funksionimit të 9 Qendrat e Këshillimit Vullnetar për Testimin, nevojiten më shumë përpjekje për përmirësimin e cilësisë dhe monitorimit të testimit për HIV/SIDA.

Bazuar në shifrat e dhëna për këtë tregues, synimet në lidhje me numrin vjetor të testeve për HIV janë ambicioze, por jo të paarrtshme. Ekziston një nevojë urgjente për ngritjen e një shërbimi të përshtatshëm testimi, i cili të ketë një komponent të fortë për përfshirjen e njerëzve. Treguesi për tuberkulozin është në rënie gjatë viteve 2003-2007. Niveli i këtij treguesi duhet të jetë më ambicioz.

Ministria e Shëndetësisë është angazhuar seriozisht për rishikimin e ligjit për HIV/SIDA dhe strategjinë për parandalimin dhe luftën ndaj HIV, me qëllim që ato të lidhen më mirë me parimet e të drejtave të njeriut dhe të bëhen më operacionale. Ndërkohë, ekziston autoriteti kombëtar, si edhe kuadri kombëtar për një plan monitorimi dhe vlerësimi në lidhje me këta tregues

Njësia dhe Plani për Monitorimin dhe Vlerësimin janë ngritur dhe për këtë kërkohet vënia në funksionim dhe zbatimi i tyre. E rëndësishme është edhe ngritja e sistemit periodik për mbikqyrjen dhe prodhimin e të dhënave. Burimet financiare të Fondit Global kundër HIV, TB dhe Malarjes do të përdoren për të zgjeruar këtë komponent.

³¹ Sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, kanceri dhe sëmundjet kardiovaskulare - dhe jo sëmundjet infektive - përfaqësojnë shkaqet kryesore të vdekjeve në Shqipëri. Duhani dhe mosmbajtja e dietës që çojnë në mbipeshë çojnë shpesh në vdekje. Prandaj, sistemi i shëndetësisë në Shqipëri duhet të ndryshojë për t'iu përshtatur sfidave të reja e të kushtueshme. Po ashtu, duhet të ndryshojë edhe sistemi i monitorimit.

OZHM 7: Garantimi i zhvillimit mjedisor të qëndrueshëm

Synimi 16: Përfshirja e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kompensimi i humbjeve të burimeve mjedisore.

Synimi 17: Ulja e përqindjes së njerëzve që nuk kanë infrastrukturë të përshtatshme për ujë të pijshëm dhe kanalizime.

Treguesit	Burimi	2002	2003	2004	2005	2007	Synimi 2015
Sipërfaqja e mbrojtur e tokës për të ruajtur biodiversitetin (% e territorit të Shqipërisë)	MMPAU	3.6	5.8	6.3	8.3	11.4	pp**
Sipërfaqja e tokës e mbuluar me pyje (000 ha)	MMPAU	991	m	m	1041	1045	pp**
Popullsia që ka ujë të pijshëm të sigurt (%)	INSTAT	69	75.4	m	71	78.4	98
Popullsia që përdor sistem kanalizimesh të përmirësuar (%)	INSTAT	63.8	68.3	m	70.8	76.2	95

*m - mungon, **pp - i papërcaktuar

Gjatë viteve 2005 dhe 2007 është rritur ndjeshëm sipërfaqja e mbrojtur e tokës për të ruajtur diversitetin biologjik. Sipërfaqja e mbrojtur në vitin 2007 përfaqëson 11.4% të territorit shqiptar. Rritja e sipërfaqes së mbrojtur nuk po ecën sipas programit të qeverisë. Sipërfaqja e mbrojtur duhet të përbëjë 13.6% të territorit shqiptar nga fundi i vitit 2007, sipas Programit për Dyfishimin e Sipërfaqes së Zonave të Rrjetit të Mbrojtur.

Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve është rritur vetëm me 4,000 ha midis viteve 2005 dhe 2007. Në vitin 2007, sipërfaqja e përgjithshme e tokës së pyllëzuar ishte 1,045 milion hektarë, duke përfaqësuar pak më shumë se 36% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Sipas procesit të decentralizimit, Qeveria Shqiptare synon të transferojë menaxhimin e pyjeve (dhe në një fazë të dytë edhe pronësinë mbi to) në duart e pushtetit vendor. Faza eksperimentale ka treguar se transferimi drejt pushteteve vendore ka sjellë si rrjedhojë rritjen e dukshme të bimësisë, uljen e prerjes së paligjshme të pyjeve dhe uljen e numrit të zjarreve. Deri në fund të vitit 2007, vetëm 300 ha u janë transferuar pushteteve vendore³².

Në lidhje me pjesën e popullsisë që ka ujë të pijshëm të sigurt dhe është e lidhur me kanalizime të përmirësuar ka njëfarë përparimi. Sipas të dhënave administrative³³, 78.4% e popullsisë ka pasur ujë të pijshëm të sigurt (71% në vitin 2005) dhe 76.2% e popullsisë kishte sistem kanalizimesh të përmirësuar në vitin 2007 (70.8% në vitin 2005). Ndërprerjet e furnizimit me ujë vazhdojnë të mbeten një problem. Qeveria Shqiptare e ka përfunduar tashmë transferimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve drejt pushtetit vendor, bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Decentralizimit, por aspektet e tjera të reformës (reforma e çmimit, përmirësimi i menaxhimit të kompanive të ujësjellësave, etj.) kanë nevojë të zhvillohen tërësisht. Plani dyvjeçar i qeverisë për reformën në sektorin e ujit (pas transferimit në qeverisjen lokale) pritet të trajtojë çështjet e mbetura pa trajtuar deri tani nga reforma. Reforma e çmimit të ujit (rritja e tij) do të plotësohet me skemën e subvencionimit të çmimit për shtresat e varfra.

Siguria e ujit të pijshëm, ndotja e ujërave të deteve dhe të liqeneve për shkak të mostrajtimit të ujërave të zeza, si edhe ndërprerjet e furnizimit me ujë të pijshëm mbeten ende probleme të cilat do të adresohen.

Në raportin bazë të OZHM-së³⁴ nuk janë përcaktuar synime për sipërfaqen e tokës së mbrojtur për ruajtjen e diversitetit biologjik ose për sipërfaqen e tokës së pyllëzuar. Synimi për sipërfaqen e mbrojtur

³² Transferimi i zonave pyjore tek qeverisja lokale ka shënuar rritje gjatë vitit 2008. Deri në mes të vitit 2008, 530,000 hektarë (më shumë se gjysma e sipërfaqes totale të tokës të mbuluar me pyll) janë transferuar tek pushteti lokal.

³³ Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

³⁴ QSH, 2004, Raporti kombëtar i Shqipërisë: Progresi i bërë drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit

i përcaktuar në strategjinë e mjedisit (15% e territorit shqiptar për vitin 2014) duket se është realist. Rezultatet e kufizuara në lidhje me përmirësimin e lidhjeve me ujë të pijshëm dhe kanalizime vënë në dukje se synimet në lidhje me to janë disi më ambicioze sesa duhet.

Për sipërfaqet e mbrojtura dhe të pyllëzuara ekziston një system i konsoliduar i monitorimit administrativ. Në krahasim me këtë, përkufizimet për “akses në ujë të pijshëm të sigurt” dhe “akses në kanalizime të përmirësuara” nuk janë zhvilluar dhe për rrjedhojë nuk janë zbatuar me përpikmëri. Sistemi administrativ për monitorimin e aksesit në ujë të pijshëm dhe kanalizime kërkon një vemendje të veçantë, veçanërisht për zonat urbane dhe nënurbane. Monitorimi bazohet në të dhënat e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) dhe mundësia për t’i pasur këto të dhëna është e vështirë.

OZHM 8: Krijimi i një partneriteti global për zhvillimin

Synimi 18: Garantimi i një partneriteti për zhvillim më të harmonizuar dhe efikas me komunitetin e donatorëve

Treguesit	Burimi	2003	2005	2007	2015
Përqindja e donatorëve, strategjitë e ndihmës së të cilëve janë në përputhje me prioritetet e OZHM-së përmes SKZHES (SKZHI)	DEBASKON	nd	28	51	100
Përqindja e donatorëve që i bëjnë të njohura informacionet mbi ndihmat, përfshirë materialet e hedhura në faqen e internetit	DEBASKON	nd	49	30	100

Gjatë periudhës 1990-2007, ndihma e huaj arriti në rreth 5.3 miliard euro, nga të cilat 67% kanë qenë në formë granti, 24% në kredi konçesionare dhe 13% në kredi jo-konçesionare. Në katër vitet e fundit, rritja e kredive jo-konçesionare ka kompesuar rënien e granteve dhe të kredive konçesionare.

Ndihma e huaj ka qenë e rëndësishme për Shqipërinë gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, për kalimin nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu.

Sondazhi i vitit 2006 dhe 2008 për monitorimin e Deklaratës së Parisit në Shqipëri, që mbulon periudhën 2005-2007, jep përmbledhjen e mëposhtme të vlerësimit, sfidave dhe aktiviteteve.

Parimet	Vlerësimi		Sfidat	Aktivitetet kryesore
	2005	2007		
Pronësia	mesatar	Mesatar-i lartë	Transmetim realist i prioriteteve në termat buxhetore	Zbatim i plotë i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
Përputhshmëria	I dobët	I dobët-mesatar	Përdorim i kufizuar i sistemeve kombëtare, raportim i ulët i ndihmës në buxhet	Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të financave publike nga donatorët, përmirësimi i të dhënave nga disbursimet e ndihmës së huaj
Harmonizimi	I dobët	I dobët-mesatar	Përdorim i kufizuar i përjasjeve me bazë programi	Zhvillimi i përjasjeve më bazë sektori në disa sektorë
Menaxhimi i rezultateve	I dobët	I dobët	Mungesë kapacitetesh në nivel ministrie dhe në atë lokal	Fokusim në kuadrin kombëtar të monitorimit dhe të vlerësimit
Përgjegjshmëria reciproke	I dobët	I dobët	Mungesë e një mekanizmi të përgjegjshmërisë reciproke	Finalizimi i Planit të Veprimeve për Harmonizim dhe sigurimi që ky plan të përfshijë sistemin e monitorimit

Që prej vitit 2005 janë bërë përparime të mëdha në një sërë fushash:

- Sistemi i Planifikimit të Integruar përcakton një numër parimesh për të garantuar që planifikimi dhe zbatimi i politikave dhe i buxhetit kryhen në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar;
- Përmes SKZHI-së 2007-2013 është hartuar një kuadër i vetëm i unifikuar strategjik dhe janë bërë hapa përpara në lidhjen e Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm me SKZHI 2007-2013. Qeveria Shqiptare është angazhuar të luajë rolin drejtues në menaxhimin e ndihmës së huaj përmes DEBASKON-it dhe Ministrisë së Financave;
- Përpjekjet dhe financimet e përbashkëta të donatorëve kanë siguruar burimet e nevojshme dhe asistencë teknike është koordinuar në mënyrë efektive. Në vitin 2007 është koordinuar 51% e asistencës teknike të ofruar nga donatorët përkundrejt 28% në vitin 2005;
- Përparim është bërë në hartimin e raportit të monitorimit të SKZHI-së 2007-2013. SKZHI-ja ka kaluar në një proces konsultimesh të gjera me publikun, përfshirë grupet e punës e grupet këshillimore të ngritura me kujdes. Në to bënë pjesë edhe donatorë dhe organizata të shoqërisë civile.

Është e qartë se synimet janë ambicioze sepse janë përcaktuar në nivele maksimale. Megjithatë, mendohet se Qeveria Shqiptare mund të marrë në konsideratë kalimin nga treguesit dhe synimet ekzistuese në treguesit dhe synimet e Deklaratës së Parisit, të cilat janë më koherente, më të plota dhe të njohura botërisht.

Të dy treguesit për OZHM 8 - të evidentuar në raportin fillestar për OZHM-në e vitit 2002 - janë hartuar që të monitorojnë kontributin e donatorëve për arritjen e OZHM-ve. Megjithatë, përvoja ka dëshmuar se është e vështirë të vihen në veprim treguesit dhe se lista e treguesve nuk është e plotë. Në të kundërt, treguesit e Deklaratës së Parisit (tek Anekset) përfaqësojnë një tërësi treguesish koherente, më të plotë dhe të pranuar ndërkombëtarisht për matjen e efektivitetit të ndihmës, e si pasojë zhvillimin social, përfshirë përmes OZHM-së.

Nga ana institucionale, DEBASKON drejton hartimin dhe zhvillimin e dy sistemeve të informacionit në mbështetje të mandatit të tij shumëplanesh për planifikim strategjik, analizë politikash, monitorim, vlerësim, si dhe koordinim të donatorëve. Konkretisht, këto janë Sistemi i Informacionit për Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPSIS) dhe Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Ndhmës së Huaj (EAMIS), Planifikimin e Buxhetit Afatmesëm (MTBP) dhe sistemet e Thesarit.

Treguesit e Deklaratës së Parisit: niveli bazë për vitin 2005 dhe synimet e Shqipërisë për vitin 2010

<i>Treguesit</i>	<i>2005 parapraku</i>	<i>Synimi 2010</i>
Pronësia		
1 Pronësia - Strategjitë kombëtare në veprim	C	B ose A
Përputhshmëria		
2a Cilësia e Sistemeve të Menaxhimit të Fondeve Publike (SMFP)	4.0	4.5
2b Cilësia e sistemeve të prokurimit	mungon	i pazbatueshëm
3 Ndihma e raportuar në buxhet	32%	85%
4 Zhvillimi i koordinuar i kapaciteteve	28%	50%
5a Përdorimi i sistemeve të vendit për MFP-të (kalimi i ndihmës)	14%	43%
5b Përdorimi i sistemeve të prokurimit (kalimi i ndihmës)	6%	I pazbatueshëm
6 PIU-t paralele	57	19
7 Parashikimi për vitin	49%	74%
8 Ndihma e pakoordinuar	59%	Më shumë se 59%
Harmonizimi		
9 Përdorimi i metodave bazuar tek programet	5%	66%
10a Misione të koordinuara	9%	40%
10b Puna analitike e vendit e koordinuar	22%	66%
Menaxhimi për arritjen e rezultateve		
11 Kuadri i vlerësimit të performancës së fortë	D	B ose A
Përgjegjësi reciproke		
12 Analiza e përgjegjësive reciproke	Jo	Po

Burimi: Këshilli i Ministrave, 2008, Dokumenti për Orientimin e Ndihmës së Huaj

OZHM 9: Krijimi dhe forcimi i procesit të mirëqeverisjes

Synimi 19: Reformimi i të gjithë sistemit shtetëror të administratës publike, legjislaçionit dhe politikave në përputhje me standardet e BE-së për drejtësinë, shtetit të së drejtës dhe ekonomisë së tregut deri në vitin 2015.

Treguesit	Burimi	Baza 2002	2005	2007	Synimet		BE-15 mesatarja për 2002
					2010	2015	
E drejta e fjalës dhe përgjegjshmëria	BB	44.9	48.6	50.0	65	81	90.3
Stabiliteti politik	BB	25.5	28.4	34.6	60.5	71	84.6
Efektiviteti i qeverisë	BB	36.8	31.8	43.1	57.7	76	90.3
Cilësia rregullatore	BB	41.4	46.3	55.8	63.2	83	90
Shteti i së drejtës	BB	16.8	25.2	28.1	56.5	74	89.3
Kontrolli i korrupsionit	BB	23	29.1	36.7	54.7	73	89.2

Burimi: Banka Botërore (Vlerat më të larta nënkuptojnë qeverisje më të mirë)

Gjatë viteve 2006 dhe 2007, Shqipëria ka bërë përparim të dukshëm drejt plotësimin të synimeve të qeverisjes. Përmirësimet janë vënë re në të gjashtë treguesit e qeverisjes dhe përmirësimet e bëra në cilësinë rregullatore, efektivitetin e qeverisë dhe kontrollin e korrupsionit janë mbresëlënëse.

Përparimet e bëra në luftën kundër korrupsionit janë vënë re në dukje edhe nga Komisioni Europian: Strategjia e Qeverisë Shqiptare kundër korrupsionit³⁵ "...tregon një ndryshim pozitiv të metodës nga zgjidhjet afatshkurtra në masa më efektive dhe të qëndrueshme"³⁶. Hetimet kundër korrupsionit kanë çuar edhe në arrestimin e një numri zyrtarësh të lartë.

Në fushën e efektivitetit të qeverisë dhe të drejtës së fjalës e të përgjegjshmërisë, sipas të dhënave të Bankës Botërore, Shqipëria ka lënë prapa një numër vendesh të rajonit. Megjithatë, shteti i së drejtës është akoma në nivel të ulët dhe kontrolli i korrupsionit është i pamjaftueshëm. Për këtë është e nevojshme të punohet ende shumë për të gjitha aspektet e këtij problemi, përfshirë përgjegjshmërinë e gjyqësorit dhe transparencën e financimit të partive politike³⁷. Përsa i përket shtetit ligjor dhe kontrollit të korrupsionit, Shqipëria ka ritmin më të ulët ndërmjet vendeve të Europës Jug-Lindore.

Kohët e fundit, Qeveria Shqiptare ka shtuar numrin e shërbimeve përmes internetit për qytetarët dhe bizneset. Përveç kësaj, rrjeti elektronik ndërmjësor (GovNet) synon t'u ofrojë qytetarëve dhe bizneseve një numër shërbimesh. Politika e qeverisë për të shfrytëzuar potencialin e shoqërisë dixhitale pritet të ketë ndikimin e vet pozitiv në të gjitha aspektet e qeverisjes.

Ritmi i përmirësimit të qeverisjes gjatë viteve 2006 dhe 2007 jep shpresa realiste se projekti për përmirësimin e qeverisjes është në rrugë të mbarë, megjithëse ende larg synimeve, veçanërisht për shtetin ligjor dhe kontrollin e korrupsionit.

Synimet e qeverisjes për vitin 2010 janë në një nivel mesatar për vendet e Evropës Lindore (në 2002) dhe synimet për vitin 2015 përfaqësojnë nivelin minimal për vendet e BE-15 (në 2002). Rezultatet e përmirësimit të qeverisjes gjatë vitit 2007 tregojnë se synimet e qeverisjes duken tashmë më realiste sesa dukeshin bazuar tek të dhënat e vitit 2005.

Aktualisht, Shqipëria nuk ka një sistem monitorimi të qeverisjes dhe është e nevojshme të konsolidohet një sistem me tregues për qeverisjen - tregues të nivelit të dytë, burime të dhënash, dhe përgjegjësi institucionale për të matur qeverisjen çdo vit. Ky është gjithashtu edhe një rekomandim i Komisionit Evropian në Raportin e vitit 2007³⁸. Treguesit e sistemit të qeverisjes duhet të jenë specifike dhe të

³⁵ Kjo është një strategji ndërsektoriale që përfshin bashkëpunimin mes agjencive

³⁶ KE, 2008, Raport Progresi i Shqipërisë, 2007

³⁷ KE, 2008, Raport Progresi i Shqipërisë, 2007

³⁸ Strategjia e re e strategjisë e luftës kundër korrupsionit nuk përfshin sa duhet objektiva dhe tregues konkretë.

ndjeshëm ndaj veprimeve afatshkurtra. Për shembull, për kontrollin e korrupsionit, tregues të tillë do të ishin: numri i masave të marra kundër zyrtarëve publikë që kanë konflikt interesi; numri i masave të marra kundër zyrtarëve publikë që nuk deklarojnë pasuritë, përfshirë numrin e zyrtarëve në taksa e dogana; numri i zyrtarëve publikë të dënuar për shkak të abuzimit me fondet publike; numri i punonjësve të regjistruar në sistemin e mbrojtjes sociale. Një sistem i tillë do ta vinte theksin tek rezultatet dhe do të lehtësonte edhe komunikimin me Komisionin Evropian.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore

- *Progresi i kryer në lidhje me përmbushjen e OZHM-ve gjatë vitit 2007 ka patur në përgjithësi ecuri pozitive.* Është bërë përparim drejt përmirësimit të qeverisjes, mbështetur edhe nga të dhënat e Institutit të Bankës Botërore për vitin 2007. Ka përmirësime në mjaft tregues lidhur me objektivat arsimin, barazinë gjinore, vdekshmërinë foshnjore, shëndetin e nënës dhe mjedisin. Ka përmirësime në uljen e varfërisë, por ndërkohë duhet të konsiderohet niveli më i dukshëm i varfërisë në zonat rurale. Gjithashtu, niveli i papunësisë dhe një shpërndarje më e barabartë e të ardhurave mbeten sfida për t'u adresuar.
- *Synimet e OZHM-ve nevojitet të rishikohen dhe rifreskohen.* Synimet për varfërinë absolute dhe të skajshme, investimet e huaja direkte, frekuencën e nënpeshës tek fëmijët nën pesë vjeç, përqindjen e vdekshmërisë foshnjore, përqindjen e fëmijëve të vaksinuar kundër fruthit, përqindjen e vdekshmërisë së nënës dhe kujdesit gjatë shtatzënisë, përqindjen e vdekshmërisë nga turbekulozi dhe synime të tjera janë arritur ose do të arrihen shpejt. Po ashtu, një numër synimesh mungojnë, pasi nuk janë përcaktuar që në raportin fillestar të vitit 2004 për OZHM-në. Rishikimi dhe rifreskimi i synimeve që tashmë janë bërë të vjetëruara dhe përcaktimi i synimeve që mungojnë, kërkon një proces me përfshirjen e gjerë të të gjithë aktorëve: qeverisë, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, agjensive të zhvillimit dhe donatorëve.
- *Llogaridhënia dhe transparencat po përmirësohen.* Qeveria Shqiptare ka bërë një punë të rëndësishme për të hartuar strategjitë (sektoriale dhe ndërsektoriale) dhe për t'i integruar ato në SKZHI 2007-2013. Sistemi i monitorimit dhe transparencat po përmirësohen. SKZHI 2007-2013 ka përfshirë një sistem prej 45 treguesish sasiorë e cilësorë. Raportet e Progresit të SKZHI-së po përgatiten bazuar në sistemin e mësipërm të treguesve. Po ashtu, çdo ministri ka një sistem monitorimi, ku përfshihet dokumenti i Planit të Integruar të Ministrisë (tashmë në internet) që çdo ministri përgatit çdo vit në kuadër të SKZHI-së dhe strategjive sektoriale (ndërsektoriale) dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Plani i Integruar i Ministrisë përmban objektivat, aktivitetet dhe produktet që ministritë ofrojnë me buxhetin e vitit aktual, Planet Monitoruese të Ministrisë që përmbajnë tregues të zgjedhur për produktet (outputs) e për të monitoruar ecurinë e arritur gjatë vitit. Megjithatë, mbetet ende për t'u bërë në drejtim të monitorimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale, sidomos të përmirësimit të treguesve që duhet të jenë të qartë.
- *Sistemet e monitorimit të strategjive sektoriale nevojitet të plotësohen me sistemin monitorues të treguesve të OZHM-së dhe synimeve përkatëse.* Strategjitë sektoriale (dhe Planet e Integruara të Ministrive) duhet të plotësohen me sistemet monitoruese të treguesve të OZHM-së, që janë sisteme të mira për të monitoruar rezultatet (outcomes). Kjo është shumë e rëndësishme për orientimin e debatit të politikave më shumë drejt jetës së njerëzve sesa drejt treguesve të ndërmjetëm (outputs). Po ashtu, sistemet e monitorimit të strategjive sektoriale duhet të plotësohen me synime, të cilat duket se mungojnë.
- *Nevojitet vazhdimi i hartimit të politikave transparente duke i hedhur ato në internet, duke motivuar nëpunësit publik dhe publikun e gjerë që të përdorin teknologjinë dixhitale.* Tashmë në internet gjendet më shumë informacion për shërbimet publike dhe një numër shërbimesh të tjera duhet të ofrohen gjithashtu në internet. Akoma më shumë duhet bërë në këtë drejtim dhe qeveria duhet të motivojë nëpunësit dhe publikun të përdorin teknologjinë dixhitale.